

Universiteti "Fan S. Noli"
Akademia e Shkencave e Shqipërisë

VENDBANIMET E BASHKISË KORÇË




**Studimi në kuadër të projektit kërkimor
"Studimi i qendrave të banuara në Bashkinë e Korçës"
(Njësia administrative Korçë, Qendër Bulgarec, Drenovë, Mollaj)**



**UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”, KORÇË
DEPARTAMENTI I HISTORISË DHE I GJEOGRAFISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË**

**VENDBANIMET E BASHKISË KORÇË
Paraqitja fiziko-gjeografike, demografike dhe funksionale**



**Studim në kuadër të projektit kërkimor “Studimi i Qendrave të
Banuara në Bashkinë e Korçës (Njësia Administrative Korçë,
Qendër Bulgarec, Drenovë, Mollaj)”**

Financuar nga të ardhurat e Universitetit “Fan S. Noli” dhe Buxheti i Shtetit
Korçë, maj 2025

Autorët:

Dr. Ermiona Braholli

Prof. as. dr. Edlira Menkshi

Dr. Ermira Jashiku

Prof. dr. Perikli Qiriaz

Profesor Emeritus Skënder Aliu

Recensues:

Prof. dr. Dhimitër Doka

Prof. dr. Bilal Draçi

Përgatitja për botim dhe redaktimi gjuhësor:

Eftiona Josifi

Foto nga:

Prof. as. dr. Edlira Menkshi

Dr. Ermiona Braholli

Dizajni grafik:

Elena Çapo

ISBN:9789928480873 e-book

Printuar në shtypshkronjën:

Promoprint

Të drejtat e autorit ©

Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë

Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës

DY FJALË PËR AUTORËT

Dr. Ermiona Braholli- lektore në departamentin e Histori-Gjeografisë, në Universitetin "Fan S. Noli", me një përvojë 11-vjeçare në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fushën e gjeografisë, veçanërisht në qarkun e Korçës dhe të Durrësit. Pjesëmarrëse në më shumë se 30 konferenca/ simpoziume ndërkombëtare dhe kombëtare; autore e rreth 15 artikujve shkencor dhe anëtare në një sërë projektsh të kërkimit shkencor. *Anëtare e Redaksisë së Gjeografisë Fizike* në krijimin e Fjalorit Enciklopedik të Shqipërisë 2030.

Prof. as. dr. Edlira Menkshi- lektore në departamentin e Histori-Gjeografisë, në Universitetin "Fan S. Noli", me një përvojë 13-vjeçare në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fushën e gjeografisë, veçanërisht në gjeografinë e turizmit, gjeografinë urbane dhe rurale, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të qarkut Korçë. Pjesëmarrëse në më shumë se 30 konferenca/ simpoziume ndërkombëtare dhe kombëtare; autore e 20 artikujve shkencorë dhe anëtare një sërë projektsh të kërkimit shkencor. Autore e studimit monografik "Trashëgimia natyrore dhe kulturore e qarkut të Korçës: Vlerat dhe përdorimi turistik, 2020".

Dr. Ermira Jashiku lektore në departamentin e Histori-Gjeografisë, në Universitetin "Fan S. Noli", me një përvojë 15-vjeçare në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fushën e gjeografisë, veçanërisht në menaxhimin e risqeve natyrore dhe humane. Pjesëmarrëse në më shumë se 15 konferenca/ simpoziume ndërkombëtare dhe kombëtare; autore e rreth 10 artikujve shkencor dhe anëtare një sërë projektsh të kërkimit shkencor.

Prof. dr. Perikli Qiriazhi- profesor me përvojë mbi 50-vjeçare në fushën e studimeve gjeografike. Autor i disa librave universitarë, si: *Geography of Albania* (2022); *Gjeografia Fizike e Shqipërisë* (2011,

2019), Trashëgimia Natyrore e Shqipërisë (2020); Drejtues i Njesisë së Kërkimit Shkencor në ASH; anëtar i Redaksisë Vendore të Enciklopedisë Shqiptare. Autor i disa shkrimeve shkencore dhe pjesëmarrës në shumë referime kombëtare e ndërkombëtare.

Profesor Emeritus Skënder Aliu- profesor me përvojë mbi 60-vjeçare në fushën e kërkimeve arkeologjike në Shqipëri. Studiues i një sërë sitesh arkeologjike në Rajonin Juglindor të Shqipërisë. Arkeolog në Tumat e Kamenicës, Sovjanit, Progrit etj.

Autor i disa monografive, si: Tuma e Luarasit (2004), Tuma e Rehovës (2012), Kolonja, studime arkeologjike, jeta, kultura dhe identiteti (2021) etj. Pjesëmarrës në një sërë veprimtarish shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTIME	8
LISTA E TABELAVE DHE E FIGURAVE	10
PARATHËNIE	13
BASHKIA KORÇË	16
1.1 Pozita gjeografike dhe roli i saj në popullim dhe zhvillim	16
1.1. Pozita gjeografike	16
1.1.1. Pozita gjeografike dhe komunikimi me treva, qendra urbane, kultura e qytetërime të tjera	16
1.1.2. Pozita në strukturën administrative territoriale të vendit ..	18
I.2 KUSHTET NATYRORE DHE TRASHËGIMIA NATYRORE	21
I.2.1 Konsiderata të përgjithshme	21
I.2.2 Pozicioni dhe ndërtimi gjeologjik	21
I.2.3 Veçori morfologjike dhe morfogjenetike të relievit	22
I.2.4 Klima dhe ujërat	22
1.2.5. Ujërat	27
I.2.6 Brezat e tokave	28
I.2.7 Flora dhe fauna, ekosistemet kryesore	29
I.2.8 Trashëgimia natyrore	32
I.2.9 Njësitë fiziko-gjeografike dhe trashëgimia natyrore e tyre ..	33
I.2.9.1 Fushëgropa e Korçës	33
I.2.9.2 Malësia e Voskopojës	37
I.2.9.3 Malësia e Vithkuqit	40
I.2.9.4 Malet e Moravës	42

I.3 HISTORIA, KULTURA DHE TRASHËGIMIA KULTURORE	45
I.4. VENDBANIMET DHE POPULLSIA	50
I.5 ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PERSPEKTIVA	53
2.1 NJËSIA ADMINISTRATIVE KORÇË (Qyteti i Korçës)	58
2.1.1.Konteksti historik.....	62
2.1.2.Zhvillimi ekonomik.....	73
2.1.3. Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar	76
2.1.4. <i>Muzeu i Arsimit</i> apo Mësonjëtorja e Parë Shqipe	77
2.1.5.Muzeu Arkeologjik	78
2.1.6 Muzeu Bratko.....	79
2.1.7. Fonoteka Sotiri.....	80
2.2 NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR BULGAREC	83
2.2.1. BARÇI.....	86
2.2.2. DISHNICA.....	90
2.2.3. NEVIÇISHTI.....	94
2.2.4. BELORTA.....	97
2.2.5. KUÇ I ZI.....	100
2.2.6. MALAVECI	103
2.2.7. SHAMOLLI.....	105
2.2.8. ÇIFLIG	108
2.2.9. BULGAREC.....	111
2.2.10. BIRANJI	114
2.2.11. LUMALASI.....	117
2.2.12. MELÇAN.....	120

2.2.13. PORODINË	124
2.3. NJËSIA ADMINISTRATIVE DRENOVË	128
2.3.1. DRENOVË	132
2.3.2. MORAVA	136
2.3.3. MBORJE	138
2.3.4 DARDHË	142
2.3.5. BOBOSHTICË	151
2.3.6. QATROM	155
2.3.7. RAVONIK	158
2.3.8. TURAN	161
2.4. NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAJ	165
2.4.1 MOLLAJ (DËVORAN)	169
2.4.2. KAMENICA	173
2.4.3. FLOQ	177
2.4.4. PULAHË	180
2.4.5. UJËBARDHË (BELLOVODË)	183
ANEKS	188
LITERATURA	195

SHKURTIME

ASH	Akademia e Shkencave
J	Jug
L	Lindje
Lmd	Lartësi mbi detare
Nj. A.	Njësi Administrative
OJF	Organizata Jofitimprurëse
P	Perëndim
Shek.	Shekull
TAP	Gazësjellësi i madh ndërkombëtar
V	Veri
vm	Vargmal
ZGjC	Zyra e Gjendjes Civile

LISTA E FIGURAVE, TABELAVE DHE HARTAVE

Lista e Figurave

<i>Fig. 1. Imazh satelitor i qytetit të Korçës, 2025. (Burimi: Google Earth).....</i>	<i>72</i>
<i>Fig.2. Imazh satelitor i fshatit Barç, 2025</i>	<i>89</i>
<i>Fig.3. Imazh satelitor i fshatit Dishnicë, 2025.....</i>	<i>94</i>
<i>Fig.4. Imazh satelitor i fshatit Neviçisht, 2025</i>	<i>97</i>
<i>Fig.5. Imazh satelitor i fshatit Belorta, 2025</i>	<i>100</i>
<i>Fig.6. Imazh satelitor i fshatit Kuç i Zi, 2025).....</i>	<i>103</i>
<i>Fig.7. Imazh satelitor i fshatit Malavec, 2025</i>	<i>105</i>
<i>Fig.8. Imazh satelitor i fshatit Shamoll,.....</i>	<i>108</i>
<i>Fig.9. Imazh satelitor i fshatit Çiflig, 2025.....</i>	<i>111</i>
<i>Fig. 10. Imazh satelitor i fshatit Bulgarec,</i>	<i>113</i>
<i>Fig.11. Imazh satelitor i fshatit Biranj,.....</i>	<i>117</i>
<i>Fig.12. Imazh satelitor i fshatit Lumalas, 2025.....</i>	<i>120</i>
<i>Fig.13. Imazh satelitor i fshatit Melçan,.....</i>	<i>123</i>
<i>Fig.14. Imazh satelitor i fshatit Porodinë,</i>	<i>127</i>
<i>Fig. 15. Imazh satelitor i fshatit Drenovë dhe Moravë.....</i>	<i>134</i>
<i>Fig.16. Imazh satelitor i fshatit Drenovë dhe Moravë,.....</i>	<i>138</i>
<i>Fig.17. Imazh satelitor i fshatit Mborje,</i>	<i>141</i>
<i>Fig.18. Imazh satelitor i fshatit Dardhë.....</i>	<i>145</i>
<i>Fig. 19. Imazh satelitor i fshatit Boboshticë</i>	<i>154</i>
<i>Fig. 20. Imazh satelitor i fshatit Qatrom,.....</i>	<i>158</i>
<i>Fig.21. Imazh satelitor i fshatit Ravonik,.....</i>	<i>161</i>

Fig. 22. Imazh satelitor i fshatit Turan	164
Fig.23. Imazh satelitor i fshatit Mollaj (Dëvoran),.....	171
Fig.24. Imazh satelitor i fshatit Kamenicë, 2025	175
Fig.25. Imazh satelitor i fshatit Floq	179
Fig. 26. Imazh satelitor i fshatit Pulahë.....	183
Fig.27. Imazh satelitor i fshatit Ujëbardhë (Bellovodë)	186

Lista e Tabelave:

Tab.1 Temperaturat mesatare shumëvjeçare mujore e vjetore për Korçën në $^{\circ}\text{C}$.....	25
Tab.2 Minimumet absolute të temperaturës për Korçë në $^{\circ}\text{C}$.....	26
Tab.3 Maksimumet absolute të temperaturës për Korçë në $^{\circ}\text{C}$	26
Tab.4 Sasia mesatare e reshjeve mujore e vjetore për stacionin e Korçës	27
Tab.5. Intesiteti 24 orësh i reshjeve.....	27
Tab.6 Shpërndarja e rrjedhjes, në % për lumenjtë Devoll dhe Osum	29
Tab. 7 Parametrat kryesorë mesatarë vjetorë të rrjedhjes ujore të Devollit dhe Osumit.....	29

Lista e fotove:

Foto 1. Pazari i Korçës	69
Foto 3. Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar	81
Foto 5,6. Tipe të banesave në fshatin Barç.....	91
Foto 7, 8. Pamje të banesave në lagjet e fshatit Dishnicë	95
Foto 9, 10.Pamje të fshatit Neviçisht, 2025	98

<i>Foto 11, 12. Pamje nga lagje dhe tokat e punueshme të fshatit Belorta, 2025(Burimi:.....</i>	<i>101</i>
<i>Foto 13,14. Pamje nga fshati Kuç i Zi , 2025.....</i>	<i>104</i>
<i>Fig.8. Imazh satelitor i fshatit Shamoll,.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<i>Foto 17,18. Pamje të banesave dhe qendrës së fshatit Shamoll, 2025.....</i>	<i>109</i>
<i>Foto 19, 20. Tipi i banesa në fshat dhe kisha e Shën Thomait, ...</i>	<i>112</i>
<i>Foto 23,24. Lagje e vjetër në fshatin Biranj (sipër.....</i>	<i>117</i>
<i>Foto 25. Lagje e fshatit Lumalas, ndërtime 1 dhe 2-katëshe prej guri.....</i>	<i>121</i>
<i>Foto.27 28. Qendra e fshatit Melçan dhe Teqeja e Melçanit,</i>	<i>125</i>
<i>Foto 29, 30. Pamje të fshatit Porodinë</i>	<i>128</i>
<i>Foto 31, 32. Pamje të banesave dhe rrugëve të gurta të fshatit Drenovë, imazh i kishës në qendër të fshatit,</i>	<i>137</i>
<i>Foto 33, 34. Pamje nga qendra e fshatit dhe ndërtimet të formës së pallateve me tulla.....</i>	<i>139</i>
<i>Foto 35. Kisha e Ristožit.....</i>	<i>143</i>
<i>Foto.37. Pamje të kullotave të bagëtive të imta në tokat e fshatit Mborje,</i>	<i>143</i>
<i>Foto .38. Pamje nga peizazhi pyjor i fshatit Dardhë.....</i>	<i>148</i>
<i>Foto 39, 40. Pamje nga fshati Dardhë.....</i>	<i>149</i>
<i>Foto 41. Kisha e Shën Gjergjit,.....</i>	<i>151</i>
<i>Fig. 43. 44. Pamje të fshatit dhe të një banese në fshatin Boboshticë</i>	<i>155</i>
<i>Foto. 45, 46. Qendat dhe pamje nga një lagje e fshatit Qatrom,.</i>	<i>159</i>

<i>Foto.47, 48. Pamje nga qendra e fshatit Ravonik,</i>	<i>162</i>
<i>Foto.49. Pamje të kullës së Turanit, "Monument Kulture",</i>	<i>166</i>
<i>Foto.50, 51. Imazhe nga pallatet 3-katëshe dhe ndërtimet private në fshatin Mollaj (Dëvoran</i>	<i>173</i>
<i>Foto.52,53. Pamje të tokave ara të punuara dhe të mbjella me pemë frutorë.....</i>	<i>174</i>
<i>Foto. 54, 55. Lagjia e Poshtme dhe e mesme e fshatit Kamenicë</i>	<i>178</i>
<i>Foto. 56,57. Pamje nga një prej lagjeve të fshatit Floq dhe qendra e fshatit,.....</i>	<i>181</i>
<i>Foto. 58. Pamje të ndërtimeve dhe infrastrukturës në fshatin Pulahë</i>	<i>184</i>
<i>Foto59, 60. Pamje të fshatit Ujëbardhë dhe të një banese 1-katëshe</i>	<i>188</i>

Lista e Hartave

<i>Harta 1. Bashkia, Njësitë e saj Administrative, qyteti i Korçës dhe vendbanimt rurale (Ndërtuar me Arc GIS 10.1, duke u bazuar te Harta Administrative e Shqipërisë 1:200 000, GC C 1999)</i>	<i>22</i>
<i>Harta 2. Harta fizike e territorit të bashkisë Korçë. (Burimi: Arc GIS 10.1, mbështetur në hartat topografike 1:25 000.....</i>	<i>28</i>
<i>Harta 3. Shtrirja gjeografike e Njësisë Administrative Korçë (Qyteti i Korçës)</i>	<i>60</i>
<i>Harta 4. Zgjerimi i formës urbane të qytetit të Korçës gjatë periudhave historike,.....</i>	<i>67</i>
<i>Harta 5. Shtrirja hapësinore e Nj.A. Qendër Bulgarec.</i>	<i>86</i>
<i>Harta 7 . Shtrirja gjeografike e Njësisë Administrative Drenovë</i>	<i>131</i>
<i>Harta 8. Shtrirja gjeografike e Njësisë Administrative Mollaj, ...</i>	<i>168</i>

PARATHËNIE

Vendbanimet janë qendra të rëndësishme ku njerëzit kanë zhvilluar jetën dhe kanë krijuar për një kohë të gjatë komunitetet e tyre. Transformimet ekonomike, sociale dhe kulturore kanë ndikuar në rritjen dhe zhvillimin e vendbanimeve, nga më të thjeshtat deri tek më komplekset. Në literaturën shkencore në Shqipëri, përpos studimeve shkencore të studiuesve shqiptarë të profileve të ndryshme, nuk ka një botim të mirëfilltë ku të gërshetohen të gjitha njohuritë në trajtimin e vendbanimeve. Me iniciativë të Njesisë së Studimeve Gjeografike dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ka nisur puna për hartimin e një Enciklopedie Gjeografike të Vendbanimeve të Shqipërisë.

Në këtë kuadër ky është studimi i parë që ndërmerret për vendbanimet e Shqipërisë duke ndjekur një qasje shkencore, nisur fillimisht me studimin e vendbanimeve urbane dhe rurale të bashkisë Korçë. Iniciativa e studiuesve të departamentit të Historisë dhe Gjeografisë, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, u parashtrua në një projekt, i cili gjeti mbështetjen financiare të këtij Universitetit për realizimin e tij.

Qëllimi kryesor i projektit konsistoi në përmbushjen e disa objektivave që kishin të bënin me: **1.** krijimin e një fondi të informacioneve dhe të njohurive gjeohapësinore me të dhëna për vendbaniment rurale dhe urbane; **2.** hulumtimin e të dhënave ndërdisiplinore shumëdimensionale me karakter gjeografik, historik, sociologjik, statistik, etnologjik, kulturor etj.; **3.** evidentimin dhe analizimin e situatës së vendbanimeve, transformimit dhe zhvillimit të tyre në aspektin hapësinor, demografik, ekonomik, kulturor dhe mjedisor; **4.** krijimin e një metodologjie të sigurimit të të dhënave në terren, e cila do të përdoret edhe për studimin e vendbanimeve të tjera në vazhdim; **5.** përdorimin e të dhënave dhe informacioneve të siguruara në lidhje me lëvizjet e popullsisë dhe braktisjet e zonave rurale, në lidhje me nivelin e zhvillimit dhe varfërisë, në lidhje me dobësimin e sistemit arsimor në zonat rurale; problemet sociale në lidhje me martesat dhe lindshmërinë; resurset natyrore dhe kulturore për zhvillimin e turizmit etj., në funksion të

politikave dhe strategjive për rijetëzimin dhe zhvillimin e territorit të bashkisë.

Pjesa e parë e monografisë “Vendbanimet e bashkisë Korçë” përfshin studimin e një qendre urbane (qyteti i Korçës) dhe 26 vendbanimeve rurale. Materiali është sistemuar duke filluar nga njësia më e madhe administrative (territori i bashkisë), duke kaluar një njësitë administrative e më pas te qyteti dhe fshatrat e secilës njësi. Materiali fillon me një përshkrim të pozitës gjeografike dhe kushteve natyrore të bashkisë së Korçës, për të vazhduar me Njësinë Administrative Korçë, që përkon me hapësirën territoriale të qytetit; me Njësinë Administrative Qendër Bulgarec dhe 13 fshatrat përbërës së saj; me Njësinë Administrative Drenovë dhe 8 fshatrat përbërës së saj dhe në fund me Njësinë Administrative Mollaj me 5 fshatrat përbërëse të saj. Në realizimin e këtij materiali studimor janë angazhuar profesorë të disiplinave të gjeografisë (fizike dhe humane), arkeologjisë, historisë, të cilët, nëpërmjet shfrytëzimit të literaturës dhe burimeve arkivore, mundësuan sigurimin e të dhënave në lidhje me gjeologjinë, kushtet fiziko-natyrore, popullsinë, migrimin, ekonominë, zhvillimin urban, zhvillimin rural, trashëgiminë natyrore dhe kulturore, trashëgiminë shpirtërore etj.

Një pikë të fortë të studimit për sigurimin e të dhënave përbën puna në terren përmes plotësimit të një ankete me komunitetin e qendrave administrative të përfshira në studim. Në pjesën e parë të anketës u siguruan të dhëna fiziko-gjeografike të vendbanimeve, si: pozita gjeografike, gjeologjia dhe gjeomorfologjia, klima, hidrografia, bimësia dhe tokat; në pjesën e dytë u siguruan të dhëna për zhvillimin historik dhe popullsinë, si: emërtimi i vendbanimit, historiku i krijimit, popullsia para viteve 90’ (lindjet, vdekjet, shtimi i popullsisë), popullsia pas viteve 90’ (migrimi), trashëgimia natyrore dhe kulturore; në pjesën e tretë u siguruan të dhëna për organizimin hapësinor të vendbanimit si, forma e vendbanimeve, arkitektura dhe infrastruktura; në pjesën e katërt të dhëna për zhvillimin ekonomik si veprimtaritë ekonomike primare (bujqësi, blegtori, pylltari), aktivitetet sekondare

dhe ato terciare. Një rëndësi të veçantë në studim përbën trajtimi i qytetit të Korçës si qendra më e rëndësishme urbane në qarkun e Korçës dhe në të gjithë rajonin juglindor.

Projekti "Vendbanimet e Bashkisë Korçë, Njësitë Administrative Korçë, Qendër Bulgarec, Drenovë dhe Mollaj", përbën pjesën e parë të studimit të vendbanimeve në qarkun e Korçës, studim i cili do të vazhdojë më tej, me realizmin e studimit për qendrat e tjera të banuara urbane dhe rurale.

Në përfundim, departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë falënderon Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës për ndihmesën financiare dhe Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për bashkëpunimin e suksesshëm. Një falënderim i veçantë shkon për prof. dr. Perikli Qiriazin, si ideatori dhe iniciuesi i këtij studimi, si dhe Prof. Emeritus Skënder Aliu, për kontributin e tij në studimet arkeologjike të qarkut. Studimi do të kishte qenë i paplotë pa ndihmesën e kryetarëve të Njësitë Administrative të bashkisë, si edhe pa komunitetin, të cilët i falënderojmë për gjithë të dhënat dhe informacionet që na mundësuan gjatë punës në terren.

Korçë, maj 2025

**Drejtuesi i projektit
Dr. Ermiona Braholli**

BASHKIA KORÇË

1.1 Pozita gjeografike dhe roli i saj në popullim dhe zhvillim

1.1. Pozita gjeografike

Bashkia e Korçës, me shtrirje veri-jug 30 km dhe lindje-perëndim 53 km, me sipërfaqe 827 km², shtrihet në juglindje të Shqipërisë, midis koordinatave 40° 25' 37" e 40° 42' 06" gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 21' 51" dhe 20° 51' 45" gjatësi gjeografike lindore; në njësinë e madhe fiziko-gjeografike Gropat Juglindore dhe malet përreth tyre dhe në rajonin gjeografik Juglindor të Shqipërisë; në sistemin më të zhvilluar të horsteve dhe grabeneve pliokatere në zonën tektonike të Mirditës, të përbëra nga larmi formacionesh sedimentarë e magmatikë dhe me reliev të larmishëm tipesh gjenetike dhe formash (gropa, fushgropa, lugina, kodra, male, blloqe malore etj.); në zonën klimatike mesdhetare paramalore jugore dhe mesdhetare malore juglindore; në pellgun ujëmbledhës të lumit Devoll dhe pjesërisht të Osunit; kryesisht në brezin e tokave të kafenjta dhe të murme pyjore; në katet bimorë të dushqeve, ahishteve e halorëve dhe të kullotave alpine. Kjo pozitë gjeografike ndikon fuqishëm në larminë e theksuar të peizazheve, ekosistemeve, habitateve, në trashëgiminë e pasur natyrore; në pasuritë e mëdha minerare, energjetike, morfologjike të relievit, klimatike, ujore, pedologjike, floristike dhe faunistike. Që në lashtësi dhe në vijim, këto pasuri krijuan kushte shumë të përshatshme për popullim të dendur dhe mundësi të mëdha për zhvillim social-ekonomik.

1.1.1. Pozita gjeografike dhe komunikimi me treva, qendra urbane, kultura e qytetërime të tjera

Rajoni Juglindor, ka gjurmë humane që nga Paleoliti i Mesëm (Aliu, 2015; Ceka, 2020). Me tokën pjellore, klimën e shëndetshme, liqenin e Maliqit, të pasur me peshq, lidheshin vendbanimet e shumta neolitike në fushën e Korçës, e cila rrezatonte zhvillim në zonat përreth. Me pozicionin nyje midis lindjes dhe perëndimit, Korça mbeti qendra e

qytetërimit edhe në periudhat pasuese deri në kohët e fundit. Sipas T. Selenicës (1927) Korça renditej në qytetet më të mëdha të vendit.

Për të gjitha kohërat, rajoni Juglindor ka pasur dhe ka rolin e një nyjeje të madhe, ku kryqëzohen rrugë dhe korridore ndërkombëtarë midis perëndimit e lindjes, veriut dhe jugut, të iniciuara dhe të ndërtuara që në lashtësi e antikitet, me vlera në rritje në periudhat vijuese. Dallohet rruga Egnatia, si bosht horizontal lidhës i trevave e qytetërimeve perëndimore e lindore, rrugët lidhëse me korridorët e tjerë horizontalë, që përshkonin Ilirinë e Arbërinë dhe rruga Manastir – Korçë – Janinë, me shtrirje veri – jug. Këto rrugë mundësuan shkëmbimin e mallrave, njerëzve dhe kulturave midis rajoneve të afërta dhe të largëta.

Edhe në kohën e sotme roli i rrugëve dhe korridorëve ndërkombëtarë është i madh në integrimin e zhvillimin social-ekonomik të rajonit dhe gjithë vendit. Dallohet Korridori VIII (tetë), ose si quhet ndryshe, Egnatia e Sotme, shtrirja e rrjetit energjetik (Gazsjellësi i Madh ndërkombëtar- TAP), në të ardhmen dhe e rrjetit hekurudhor, të cilët kalojnë edhe në Rajonin Juglindor e bashkinë e Korçës.

Në të njëjtën kohë, pozita ndërkufitare e rajonit me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut, ka bërë që në territorin e bashkisë së Korçës të kalojnë akse të rëndësishme të komunikimi, që lidhin Shqipërinë me Ballkanin Juglindor e më gjerë. Përmirësimi në vitet e fundit i rrugëve automobilistike si dhe lidhja me dy shtete fqinje Republika e Greqisë dhe e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet disa pikave doganore, jo larg nga Korça: Kapshticës (35 km), Tushemisht (43 km), Goricës (46 km), Qafë Thanës (65 km) dhe Tri Urat (98 km), kanë mundësuar zhvillimin social dhe ekonomik të kësaj bashkie dhe gjithë Rajonit Juglindor.

Rrugët e sotme automobilistike, të përmirësuara ndjeshëm kohët e fundit, mundësojnë lidhjen e bashkisë së Korçës me bashkitë e tjera të vendit. Distanca rrugore nga kryeqyteti është 162.5 km; nga Durrësi 199.7 km; nga qyteti i Gjirokastrës 196 km; nga Kosturi 65 km dhe Selaniku 246 km.

Si qendër e një rajoni të madh, Korça ka rrezatuar zhvillim, kulturë, emancipim. Drejt saj gravitonin gjithë zonat përreth: Manastiri, Kërçova, Ohri, Struga, Pelagonia, Kosturi, Follorina, Devolli, Pogradeci, Mokra, Gora, Voskopoja, Vithkuqi, Opari, Kolonja, etj. Këtë rol e humbi pas vendosjes së padrejtë të kufijve të vitit 1913, që lanë jashtë Shqipërisë rreth gjysmën e territorit dhe të popullsisë së atëhershme shqiptare. Edhe pjesa më e madhe e rajonit të Korçës mbeti

jashtë Shqipërisë. Ky kufi ndërpreu rrugët e komunikimit me qendrat e mëdha të lindjes; Korça humbi rolin e nyjes midis lindjes e perëndimit, sidomos gjatë periudhës komuniste, kur u ngrinë kufijtë shtetërorë (Qiriazi, 2024).

Me ndërrimin e sistemit dhe hapjen e kufijve, pas vitit 1990, Korça, si qendra më e madhe urbane, me tradita të pasura zhvillimore e kulturore, i ka të gjitha mundësitë të jetë qendra e Eurorajonit Ndërkufitar të Korçës, në përbërje të të cilit hyjnë të gjitha zonat, që tradicionalisht gravitonin drejt saj. Kjo do të krijonte kushte për integrim e zhvillim të shpejtë e të qendrueshëm socio-ekonomik në këtë eurorajon dhe gjithë vendin, do të thellonte mirëkuptimin dhe bashkëpunimin midis shqiptarëve, grekëve, maqedonasve etj.

Natyrisht, kjo do të bëhet realitet kur të ndërmerren studime të thelluara, gjithëpërfshirëse, multidisiplinore për vendbanimet dhe, duke aplikuar konceptet e sotme të BE-së, të shtrihen në studimin e rajonit, eurorajoneve ndërkufitare dhe zhvillimeve rajonale, të cilësuar albanologjike. Jo vetëm kaq: kjo kërkon nga qeveritë vendore e qendrore të vendeve përkatëse vullnet dhe veprime konkrete për bashkëpunim dhe mirëkuptim në zgjidhjen, me projekte të studiuara e të përbashkëta, të sfidave të shumta, me të cilat po përballen natyra dhe zhvillimi socio-ekonomik i këtij eurorajoni ndërkufitar.

Theksojmë se këto përparësi të pozitës gjeografike të qarkut dhe bashkisë së Korçës duhet të njihen dhe të vlerësohen si mundësi të mëdha për zhvillimin social-ekonomik dhe për integrimin e rajonit me rajonet e tjera brenda dhe jashtë vendit.


1.1.2. Pozita në strukturën administrative territoriale të vendit

Bashkia e Korçës gjendet në qendër të Rajonit Juglindor dhe të qarkut të Korçës, ku gjenden edhe këto bashki të tjera: Maliqi në V, Devolli në L, Pusteci në VL, Pogradeci në V dhe Kolonja në J. Njëherazi, bashkia e Korçës, në P. kufizohet edhe me bashkinë Përmet (qarku Gjirokastrë) dhe Skrapar (qarku Berat).

Si të gjitha bashkitë e tjera të vendit edhe në bashkinë e Korçës janë diferencuar këto njësi administrative: Korçë, Qendër Bulgarec me 13 fshatra, Voskop me 7 fshatra, Voskopojë me 5 fshatra, Lekas me 11 fshatra, Vithkuq me 13 fshatra, Mollaj me 5 fshatra dhe Drenovë me 8 fshatra. Githësej bashkia e Korçës ka 8 njësi admimintrative, 62 fshatra

dhe 1 qytet, Korça, e cila është qendra urbane e bashkisë Korçë, qendra e qarkut dhe njëkohësisht një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike dhe kulturore në Shqipëri.

Në këtë studim analizohen vetëm 4 njësi administrative: qyteti i Korçës, Qendër Bulgarec, Mollaj dhe Drenovë dhe 26 vendbanime rurale. Në një studim të dytë do të analizohen edhe njësitë e tjera administrative dhe fshatrat e tyre.



Harta 1. Bashkia, Njësitë e saj Administrative, qyteti i Korçës dhe vendbanimet rurale (Ndërtuar me Arc GIS 10.1, duke u bazuar te Harta Administrative e Shqipërisë 1:200 000, GC C 1999)

Duhet theksuar se njësitë administrative formojnë entitete natyrore, sociale, ekonomike dhe administrative. Ato administrohen nga kryetari i emëruar dhe nga një administratë e vogël për të zgjidhur disa kërkesa urgjente të popullsisë, ndërsa çdo fshat ka kryetarin e tij (më parë përdorej termi kryeplak).

Njësitë administrative dallohen për trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore, tradita të hershme mjaft të shprehura dhe të trashëguara brez

pas brezi. Banorët e tyre janë të lidhur shpirtërisht me këto tradita dhe me vendbanimin, duke e individualizuar koshiencën, lidhjet e tyre shpirtërore me fshatin dhe me gjithë njësinë e tyre administrative. Sistemi rrugor, i hershëm dhe i ri, duke mundësuar marrëdhëniet e banorëve brenda njërive, midis tyre dhe me qytetin e Korçës, i ka zgjeruar këto lidhje shpirtërore në shkallë bashkie, madje, qarku dhe rajoni. Banorët e këtyre njërive prej kohësh, e bënin pazarin, madje vazhdojnë ta bëjnë, në Korçë, ku blejnë mallrat industriale apo të artizanatit dhe shesin prodhimet e tyre bujqësore e blegorale; sigurojnë shërbimin arsimor më cilësor parauniversitar dhe sidomos universitar, shëndetësor, bankar, tregtar, kulturor, administrativ etj. Kjo lidhje shekullore midis fshatrave dhe qytetit vazhdon të ruhet edhe aktualisht, duke unifikuar kështu gjithë bashkinë në aspektin social, ekonomik dhe shpirtëror, me të cilin lidhet koshienca dhe identiteti i tyre korçar. Natyrisht si në gjithë vendin tonë, dhe jo vetëm, edhe në njësitë administrative, sidomos rurale malore, për shkak të globalizmit, presionit të madh të kulturave të tjera, gjendjes ekonomike, nevojave normale të njerëzve për të parë vende të reja, për të jetuar më mirë, popullsia ka migruar e migron në masë. Kjo ka boshatisur fshatra të tërë malorë dhe, natyrisht, veç të tjerave, ka tronditur rëndë koshiencën regjionale, lidhjet shpirtërore me vendbanimin. Zgjidhja e këtij problemi të madh kombëtar do të kërkonte ndërtimin e strategjive dhe programeve të zhvillimit të qendrueshëm, sidomos të turizmit, për të cilin ka resurse të mëdha natyrore, kulture dhe tradita shumë të pasura.

I.2 KUSHTET NATYRORE DHE TRASHËGIMIA NATYRORE

I.2.1 Konsiderata të përgjithshme

Territori i bashkisë Korçë dallohet për kompleksitetin dhe larminë e theksuar fiziko-gjeografike, të shprehur në shumëllojshmërinë e strukturave dhe të formacioneve gjeologjike, të morfologjisë dhe morfogjenezës së formave të relievit, të klimës, ujërave, tokave, florës e faunës, ekosistemeve e habitateve, të peizazheve dhe komplekseve fiziko-gjeografike. Ndryshimet janë më të shprehura në drejtim vertikal, nga fusha në kodrat e malet. Me këtë larmi lidhen resurset e mëdha natyrore, bazë për zhvillimin e qendrueshëm social-ekonomik.

I.2.2 Pozicioni dhe ndërtimi gjeologjik

Me shtrirjen e territorit të bashkisë në sistemin më të zhvilluar në Shqipëri të horsteve dhe grabeneve plioaternare të zonës tektonike Mirdita dhe me mbizotërimin e regjimit neotektonik në tërheqje me intensitet shumë të madh në këtë sistem lidhet larmia litologjike dhe strukturore e ndërtimit gjeologjik të këtij territori. Ky territor ndërtohet nga formacione sedimentare (gëlqerore, flishi dhe molase) dhe magmatike, kryesisht ultrabazike. Këto formacione ndërtojnë struktura shkëputëse (horste dhe grabene) dhe rrudhosëse (antiklinale, sinklinale, monoklinale). Gjatë evolucionit morfotektonik të tij u individualizuan këto njësi kryesore me tipare morfostrukturore e morfogjenetike të diferencuara qartë (Qiriazi, 1985):

- Ngritje të larta malore, të formuara në struktura gjeologjike me prirje të theksuar ngritëse neotektonike dhe të modeluara nga faktorët e jashtëm gjatë evolucionit kontinental. Në territorin e bashkisë nga kjo njësi bëjnë pjesë malësia e Voskopojës dhe Vithkuqit, si dhe malet e Moravës.

- *Gropat e reja* (pliocenike e plioaternare) grabenore të formuara nga tektonika në zgjerim (Aliaj, 2012). Ato u themeluan qysh në fillim të pliocenit në formën e pellgjeve liqenore (Kolonjë, Bilisht, Prespë, Prenjas, Korçë) dhe u ripërtërinë gjatë plioaternarit, që u shoqërua me rindërtimin strukturor (Çeravë, Korçë, Ohër, Prespë, Përrenjas). Në ndryshim nga të tjerët, grabeni i Korçës u përfshi nga lëvizje

neotektonike me prirje të vazhdueshme ulëse. Ndaj, u formua fushëgropa e madhe e Korçës, me taban krejt të rrafshët dhe rrethuar me kurrize malore. Gjatë kësaj kohe u thanë disa nga liqenet, midis tyre edhe liqeni që mbulonte grabenin e Korçës. Në bashkinë Korçë, shtrihet pjesa më madhe kësaj fushëgroe.

I.2.3 Veçori morfologjike dhe morfogjenetike të relievit

Relievi i bashkisë dallohet për morfografi tepër të ndërlikuar dhe të larmishme: fusha e rrafshët, lugina me drejtime dhe forma të ndryshme: V-je, U-je, kanion të shkallëzuar, kodra të buta dhe të copëtuara, pllaja, gropore, male e vargje malore të larta dhe të thepisura, forma erozive, karstike, akullnajore, terrene të degraduara e të shkretirizuara.

Relievi i bashkisë shtrihet nga rreth 500 m lmd (përroi i Panaritit), në 2383 m lmd (mali i Ostrovicës), duke shënuar amplitudën hipsometrike 1883m, me të cilën lidhet shkallëzimi vertikal i kateve klimatike, tokave dhe bimësisë. Njëherazi pakësohen e zvogëlohen vendbanimet dhe popullsia e tyre ndryshon fizionomi, strukturë, ndryshojnë funksionet dhe karakteri i aktivitetit jetësor e ekonomik të tyre.

Mbizotërojnë lartësitë 500 – 1000m, të cilat zenë 20.07% të territorit. Pas tyre vijnë lartësitë mbi 1000 m me 79.09 %, ndërsa mbi 2000 m vetëm 0.84 %. Siç shihet relievi ka karakter dominues kodrinor-malor.

Mbizotëron tipi i relievit strukturor, me të cilin lidhen relievet e formuara në grabenet dhe horstet, në struktura antiklinale, sinklinale dhe monoklinale, përgjatë shkëputjeve të mëdha tektonike. Shtrirje të madhe ka relievi litologjik, në të cilin dallohet relievi karstik në gëlqerorët e Ostrovicës, relievi eroziv në formacionet flishore dhe molasa, relievi i formuara në formacione magmatike, sidomos në masivet ultrabazike të Moravës, Voskopojës, pragut të Qarrit etj., me tipare të veçanta. Nuk mungojnë as format akullnajore në lartësitë e Ostrovicës, Shullërit të Madh, Malit të Zi (ku ka edhe dy liqene akullnajore) në pllajën e Rungajës etj.

I.2.4 Klima dhe ujërat

Klima e territorit të bashkisë është mesdhetare paramalore J dhe mesdhetare malore JL, por pozicioni në brendësi të vendit kushtëzon

shfaqejen e dukshme të ndikimit të klimës kontinentale, sidomos gjatë periudhës së ftohtë të vitit (Akademia e Shkencave, 1990). Këto dy nënzona klimatike lidhen me amplitudën e madhe hipsometrike të territorit bashkiak, që kushtëzon vlera dhe tipare të ndryshme të elementëve klimatikë. Në fushëgropën e Korçës klima është mesdhetare paramalore jugore, ndërsa në malin e Moravës dhe në malësinë e Voskopojës e Vithkuqit klima është mesdhetare malore juglindore. Në përgjithësi klima e bashkisë Korçë dallohet për dimër të ftohtë dhe të gjatë dhe verë e freskët dhe të shkurtër.

Në bashkinë e Korçës temperaturat mesatare shumëvjeçare vjetore ndryshojnë nga rreth 8-9°C (Voskopojë) në 10.5°C (Korçë). Temperatura mesatare e janarit ndryshon nga 0.2°C (Sheqeras) në (Korçë). Ditët e akullta vërehen nga muaji tetor deri në muajin prill, por ka raste edhe më vonë (fund prilli-fillim maji 2025 etj.). Në total takohen rreth 40-50 ditë (Korçë) në 131 ditë (Voskopojë) me temperaturë negative. Minimumi absolut prej - 26.9°C është regjistruar në Sheqeras (fshat i bashkisë së Maliqit, në kufi me bashkinë e Korçës), ndërsa në Korçë ka arritur - 20.9°C (28.1.1963). Temperatura shumë të ulëta takohen në gjithë muajt e vitit. Në Korçë janë regjistruar 0°C (maj), - 10.5°C (prill), 0.5°C (shtator) etj.

Temperaturat mesatare më të larta takohen në korrik ose në gusht. Ato ndryshojnë nga 18°C (Voskopojë) në 20.2°C (Korçë). Maksimumet absolute të tempertaturës ndryshojnë nga 33°C (Voskopojë) në 37°C (Korçë, 26.07.1965). Vlera të mëdha marrin amplitudat midis temperaturave skajore në Korçë, 61°C; Voskopojë, 59°C dhe Sheqeras, 63°C. Kjo flet për pasigurinë e theksuar termike të klimës.

Tab.1 Temperaturat mesatare shumëvjeçare mujore e vjetore për Korçën në °C

Muaj	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet
Korçë	0,5	2,2	4,9	9,2	13,9	17,6	20	20,2	16,5	11,3	6,8	2,5	10,5

Burimi: *Instituti Hidrometeorologjik. Klima e Shqipërisë (Manuali temperaturës), 1980*

Tab.2 Minimumet absolute të temperaturës për Korçë në °C

	I	II	III	IV	V	VI	VI I	VI II	IX	X	XI	X II	Vje t	Data
Korçë	- 20. 9	- 17. 3	- 16. 5	- 10. 5	0	2.6	4.9	6.6	- 0.5	- 7.4	- 9.9	- 1 9	- 20. 9	28.1. 1963

Burimi: *Instituti Hidrometeorologjik. Klima e Shqipërisë (Manuali temperaturës), 1980*

Tab.3 Maksimumet absolute të temperaturës për Korçë në °C

	I	II	III	IV	V	V I	V II	VII I	IX	X	X I	X II	Vjet	Data
Korçë	17. 4	21 .8	26 .3	26 .7	31 .6	3 4. 3	3 7	36. 5	33 .1	27. 6	2 2. 1	1 6. 1	37	26.07.19 65

Burimi: *Instituti Hidrometeorologjik. Klima e Shqipërisë (Manuali temperaturës), 1980*

Bashkia dallohet për reshje mesatare vjetore më të pakta në vendin tonë, nga 620 mm/vit (në veri të fushëgropës së Korçës), 789 mm/vit (Korçë) në 900-1000mm/vit në malin e Ostrovicës. Takohen rreth 110-120 ditë me reshje në vit.

Reshje kanë regjim të çrregullt, mesdhetar. Janë përqëndruar kryesisht gjatë gjysmës së ftohtë të vitit, rreth 60% të reshjeve vjetore. Stina më e lagësht është vjeshta me rreth 34% (Korçë) të reshjeve vjetore. Pas saj vjen dimri me rreth 30%, stina e pranverës me rreth 27% dhe stina e thatë e verës me rreth 10% të tyre. Kjo tregon se klima mesdhetare, por në brendësi karakteri mesdhetar i saj, po dobësohet. Këtu shfaqet ndikimi i klimës kontinentale, që nuk arrin të bëhet mbizotëruese.

Karakter i çrregullt i regjimit të reshjeve shprehet edhe në *vlerat e larta të intensitetit* të tyre, 73,9 mm/24 orë (Sheqeras, më 15.11.1962), 77 mm/24 orë (Korçë më 15.11.1962). Ky karakter i çrregullt i regjimit të reshjeve shprehet edhe në *ndryshimet e theksuara midis sasive të reshjeve* të rëna për të njëjtën periudhë, por në vite të ndryshme. Në vitin 1961 ranë 423 mm në fushëgropën e Korçës (Qendra e Studimeve Gjeografike, 1990). Nuk kanë munguar vitet me sasi reshjesh gati

dyfishi i mesatares. Takohen 110-120 ditë me reshje, më të shumta në dimër dhe më të pakta në verë.

Tab.4 Sasia mesatare e reshjeve mujore e vjetore për stacionin e Korçës

	I	II	III	IV	V	VI	VI I	VI II	IX	X	XI	XI I	Vje t
Korçë	7 8	73	59	60	74	42	32	31	48	85	10 9	98	789

Burimi: *Instituti Hidrometeorologjik. Klima e Shqipërisë (Manuali reshjeve), 1980*

Tab.5. Intesiteti 24 orësh i reshjeve

Mua ji	I	II	III	IV	V	V J	V II		V II I	I X	X	X I	X II	Vjet	Data
Kor çë	5 0	41	32	52	5 0	6 0	4 9		4 5	6 3	5 5	7 7	6 6	77	15.11. 1962

Burimi: *Instituti Hidrometeorologjik. Klima e Shqipërisë (Manuali reshjeve), 1980*


Shumica e reshjeve bie në formën e shiut. Dëbora, e cila bie sidomos në rajonet e larta, takohet në gjithë territorin e bashkisë, por sasia e rënies, kohëzgjatja dhe trashësia e shtresës së saj rritet nga rajonet e ulëta (disa centimetra deri në 1 ditë në vit) në rajonet e larta malore (mbi 150 cm dhe rreth 100 ditë në vit). Ky ndryshim është rezultat i rritjes së lartësisë së relievit dhe i ndikimit kontinental në brendësi e në lindje. Për të njëjat shkaqe, ndryshon koha e rënies, e shfaqjes së shtresës së dëborës dhe e trashësisë së saj.

Ka patur edhe disa raste të veçanta të rënies së dëborës, si në prill të 2014, madje edhe në maj 2025 në Korçë, kohë kur disa pemë frutore kishin lulëzuar.

Edhe për bashkinë e Korçës pasuritë klimatike janë të mëdha. Periudha me zero biologjike 5°C në Korçë arrin 254 ditë; periudha vegjetative

me zero biologjike 10°C zgjat rreth 180 ditë; periodha me temperaturë 15°C zgjat deri 60 ditë (Instituti Hidrometeorologjik, 1980).

Në pasuritë e tjera klimatike theksojmë: *dritë e mjaftueshme* për zhvillimin e bimësisë. Ndriçimi i diellit rreth 2000 orë/vit krijon kushte për shfrytëzimin e energjisë diellore për ekonominë; *sasia e konsideueshme e reshjeve dhe e dëborës* krijon rezerva ujore për hidroenergjinë, për furnizimin e qendrave të banuara, bujqësisë, industrisë, turizmit etj.; *mbizotërimi i motit të kthjellët* gjatë verës krijon kushte për zhvillimin e turizmit. Nuk mungon klima malore, tepër e pëlqyeshme nga turizmi. Por, klima ka edhe dukuri negative. Ecja e kundërt e temperaturës dhe e reshjeve krijon vështirësi në zhvillimin e bujqësisë, furnizimin me ujë të industrisë, turizmit, vendbanimeve etj. Pasoja të dëmshme ka *karakteri kapricioz* i klimës, shumë i shprehur sidomos kohët e fundit.



Harta 2. Harta fizike e territorit të bashkisë Korçë. (Burimi: Arc GIS 10.1, mbështetur në hartat topografike 1:25 000 me emërtesa: K-34-126-A-c; K-34-125-B-a; K-34-126-A-d; K-34-114-D-c; K-34-114-C-d; K-34-114-C-c; K-34-125-D-b; K-34-126-C-b; K-34-126-C-a; K-34-125-B-b; K-34-125-B-d; K-34-126-A-a; K-34-126-A-b; K-34-126-B-a; K-34-126-B-c;)

1.2.5. Ujërat

Territori bashkisë i përket pellgut ujëmbledhës të dy degëve të mëdha të Semanit, Devollit dhe Osumit. Ai përshkohet nga disa degë të tyre, më tepër në formën e përrenjve. Devolli buron nga mali i Badaroshës, ka gjatësi 196 km, me pellg ujëmbledhës të përbërë kryesisht nga flishi, molasa dhe pjesërisht gëlqerorë dhe me sipërfaqe 3130 km², lartësi mesatare 960 m lmd, prurje mesatare 49.5 m³/sek dhe me modul rrjedhjeje 16 l/sek/km². Nga territori i bashkisë në studim merr disa degë, si Dunaveci, i cili, me rrjedhje J-V, përshkon fushëgropën e Korçës dhe derdhet në Devoll; me përrenj të malorë Voskopojës, Gjergjevicës, Çëmericës etj. përfundojnë në grykën e Devollit. Osumi zë fill në lartësitë e Rungajës të malësisë së Vithkuqit, ka gjatësi 161 km, sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 2150 km² dhe lartësi mesatare 828 m md, prurje mesatare 32.5 m³/sek dhe model rrjedhjeje 17.5 l/sek/km². Nga territori i bashkisë në studim merr disa degë, si përroi i Panaritit, i Lubonjës etj.

	Periudha		Dimër	Pranverë	Verë	Vjeshtë
Lumi	Ujëshumë	Ujëpak				
Devoll	95	5	39	39	7	15
Osum	95	5	41	36	8	15

Tab.6 Shpërndarja e rrjedhjes, në % për lumenjtë Devoll dhe Osum

Burimi: *Instituti Hidrometeorologjik, Hidrologjia e Shqipërisë, 1985*

Tab. 7 Parametrat kryesorë mesatarë vjetorë të rrjedhjes ujore të Devollit dhe Osumit

Devolli	3130	960	49.5	15.8	500	0.47
Osumi	2073	828	32.5	15.7	494	0.45

Burimi: *Instituti Hidrometeorologjik. Hidrologjia e Shqipërisë, 1985*

Lumenjtë kanë regjim të çrregullt, prurje maksimale në periudhën e largët të vitit dhe minimale, deri në shterim, në periudhën e thatë.

Përbërja kryesisht terrigjene e pellgjeve ujëmbledhës, pjerrësia e shpateve, zhveshja bimore etj., kushtëzojnë prurje të mëdha të ngurta, të cilat shpesh marrin formën e rrjedhjeve të baltës.

Në hidrografinë e bashkisë janë disa burime të mëdha karstike edhe dy liqene akullnajore në Malin e Zi, me përmasa të vogla, drejt kënetëzimit e moçalizimit dhe me disa ujëmbajtës artificiale për ujitje. Më i madhi është ujëmbajtësi i Gjançit, ujët e të cilit përdoren për energji elektrike (H/C i Ujëbardhës) dhe ujitje të tokave të fushëgropës së Korçës.

1.2.6 Brezat e tokave

Takohen kryesisht tokat e kafenjta dhe të murme pyjore, ndërsa tokat livadhore malore kanë shtrirje të kufizua, mbi 1700 m lmd.

- *Tokat e kafenjta (kambisol, luvisol, leptosol, vertisol)*. Kanë shtrirje më të madhe, ndodhen në 600-1000 m, lmd. Formohen mbi shkëmbinjtë sedimentarët dhe më pak mbi ata magmatikë; nën pyjet e dushqeve, që dikur mbulonin sipërfaqe shumë më të gjera; në reliev të ndryshëm dhe me pjerrësi jo të vogla, të përfshirë nga erozioni i fuqishëm; në klimën më të ngrohtë se e dy brezave më të sipërm, me reshje vjetore 600-1000 mm dhe temperatura mesatare vjetore 14-17°C, me amplituda të madhe ditore, që fuqizon procesin e tjetërsimit. Kanë strukturë granulare, profili të thellë deri në 1.20-1.5 m; përmbajtje humusi në sipërfaqe 4-9%, ndërsa në thellësi jo më shumë se 1% (Veshi, 1986). Tokat e kafenjta ndahen në të kafenjta tipike, gëlqerore, të kuqe, të zeza, livadhore të kafenjta etj. (Veshi, 1986). Në to kultivohen me sukses drithërat, bimët industriale, vreshtat, drufrutorët etj. Për përmirësimin e tyre kërkohen përdorimi i masave agroteknike, si punimi, ujitja me metoda moderne, kullimi, plehrimi organo-mineral, masa kundër gërryerjes etj.

Tokat e murme pyjore (të pyjeve të ahut e të pishës) ose kambisol, leptisol, phaeoziem. Shtrihet në 1000-1600 m lmd. Zhvillohen mbi shkëmbinj terrigjenë, gëlqerorë, magmatikë. Formohen në reliev shumë të copëtuar dhe të gërryer fuqimisht; në klimë mesdhetare paramalore dhe mesdhetare malore të lagët e të ftohtë, nën pyjet e ahut e të halorëve. Kanë profil 80-140 cm të trashë. Përmbajnë deri 20 % humus. Në vartësi të kushteve të formimit, tipareve morfologjike dhe

kimike, këto toka ndahen në shtatë nëntipe: të murme pyjore tipike, të kuqërremta, të zeza, të shpërlara, livadhore dhe karbonato-humusore. Në këto toka zhvillohen shumë mirë pyjet e ahut dhe të halorëve, kultivohen disa lloje kulturash: thekra, gruri, patatja, molla, qershia, kumbulla, gështenja etj. Përmirësimi i tyre kërkon mbrojtjen nga erozioni, pastrimin e gurrëve dhe korigjimin e reaksionit acid etj. Braktisja e tyre i rrezikon nga degradimi e shkretëtirizimi.

- Tokat livadhore malore ose tokat e maleve të larta (*kambisol* dhe *leptosol*) (Cara, 1997). Shtrihen mbi lartësitë 1600 m të Ostrovicës dhe Rungajës. Formohen kryesisht mbi gëlqerorë e terrigjenë, në relief heterogjen, i copëtuar e pjerrësi të mëdha; në kushtet e klimës më të ashpër: dimër i ashpër me reshje kryesish dëbore, vera e freskët dhe me reshje të konsiderueshme; nën bimësinë barishtore të kullotave alpine me periudhë vegjetacionit të shkurtër. Përmbajnë 17-25% humus. Kanë profil rreth një metër të trashë, përbërje mekanike subargjlore të mesme dhe reaksion acid (pH 4-5.6), ndërsa mbi gëlqerorët janë neutrale ose pak acide (Veshi, 1986). Në vartësi të kushteve të formimit, tipareve morfologjike dhe kimike, tokat livadhore malore ndahen në katër nëntipe: tipike, të zeza, të thata dhe livadhore të pyjeve të djerrit (Gjoka & Brahushi, 2012). Në këto toka zhvillohet bimësi e dendur, që shfrytëzohet si kullota gjatë verës. Një pjesë e tyre janë kultivuar me patate, me prodhim të mirë, ndërsa në zonat më të ulta me thekër dhe elb. Për të rritur pjellorinë duhet të mbrohen nga erozioni etj.

- Tokat moçalike, hidromorfe (*vertisol*, *kambisol*, *kastanozem*, *gleisol*). Gjenden në pjesën veriore të fushëgropës së Korçës. Tharja e kënetës së Maliqit dhe bonifikimi i tokave në vitet '50 të shekullit të kaluar i kthyen në toka pjellore. Si rrjedhojë e dekompozimit jo të plotë të lëndës së bollshme organike të rezultuar nga bimësia e pasur higrofile, në këto toka formohet një shtresë e trashë torfe¹, e cila, në ish-kënetën e Maliqit arrin trashësinë 8 m etj.

I.2.7 Flora dhe fauna, ekosistemet kryesore

Territori i bashkisë dallohet edhe për florë dhe faunë të larmishme.

¹ Torfa përbëhet nga mbetje bimore në stadi të ndryshme të zbrërthimit anaerob dhe zë pjesën kryesore të komponentit organik të tokave moçalike

Takohen tre kate bimore:

- *Kati i dushqeve*: Shtrihet në formën e një brezi nga 800-1250 m lmd (Qendra e studimeve Biologjike, 1988; Qendra e Studimeve Biologjike, 1992); përbëhet nga disa lloje dushqesh, si bunga, bungëbuta, shparthi, qarri e bulgëri dhe bimë të tjera si pisha e zezë (*Pinus nigra arnold*), shparthi (*Quercus frainetto Ten*), qarri (*Quercus Cerris L*), gështenja (*Castanea sativa Miller*), lloje shkurresh si shkoza (*Carpinus betulus L*) etj. Mbizotërojnë dushqet mesofile dhe mezokserofile, të shoqëruara me shkurre të trevës meseuropiane. Pyjet më me rëndësi të këtij kati janë: pyjet me bungë (*Quercus petraea, Mattuschka, Liebl*) të thjeshta ose të përziera me shpardh, qarr, gështenjë, panjë (*Acer pseudoplatanus L*), frashër (*Fraxinus ornus L*), shkozë, dëllinjë etj. Dhe me bimësi barishtore të pasur; pyjet me shpardh (*Quercus frainetto Ten*) të përziera me qarr, bungë, shkozë, frashër dhe nënpyll e bimë barishtore; pyjet me qarr (*Quercus cerris L*) dhe me shkozëbardhë (*Carpinus betulus L*) etj. Dushkajat ndodhen në zona me popullsi mjaft të dendur, prandaj edhe shkalla e dëmtimit të tyre nga njeriu është mjaft e madhe.

- *Kati i ahishteve*: Takohen ahishtet dhe halorët subartikë në zonat e larta, si: pisha e zezë, rrobulli, hormoqi (*Pice abies, L, Karsten*), arneni, bredhi i bardhë, që formojnë pyje të thjeshta apo të përziera. Ahishtet shtrihen në lartësitë 1200-1900-2000, ku kanë zhvillim optimal. Ahu parapëlqen shpatet me ekspozim verior, verilindor, lindor dhe veriperëndimor, sepse ata janë më të freskët dhe me lagështirë më të madhe. Ndryshime të dukshme vihen re midis ahishteve mbi formacionet gëlqerore dhe mbi magmatikë. Në përgjithësi ahishtet janë të thjeshta, por shpesh shoqërohen me bredh të bardhë (*Abies alba Miller*), panjë (*Acer pseudoplatanus L*), frashër (*Fraxinus angustifolia Vah*), pishë të zezë (*Pinus nigra*) që formon pyje të mëdha në disa zona: Voskopojë, Vithkuq etj., sidomos në tokat e formuara mbi shkëmbinj magmatikë. Në pjesën e poshtme të ahishteve takohen shkurret e tipit meseuropian të lajthishteve me përbërje kryesore lajthinë (*Coryllus avallana L.*). Ahishtet kanë rëndësi të madhe për lëndën e drurit dhe për të penguar erozionin. Ato shërbejnë si vendstrehim për kafshët e egra.

- *Kati i kullotave alpine*: Përbëjnë një kat të veçantë mbi ahishtet dhe mbi lartësitë 1600-1700 m. Përfaqësohet nga shoqërime bimore,

kryesisht barishtore, sidomos graminore, si: lloje të bishtpelzës (*Festuca sp. div.*), të pirrëgjaksës (*Sesleria sp. div.*) etj. Aty këtu, takohen edhe shkurre, si: dëllinja xhuxhe (*Juniperus nana Willd.*), përfaqësues të familjes së trëndafilave (*Rosa sp.*). Përdoren për verimin e blegtorisë.

Fauna e pyjeve malore (dushkut, ahut, halorë) është më e pasura në lloje kafshësh, sidomos me gjitarë dhe shpendë. Kjo faunë jeton në kushtet e relievit shpesh shumë të ashpër dhe të thyer; në bimësinë e lartë pyjore; në kushtet e klimës me dimër të ashpër dhe me shtresë dëbore të trashë dhe të qëndrueshme. Shtrirja më e madhe kjo faunë e ka në zonat e mbrojtura, aty ku dendësia e qendrave të banuara dhe e popullsisë është më e vogël, pra në viset e pyjeve në fjalë. Shtojmë se largimi në masë i popullsisë nga zonat malore, pas vitit 1990, ka krijuar kushte për shtimin e botës shtazore në këto vise. Kafshët më karakteristike të këtij kompleksi faunistik janë gjitarët e mëdhenj, si: ariu i murmë (*Ursus arctos*); ujku (*Canis lupus L.*), deri i egër (*Sus scrofa*), zardafi (*Martes martes, L.*), shqarthe ose kunadhja (*Martes foina, L.*), ketri i zakonshëm (*Sciurus vulgaris*), gjeri (*Glis glis*) dhe lajthingrënësi (*Muscardinus avellanarius*) që takohet në viset me lajthi; nusja e lalës (*Mustela nivalis*), që gjendet në zgavrat etj. Më pak të përhapur janë rriqebulli (*Lynx lynx*), macja e egër (*Felix silvestris*) dhe disa shpendë të rrallë, si: gjeli i egër (*Tetrao urogallos*), që përbëjnë monumente të bukura të natyrës sonë të gjallë etj. Ndër shpendët më të zakonshëm përmenden kolonitë e pëllumbave (*Columba livia*), grifsha (*Garrulus glandarius*), sokolët etj. Në liqenet akullnajore takohet rosa glaciale (*C. hyemalis*) etj., ndërsa në mjediset barishtore gjendet dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), thëllëza e malit (*Alectoris graecus, Meish*) etj. (Zeko, 1963)

Jeta në pyjet e ahut dhe të halorëve gjallërohet në pranverë, kur vijnë shumë zogj nga zonat e ulëta, ku kanë dimëruar. Në kushtet e klimës më të freskët, në këto pyje ata ndërtojnë foletë dhe sigurojnë riprodhimin e tyre. Të tillë janë zborakët, mëllenjat, tushat e malit, trishtilët (*Parus major, P. ater, P. Cristatus*), qukapikët (*Dryocopus martius*), gushkuqët (*Erthacus rubecula*), bilbilat, qyqja (*Cuculus canorus*) dhe shumë të tjerë, ndërsa zvarranikët janë shumë të pakët.

- *Fauna e lartësive të maleve* (livadhe, shkurre subalpine, maja shkëmbore të zhveshura) është më e varfër. Këtu jetojnë dhitë e egra, të përshtatura ndaj klimës së ashpër dhe relievit të thyer. Në kërkim të

gjahut, në këto lartësi, sidomos kur vijnë kopetë e dhënve për verim, ngjiten edhe grabitqarë, si: ujku, ariu etj. Nga shpendët dallohen stërqokat e malit (*Pyrrohocorax graculus*), zhgabat mjekëroshe (*Gypaetus barbatus*), zhgabat e zeza (*Gypus fulvus*), shqiponja e malit (*Aquila chrysaetus*), kali i qyqes (*Neophron percnopterus*), korbi (*Corvus corax*).

I.2.8 Trashëgimia natyrore

Me larminë e theksuar natyrore lidhet trashëgimia e pasur natyrore e bashkisë. Janë shpallur këto kategori të zonave të mbrojtura: 13 monumente natyre (shih *njësitë fiziko-geografike*) dhe Peizazhi i Mbrojtur Bredhi Drenovë – Sinicë. Ky i fundit u shpall Park Kombëtar (1380 ha) në vitin 1966, ndërsa VKM nr. 594 datë 25.09.2024 e shpalli Peizazh i Mbrojtur me sipërfaqe 2065,8 ha. Ndodhet kryesisht në bashkinë e Korçës dhe pjesërisht në bashkinë e Devollit: në malet e Moravës, 1.200 m në 1.798 m lmg, në rrjetin “Emeralde” dhe të Parqeve të Harkut Dinarik. Përbëhet nga shkëmbinj molasikë dhe magmatikë. Ka reliev të thyer malor. Mbresa të thella të lë pylli dhe format ineresante të mikrorelievit (Guri i Capit). Ka klimë mesdhetare malore: verë e freskët dhe dimër i ashpër me shumë dëborë, burime natyrore me ujë të pastër e të ftohtë, që i shtojnë vlerat tërheqëse. Prej kohësh, qytetarët korçarë organizojnë këtu piknikët e dëgjuar e mbresëlënës.

Peizazhi ka rëndësi të veçantë për shkëmbimin e elementëve faunistikë dhe floristikë të vendit tonë me ato të Greqisë. Njëherazi, është bërthamë e biokorridor për gjitarët e mëdhenj, si: ariu i Bozdovecit (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*) e kaprolli (*Capreolus capreolus*). Kjo i jep atij edhe rëndësi rajonale ballkanike. Dallohet për larmi habitatesh: kullota natyrore nënalpine e alpine, pyje ahu (*Fagus sylvatica*), pishë (*Pinus sp.*), bredhi (*Abies sp.*), dushku dhe lajthie (*Corrilus avellana*). Takohen mjaft bimë të rralla dhe subendemike. Ka disa monumente natyre.

Peizazhi dhe territoret përreth kanë shumë *vlera kulturore*, që shprehen në monumentet e kulturës (Ministria e Kulturës, 2006): kalaja e Mborjes, kisha e Shën Jovanit, kisha e Shën Mitrit, kisha e Ristozit, kisha e Shën Gjergjit në Dardhë etj.

Peizazhet tërheqëse të parkut ofrojnë potenciale të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit natyror dhe kulturor. Por, gjendja e tij është e rëndë, për shkak të zjarreve të shpeshta, në vitin 2012, kur u dogj rreth 45% e pyllit (Xhaferllari, 2016).

I.2.9 Njësitë fiziko-geografike dhe trashëgimia natyrore e tyre

I.2.9.1 Fushëgropa e Korçës

Fushëgropa e Korçës është më e madhja, më e rëndësishmja në bashki dhe ndër fushat më të mëdha në vend. E gjitha shtrihet midis maleve të Moravës në L, Malit të Thatë në VL, pragut të Çërravës në V, malësisë së Gorës, Voskopojës e Vithkuqit në P dhe pragut të Qarrit në J. Ka shtrirje V-J, rreth 35 km dhe gjerësi nga 1 km në rreth 16 km, ndërsa sipërfaqja rreth 300 km². Pjesa veriore dhe qendrore janë krejtësisht të rrafshta. Shtrihet nga 813 m (Maliq) në rreth 950 m lmd në Floq (pjesa jugore). Pra, ka amplitudë hipsometrike të vogël (137 m), e lidhur me lëvizjet ulëse të strukturës së saj. Pjesa më e madhe shtrihet deri në 900 m lmd. Vetëm skaji jugor dhe disa kodra të vogla në P kanë lartësi më të madhe. Pjesa veriore e saj shtrihet në bashkinë e Maliqit. Kufiri midis tyre është konvencional dhe shënohet nga fshati Shamoll, Nj.A. Bulgarec, bashkia Korçë.

Është formuar në grabenin pliokuaternar, i cili vazhdon të ulet edhe aktualisht. Ka fund të rrafshët dhe rrethohet nga kurrize malorë. Devolli e Dunaveci këtu vetëm akumulojnë, duke krijuar rrafshirën karakteristike të fundit të saj. Për pasojë shtretërit e tyre natyrorë janë të cekët, të paqëndrueshëm, të degëzuar e të ishulluar, të paaftë për të përcjellë plotat e ujit që shoqërohen me vërshime. Në këto kushte, gjithmonë natyrore, fushëgropa është e lagët, kënetore e moçalore. Pamja e sotme e peizazhit të saj është rezultat i bonifikimit në vitet '60 të shekullit të kaluar.

Grabeni në fjalë është mbivendosur mbi një bazament molasik, ultrabazik, gëlqeror. Shpimet treguan se gëlqerorët e burdigalianit, që ndërtojnë kreshtën më të lartë të maleve të Moravës (rreth 1700-1800 m), këtu ndodhen në thellësinë 1000 m. Disnivele prej rreth 2000 m midis tyre flet për shkallën e madhe të zhytjes së tij dhe të ngritjes së

strukturave të Moravës, pra, për diferencimin shumë të madh të tij me njësitë rrethuese. Trashësia e madhe e depozitimeve kuaternare (200-300 m) (Tyli, 1971) mbi këtë bazament, flet për zhytjen e madhe të tij gjatë kuaternarit.

Depozitimet kuaternare janë liqenore, sepse përbëhen nga ndërthurje të shtresave të zhavorreve me shtresa zhuresh, të ndara nga horizontet argjilash dhe subargjilash (Tyli, 1971). Ato tregojnë se në kuaternar fushëgropa e Korçës ka qenë e mbuluar nga një liqen, që arrinte në jug afër pragut të Qarrit. Ky liqen, për shkaqe ndoshta tektonike apo klimatike, e ka ndryshuar disa herë thellësinë e tij, për pasojë depozitimet janë të ndërthurura, herë më të trasha e herë më të holla. Mbi depozitimet liqenore gjenden depozitime aluvionale (pjesa jugore) dhe kënetore (pjesa veriore), ndërsa në rrethinat, në kontaktin me relievin malor, takohen proluvione. Në tërësi, evolucioni morfotektonik kuaternar i strukturës së kësaj fushëgrobe, të përfshirë nga lëvizje ulëse, formoi veçoritë kryesore të morfologjisë të fushëgropës.

Bazamenti strukturor i kësaj fushëgrobe dhe pellgu i madh i Ohrit vazhdojnë lëvizjet ulëse. Këtë e dëshmojnë 1-pakësimi i pjerrësisë së lumit Devoll, që solli cektësimin e shtratit dhe vërshimet e tij, nga të cilat u formua kënetat dhe liqeni i ri i Maliqit 2- shpeshtësia e lëkundjeve të fuqishme sizmike, që lidhen me riaktivizimin e thyerjeve tektonike 3-banesat palafite neolitike në Maliq, të mbuluara me depozitime të reja.

Në rrethinat perëndimore e lindore të saj ndodhen kodrat e Vloçishit, të Korçës etj., me lartësi të vogël relative (rreth 150-160 m) dhe të përbëra nga depozitime më të vjetra se ato të tabanit të fushëgropës. Në të njëjtën kohë ato ndodhen shumë më poshtë se sa malet apo malësitë rrethuese, të përbëra nga të njëjtat depozitime, pra këto kodra janë mbetje dhe dëshmitare të fundosjes së grabenit.

Një thyerje tektonike aktive e përshkon grabenin e Korçës në drejtimin Voskop-Dishnicë, duke e ndarë atë në dy pjesë me regjime të ndryshme të lëvizjeve neotektonike: pjesa veriore e përfshirë nga lëvizje më të fuqishme ulëse se pjesa jugore, ku, më vonë, ndoshta, janë shfaqur edhe lëvizjet ngritëse me amplitudë të vogël. Me këto shkaqe lidhen ndryshimet morfologjike të fushëgropës. Pjesa veriore është shumë më e rrafshët se pjesa jugore. Duke përbërë nivelin bazë të proceseve të modelimit të relievit të njërive rrethuese, fushëgropa ka luajtur rolin

kryesor në evolucionin morfologjik të tyre, sidomos në kuaternar. Kjo kushtëzoi formimin me erozion regresiv të grykave të përrenjëve në kurrizet rrethuese. Këta përrenj derdeshin në liqenin e dikurshëm kuaternar dhe pas tharjes së tij, në Dunavec.

Kufijtë morfologjikë të fushëgropës, duke u përputhur gati plotësisht me kuadrin e përgjithshëm morfotektonik, shprehen mjaft mirë në relief. Në P, struktura e saj kufizohet pothuajse tërësisht me strukturat kryesisht molasike të malësisë së Gorës, Voskopojës e Vithkuqit, ndërsa në L me strukturat magmatike të Movarës dhe karbonatike të Malit të Thatë, ku dalin burime në të njëjtin nivel hipsometrik. Pragu strukturor i Çërravës e ndan nga grabeni i Ohrit, pragu i Qarrit nga grabeni i Kolonjës dhe pragu i Dumbravës nga gjysmëgrabenit i Bilishtit. Morfologjikisht, më i shprehur është kufiri verilindor me Malin e Thatë dhe lindor me Moravën.

Kontrastet e theksuara morfologjike të shpateve të Malit të Thatë dhe të Moravës dhe sasia më e madhe e materialeve koluvo-proluvional në rrëzë të këtij të fundit, dëshmojnë për ngritjet më të mëdha të strukturave të tyre, në krahasim me ato kufizuese P. Kjo ngritje e tyre dhe e strukturave në P, intensifikoi erozionin, transportimin dhe depozitimet proluvionale në këtë fushëgropë, të cilat kompensonin uljen e strukturës grabenore, duke mbathur liqenin dhe formimin e relievit fushor të saj. Me këtë lidhen ndryshimet midis shpateve L e P të kësaj fushëgropë.

Veçoritë klimatike lidhen sidomos me lartësitë mbi nivelin e detit, me rrethimin e saj me male të larta, largësinë e madhe nga deti dhe sidomos me ndikimin që ushtron gryka e Cangonjit në verilindje, rreth 100 m e gjerë, që lidh fushëgropën e Korçës me fushën e Bilishtit. Nëpër të depërton murlani ose "cangonjarja", siç njihet nga vendasit. Ngushtimin dhe forcën e madhe të fituar, duke kaluar nëpër këtë grykë, e ruan edhe kur përshkon pjesën veriore të fushëgropës, ku ndihet, si erë e fortë dhe e ftohtë, duke shkaktuar ndryshime të dukshme klimatike midis pjesës veriore e jugore të fushëgropës. Fushëgropa e Korçës bën pjesë në rajonet më të ftohta të vendit tonë dhe ka tipare të dukshme të ndikimit kontinental: në Korçë temperatura mesatare vjetore 10,5°C; e korrikut 20°C; e janarit 0,5°C dhe amplituda e temperaturës mesatare vjetore rreth 20°C (Korçë), ndërsa në Sheqeras respektivisht: 9,5°C; 18,3°C, 0°C dhe 18,5°C; minimume absolute shumë të ulëta: Sheqeras -26,9°C (ndër më më të ulëtat në vendin tonë),

Korçë -20.9°C dhe Zvirinë -25°C . Këto minimume janë pasojë e depërtimit të masave ajrore të ftohta dhe e fuqizimit të efektit të tyre nga forma e mbyllur e fushëgropës.

Dallohet për sasinë mesatare vjetore më të vogël në vend të reshjeve, sidomos Sheqerasi me rreth 600 mm. Edhe brenda fushëgropës ka shpërndarje gjeografike jo të barabartë të reshjeve vjetore. Për shkak të afërsisë së maleve, në Korçë e në Maliq bien deri në 190 mm reshje më shumë se në Sheqeras. Ndikimi kontinental në klimë zbut regjimin mesdhetar të reshjeve: në verë bien 12,5 % të reshjeve vjetore dhe maksimumi sekondar i reshjeve në maj, që vërehet më mirë në Korçë. Dëbora krijon shtresë, rreth 34 ditë, në muajt nëntor deri në fund të marsit, por ka raste edhe në muajin prill. Trashësia maksimale e shtresës së saj ka arritur 47 cm, sidomos në pjesën V.

Hidrografia e fushëgropës është e pasur sidomos me ujëra nëntokësore të tipit artezian (Tafili, 2002). Pjesën veriore të saj e përshkon lumi i Devollit, ndërsa atë jugore lumi i Dunavecit. Tokat e kafenjta ndryshojnë gjatë shtrirjes së saj. Në të dallohen disa nëntipa. 1-Tokat e kafenjta livadhore mbizotëruese, që shtrihen kryesisht në brendësi dhe dallohen për profil të trashë, me reaksion neutral e pjellori të mirë; 2-Tokat livadhore aluvionale në të dy anët e lumit të Devollit dhe të Dunavecit, që janë të shtresëzuara dhe me përbërje mekanike subargjilore dhe pjellori të mirë; 3- Tokat livadhore torfike me pjellori të lartë në V.

Bimësia natyrore në këtë fushëgropë ruhet vetëm në areale të vogla (në afërsi të Sheqerasit) dhe përbëhet nga disa drurë të lartë higrofile (plepi, shelgu, vidhi etj.) dhe nga bimësi barishtore higrofile. E plotë ruhet në pyllin apo në rezervatin e Maliqit, monument natyre. Ky monument gjendet në 813 m lmd. Përbëhet nga plepi, shelgu, bliri etj. Është mbetje e pyllit të dikurshëm që mbulonte pjesën veriore ligatinore të fushëgropës së Korçës.

Pjesën veriore më të ulët të fushëgropës së Korçës e zinte kënetat e Maliqit. Lumenjtë që e përshkonin atë herë pas here dilnin nga shtrati dhe përmytnin sipërfaqe të mëdha. Gjendja e saj ndryshoi në vitet '60, të shekullit XX, kur u tha artificialisht kënetat e Maliqit, nga e cila u përfituan 5600 ha tokë të reja dhe u përmirësuan 7920 ha të tjera. Për ujëtimin e tokave u hapën kanale të mëdha ujëtimëse (Ventrokut, i Korçës etj.), ujëmbajtësi (Gjançit etj.) dhe stacione pompimi, të cilat i vunë të gjitha tokat e fushëgropës nën ujë. Ajo është dendësisht e banuar dhe

ndër më pjelloret në vend, ku kultivohen drithëra, patate, perime, fruta e foragjere etj. Në fushëgropën e Korçës janë këto vendbanime: qyteti i Korçës dhe fshatrat Shamoll, Bulgarec, Çiflig (Nj.A. Qendër Bulgarec); fshatrat Turan, Ravonik dhe Qatrom (Nj.A. Drenovë).

I.2.9.2 Malësia e Voskopojës

Shtrihet midis luginës së Devollit në V dhe luginës së Gjergjevicës në vazhdim, përgjatë kontaktit midis magmatikëve dhe gëlqerorëve, ku ndahet me malësinë e Vithkuqit. Dallohet për kontraste të mëdha të relievit: lugina në formën e grykave e kanioneve, lugina dhe zgjerime e kontakti, thepisje të relievit etj. Lartësia e saj rritet V-J dhe L-P nga rreth 600 m (V), mbi 1650 m (Shullëri i Madh) dhe 2352 m (Ostrovicë), në P. Ndër elementët morfologjikë dallohen:

- *Kurrizi Ostrovicë-Bofnjë në P*, me drejtim V-J, më i madhi, më kompakti, më i larti, me kontraste më të theksuara morfologjike. Përbëhet nga gëlqerorë të kretak-eocenit dhe nga flishi oligocenik, të cilat formojnë strukturë sinklinale, të ndërlikuara dhe të copëtuara nga shkëputje normale gjatësore dhe tërthore (Instituti i Studimeve Gjeologjiko-minerale, 1999). Ky sinklinali u përfshi nga lëvizje të fuqishme ngritëse neotektonike, të cilat e diferencuan nga strukturat fqinje dhe, së bashku me ndërtimin gëlqeror të kreshtës, përcaktuan lartësinë më të madhe të tij (Çuka e Faqekuqit 2352 m). Këta faktorë, copëtimi i madh tektonik dhe pozicioni midis luginave të thella, Çemericës (degë e Devollit) në L, Kapinovës dhe Staraveckës (degë të Osumit), përkatësisht, në P e në J dhe luginës së Devollit në V, kushtëzuan zhvillimin e vrullshëm morfologjik të këtij kurrizi, me të cilin lidhen kontrastet e mëdha hipsometrike të relievit, thepiset e theksuara, forma e veçantë e shpateve dhe e kreshtës së kurrizit. Pjesa qendrore flishore e kurrizit malor, e formuar përgjatë boshtit të sinklinalit, ka lartësi më të vogël se rrethinat (kornizat), tepër të thepitura e të ashpra gëlqerore, të formuara në krahët e sinklinalit. Morfologjia e pjesës qendrore është më e butë, me sektorë të sheshtë ose me pjerrësi të vogël, por të copëtuar nga erozioni ujor e akullnajor.

Në këtë kurriz dallohen dy male kryesore: Ostrovica në jug dhe Bofnja në veri, që ndahen nga lugina e përroit të Becit (degë e përroit të Çemericës). Ostrovica ka reliev më të lartë e më të ashpër se Bofnja. Ndaj ka forma akullnajore më të shumta e më të mëdha. Dallohen cirqet

e lugjet, pak të ruajtura për shkak të karstit e proceseve periglaciare. Mali i Bofnjës vazhdon me një kurriz gëlqeror që, duke u ngushtuar, arrin afër malit të Koshnicës. Bazamenti strukturor i tij është copëtuar nga thyerje tektonike normale gjatësore dhe tërthore, me të cilat lidhen asimetria strukturore, që sjell edhe asmetrinë morfologjike.

Lugina e Çemicës në P të kurrizit Ostrovicë-Bofnjë është zhvilluar në brezin e shkatërrimit të flisheve nga mbihipja në këtë sektor të zonës së Mirditës mbi atë të Krastës. Lugina dallohet për pragjet e shtratit dhe për format e shpeshta erozive që lidhen me shkatërrimin tektonik, me përbërjen flishore, me pjerrësinë e madhe të shtratit e të shpateve të luginës, me varfërinë bimore, rezultat ky edhe i faktorit antropogjen. Në shpate ka rrëshqitje të shumta, të vjetra dhe aktive, blloqe gëlqerorë të zbritur nga lartësitë deri në shtratin e përroit, si dhe peizazhe të shkretirizuara. Bimësia përbëhet nga dushqe, halorë dhe nga kullota alpine. Në këtë luginë ka disa disa qendra të banuara.

Kurrizi malor "Shullëri i Madh" (1653 m) përbëhet nga ultrabazikë. Në jug ai ngushtohet midis prerjes së thellë erozive të lumit të Gjergjevicës dhe lumit të Zhombrit. Në vazhdim ai shkrihet me pjesën qendrore të malësisë së Vithkuqit.

Në P. të gropores së Voskopojës, në sektorin Gjonmadh-Lavdar i Korçës dalin gëlqerorët mesozoikë, të copëtuar nga shkëputje normale tërthore. Kjo shprehet në reliev me rritjen e kontrasteve dhe me formimin e disa shkallëve strukturore. Sektori Gjonmadh – Polenë ka reliev të shkallëzuar dhe me kueste, pak të shprehura në reliev. Groporet dhe luginat e kontaktit janë pak të zhvilluara, fakt ky që lidhet me fundosjen e bazamentit strukturor të fushëgropës së Korçës, ku u krijua një bazë e ulët erozioni. Prandaj rrjeti hidrografik mori drejtim kryesisht L-P.

- *Groporja e Voskopojës* (1200 m) e zhvilluar midis ultrabazikëve në P dhe molasave në L, është më e madhja (4 km e gjatë dhe 1 km e gjerë). Zgjerimin më i madh shënohet tek fshati homonim, që lidhet me bashkimin e përroit të Zhombrit me të Mustafallarit, luginat e të cilëve, së bashku me groporen e Voskopojës, janë modeluar nga akujt që erdhën nga pjesa qendrore më e lartë e malësisë së Vithkuqit. Qafa e Gjonmadhit është një mbetje e kaptimit nga një degë e Devollit, të lumit të Voskopojës, që derdhej dikur në fushëgropën e Korçës. Për këtë flet forma e saj dhe mbetjet e pakta të depozitimeve lumore, në të

cilat takohen edhe zaje ultrabazike të sjella nga masivi i Voskopojës në lindje të gropores.

- *Lugina e Gjergjevicës*, e zhvilluar përgjatë thyerjes tektonike midis gëlqerorëve të kurrizit Krasta e Tejme dhe magmatikëve të Shullërit të Madh, përshkohet nga përroi i Gjergjevicës. Dallohet për karakterin asimetric dhe pragjet e shumta.

Bimësia e malësisë së Voskopojës, në përgjithësi, është mjaft e dendur, por ka edhe shpate krejt të zhveshura. Gjenden dushqet e degraduara, në pjesën e poshtme, ndërsa më lart, areale pishash e ahishtesh të përziera. Në kurrizet ka kullota alpine.

Trashëgimia natyrore përbëhet nga disa monumente natyre, në të cilët dallohen (Qiriazhi & Sala, 2006):

- *Guri i Prerë*, pranë fshatit Gurrazez, 1300 m mbi nivelin e detit, 16 m i lartë, me formë disi të rrumbullakët të krijuar nga erozioni.
- *Varreza e fosileve të Kretës të poshtme në Voskopojë* gjendet në kodrën e fshatit, rreth 1000 m mbi nivelin e detit. Fosilet dalin në një sipërfaqe rreth 1000 m².
- *Mospërputhja këndore e Polenës* shfaqet midis molasës oligocenike e gëlqerorëve të Mirditës.
- *Burimi i ujit dhe i gazit të djegshëm* në Polenë, del sipas shkëputjes tektonike 5 m e gjatë.
- *Pishat e Voskopojës* përfaqëson pyll (20 ha), 150-180 vjeçar pishë të zezë (*Pinus nigra*).
- *Ahishta e Bofnjës* (10 ha), afër fshatit Dushar përfaqëson pyll ahu rreth 200-vjeçar.

Në malësinë e Voskopojës vendbanimet rurale janë vendosur përgjatë luginës së Gjergjevicës (Lavdar, Mazreka, Brozdovec, Tudas, Xerje, Lekas, Shkozanj, Marjan, Gjonbabas, Gurmuja, Popovinë dhe Gjergjevicë) dhe në groporen e Voskopojës (Gjonmadh, Voskopojë, Shpëskë dhe Krushovë). Në rrëzë të malësisë, pranë fushëgropës së Korçës gjenden fshatrat Damjanec, Vinçan, Melçan, Lumalas, Porodinë, Goskovë, Voskop, Lavdar, Polenë dhe Dërsnik. Si vendbanimet e zonave malore të vendit edhe fshatrat malorë të kësaj malësie u përfshinë nga migrimi i madh i dhjetëvjeçarëve të fundit. Ky migrim ka shkaktuar braktisje masive të vendbanimeve, plakjen e

popullsisë, braktisjen e resurseve natyrore, humbjen e traditave dhe pasurisë shpirtërore të tyre.

I.2.9.3 Malësia e Vithkuqit

Shtrihet në jug të malësisë së Voskopojës. Pjesa qendrore përbëhet nga magmatikë, ndërsa rrethinat nga terrigjenë (molasë, flish) dhe gëlqerorë. Kontrastet e relievit rriten nga qendra në drejtim të rrethinave, sidomos në P. Nga qendra e saj në drejtim të gropave rrethuese dhe prerjeve erozive rrjedhin shumë përrenj me drejtim rrezor. Shtrihet nga rreth 1000 m (L) deri në 1945 m (maja e Rungajës). Dallohen:

- *Pllaja veriore* ultrabazike e malësisë, me shtrirje më të madhe P-L dhe me reliev të valëzuar. Kjo pllajë përbën mbetje të një sipërfaqeje sheshimi, ende e pa kapur nga erozioni regresiv i përrenjve. Ka forma akullnajore: cirqe të thjeshta e lugje akullnajore të cekëta.

Pllaja e Rungajës shtrihet në VP, ndërsa drejt J arrin deri në luginën e Osumit. Në përbërjen e saj dominojnë magmatikët, që ndërtojnë masive dhe gëlqerorët e kretës së sipërme në pjesën qendrore më të lartë, të vendosura mbi të parët. Struktura gjeologjike e kësaj pllaje është përfshirë nga lëvizje të fuqishme ngritëse neotektonike, të shoqëruara me thyerje tektonike që e ndërlikojnë këtë strukturë komplekse, të pozicionuar midis luginave të thella (Osumit të Sipërm e të Mesëm, përroit të Panaritit, Çemericës) dhe gropës së Kolonjës. Ndaj edhe rrjeti hidrografik i saj ka shpërndarje rrezore, nga qendra më e lartë drejt rrethinave. Në qendër ndodhet pllaja karstike e Rungajës me reliev të valëzuar dhe disa maja: Rungajës 1945 m, Maringelos 1786 m, Çingasit 1676 m etj. Dominon morfologjia karstike dhe akullnajore, me të cilën lidhet rrjeti i rrallë hidrografik sipërfaqësor. Të vetmet rrjedhje sipërfaqësore janë: 1-përroi i Rungajës (fillimi i Osumit), që rrjedh në terrigjenë me një luginë tektonike të thellë e të ngushtë dhe 2- përroi i përkohshëm i Orenjës në skajin VL të pllajës. Në rrethinat e kësaj pllaje karstike, në kontaktin e gëlqerorëve me efuzivët dhe ultrabazikët, dalin burime karstike, që shënojnë fillimet e degëve të Osumit, i cili, duke shfrytëzuar kontaktet tektonike e litologjike, e qarkon pllajën karstike nga VP, V dhe L. Këtu takohen edhe forma akullnajore të gërshetuara me ato karstike, aq sa është e

vështirë të dallohen nga njëra-tjetra. Në J ngrihet edhe *Mali i Zi* (1672 m), i përbërë nga ultrabazikë, më të fortë se efuzivët përreth. Ndaj, ky mal ka formë konike, me shpatet mjaft të pjerrët dhe veshje të dendur bimore. Afër tij ndodhet gropa e kontaktit (Çlirimi etj.) dhe tektonike (Lubonjës).

Kurrizet gëlqerore shtrihen në P e JP të malësisë. Dallohen: 1-*Kurrizi Mali i Ujit të Bardhë-Gjanç*, në juglindje me lartësi 1312 m dhe reliev të shkallëzuar; 2- *Kurrizi Leshnjë-Krasta e Tejme*, në VL të të parit, me majën e Lisecit (1714 m)VP; 3- *Kurrizi Vithkuq-Shtyllë-Maja e Bardhë, më i thyer dhe me kontraste të theksuara, që lidhen me përbërjen gëlqerore mesozoike*.

I gjithë bazamenti strukturor i pjesës L të malësisë përshkohet nga shkëputje tektonike. Me këto dukuri strukturore dhe litologjike lidhen kontraste dhe shkallëzime morfologjike.

Fusha e Leshnjës, rreth 80 ha dhe me formë të përzgatur, përbën një fushëgropë të vogël tektonike, që përshkohet me shtrat të cekët nga rrjedhja e sipërme e Osumit. Për vënien nën kulturë u desh sistemimi i saj. Këto vërtetojnë përfshirjen e saj nga lëvizjet ulëse.

Lugina e përroit të Panaritit shtrihet në P të pllajës së Rungajës. Perroi zë fill në qafën e Martës dhe derdhet në Osum. Me zhvillimin e luginës në brezin e shkatërrimit të flisheve nga mbihipja, në këtë sektor, të zonës së Mirditës mbi atë të Krastës, lidhet karakteri tepër eroziv, ai, jo rrallë, merr formën e rrjedhjes së baltës. Pellgu i tij ujëmbledhës dallohet për zhvillimin e madh të peizazheve të shkretirizuara. Në sektorin e sipërm të luginës është vendosur fshati Panarit.

Mbulesa bimore e malësisë së Vithkuqit është e varfër dhe mjaft e degraduar. Ruhen vetëm disa areale pyjore ahu dhe halorësh të veçuar: Shtyllë, majën e Azinës, Mali i Zi etj.

Trashëgimia natyrore përbëhet nga dy monumente natyre:

- *Pisha e Makrezës*, afër Vithkuqit, në lartësinë 1100-1200 m, është pyll rreth 150-vjeçar.
- *Bliri 340-vjeçar i Shënpjetrit në Vithkuq*, pranë kishës së Shënpjetrit.

Ndërkohë janë propozuar edhe tre të tjerë: Lista e Kisha të Lubonjës, pishat e kalasë së saj dhe Liqeni i Poshtëm Akullnajor i Malit të Zi.

Në malësinë e Vithkuqit gjenden vendbanimet e Ujëbardhit (Bollovodës), Gjançit, Leshnjës, Vithkuqit, Shtyllës, Roshanjit, Rehovës, Lubonjës, Stratobërdhës, Treskës, Trebickës, Panaritit dhe Grabockës.

I.2.9.4 Malet e Moravës

Këta male, me shtrirje V-J, rreth 28 km e L-P, 3-12 km, lartësohen nga gryka e Cangonjit në V, deri në Qafën e Kazanit në J, që e ndan nga mali i Gramozit. Përbëhen nga molasa, ultrabazikë, flish dhe gëlqerorë që formojnë: 1-Strukturën e madhe monoklinale, antiklinale, masive ultrabazikë dhe blloqe të mëdha gëlqerore, të copëtuara nga tektonika. 2- Dallohen për larmi morfologjike e morfogjenetike të relievit. 3- Shtrihen midis lartësive 900-2043 m (maja e Badaroshës).

Nisur nga ndryshimet morfologjike dallohen dy sektorë: Ai verior (Morava) dhe jugor (Llofka) që ndahen nga shkëputja tektonike midis terrigjenëve dhe ultrabazikëve të Malit të Kuq. Me tiparet jo të njëjta strukturore dhe litologjike të tyre lidhet morfologjia e ndryshme e tyre: ndërsa veriori përbëhet nga dy kurrize malore, jugori (Llofka) ka disa të tillë me drejtime të ndryshme.

Spektori verior (Morava) me reliev më të rregullt është modeluar në monoklinalin e Moravës. Bazamenti i tij përbëhet nga brezi ultrabazik, rreth 1-1.5 km të gjerë në P, gjatë kufirit tektonik me grabenin e fushëgropës së Korçës, ndërsa pjesa L që përfaqëson krahun e monoklinalit, përbëhet kryesisht nga molasa të neogjenit dhe pjesërisht nga flishi i oligocenit. Gjerësia e këtij krahu ndryshon nga 4 km në veri deri rreth 12 km në jug. Ky monoklinal iu nënshtrua diferencimit neotektonik bllokor me vlerë 300-400 m, midis grabenit të Korçës, bërthamës ultrabazike dhe krahut L terrigjen të tij. Ky diferencim shprehet me ndryshimin e lartësisë midis fushëgropës së Korçës dhe kurrizit P ultrabazik, si dhe midis këtij kurrizi dhe kreshtës molasike L. Për këtë flet edhe krahasimi midis pozicionit të gëlqerorëve burdigalianë në kreshtën molasike dhe në thellësi të fushëgropës së Korçës. Dallohen dy kurrize, ai L dhe ai P.

Kurrizi lindor i Moravës ka trajtën e kreshtës monoklinale (rreth 23 km) që dallohet për asimetri strukturore të shpateve, lugina konsekuente në shpatin L dhe obsekuente në atë P, për sipërfaqe

strukture, më rrallë kueste, shkallët strukture, depresionet e kontaktit, mbetjet erozive, për dendësinë e thellësinë e madhe të copëtimit të relievit. Balli i kreshtës, i orientuar në P, ndërtohet kryesisht nga konglomeratë dhe ranorë masivë të akuitanianit të poshtëm dhe gëlqerorë litotamikë të burdigalianit, ku shënohen lartësitë më të mëdha: Maja e Lartë (1808 m), Maja e Rrumbullakët (1798 m), Elbit, Bigllës së Drenovës e Boboshticës 1600-1750 m. Në konglomeratë e ranorë, erozioni selektiv ka krijuar mikroforma të relievit, si shtylla, kërpudha, gamile (Guri i Capit, monument natyre) etj. Shpati P ka formën e greminës, sepse është modeluar në drejtimin të kundërt të rënies së shtresave të gëlqerorëve litotamikë. Për shkak të rënies së shtresave në drejtim të lindjes, burimet e ujit, në kontaktet e gëlqerorëve me argjilat, janë të pakta e të vogla. Ndaj, rrjedhjet në këtë shpat me zhvillim të vogël nuk kanë mundur të copëtojnë ballin e kësaj kreshte. Shpati lindor ka pjerrësi të vogël pasi shpati gati përputhet me shpinën e shtresave.

Kurrizi perëndimor (Shëndëllisë), prej kurrizit lindor diferencohet nga depresionet e kontaktit me drejtim subsekuent. Ky kurriz me lartësi deri në 1200-1400 m është modeluar në brezin e ultrabazikëve. Bën përjashtim vetëm segmenti Dishnicë-Kuç i Zi, rreth 4 km, ku del flishi që mbulon ultrabazikët. Këtu zvogëlohet lartësia e tij deri në 1000-1200 m. Shpati P i tij ka pjerrësi të madhe, që lidhet me diferencimin neotektonik me grabenin e Korçës. Shpati L, për shkak të erozionit selektiv të zhvilluar në brezin e kontaktit të ultrabazikëve me flishin, ka morfologji shumë të çrregullt. Kulmi i këtij kurrizi ka morfologji kryesisht të butë dhe lehtësisht të valëzuar. Ai copëtohet tërthor nga disa gryka depërtuese që përshkohen nga degët e djathta të Dunavecit. Formimi i tyre lidhet me erozionin regresiv të degëve të Dunavecit. Në rrjedhën e tyre të sipërme kanë ndodhur disa kaptime, me të cilat lidhen qafat e këtij kurrizi: Qafa e Qytetit (1200 m) dhe e Shëndëllisë (1300 m). Në L të tij, në kontaktin magmatikë-molasë, luginat e pellgjet e degëve zgjerohen në depresione kontakti subsekuente dhe të bashkimit të degëve të përranjëve në hyrje të grykave në fjalë. Këto depresione ndahen nga qafa e ujëndarës të ngushtë.

Spektori Jugor (Llofka ose Mali i Kuq) ka reliev më të çrregullt dhe me kontraste më të mëdha. Ka përbërje gjeologjike më të larmishme me

masive magmatike të llojit ultrabazik, që lidhen me të Moravës nëpërmjet dy blloqeve gëlqerore të kretës së sipërme dhe serpetinite, që vazhdojnë edhe në pragun e Qarit; flishoide të jurës së sipërme-kreta e poshtme dhe gëlqerorë triasiko-jurasikë, që ndërtojnë struktura antiklinale, me shtrirje veriperëndim-juglindje (Instituti i Studimeve Gjeologo-Minerare, 1999). Bazamenti strukturor u përfshi nga lëvizje ngritëse të fuqishme, me të cilat lidhen lartësitë më të mëdha (rreth 200 m) se sektori i parë dhe thyerje tektonike normale e neotektonike, deri në mbihipje të ultrabazikëve mbi flishoidet e gëlqerorët. Këto ngritje e diferencuan nga grabeni i Kolonjës e i Korçës dhe nga skaji jugor i sinklinalit të Devollit, duke kushtëzuar shpërndarjen rrezore të rrjetit hidrografik drejt bazave të ulëta të erozionit, gropa e Kolonjës, fushëgropa e Korçës (përroi i Kamenicës dhe i Floqit, degë të Dunavecit) dhe lugina e Devollit të Sipërm. Këto kushtëzuan evolucionin e shpejtë morfologjik dhe morfologjinë e veçantë të këtij sektori, shtrirje me drejtime të ndryshme të maleve, më tepër në formën e blloqeve, me ndryshime të mëdha nga njëri - tjetri.

Kurrizi Floq-Badaroshë, që mbyll nga jugu sektorin jugor, është modeluar në dy struktura antiklinale gëlqerore të triasit të sipërmë: jura e poshtme dhe flishoide. Format akullnajore në këto male kanë shtrirje të madhe, por ruhen më pak për shkak të karstit. Në pjesën P të maleve të Moravës bimësia natyrore është e varfër, kurse në brendësi e në L ajo është më e pasur dhe përbëhet nga shkurre, dushqe, ahishte e halorë. *Trashëgimia natyrore* përfaqësohet nga Peizazhi i Mbrojtur Bredhi i Drenovës – Sinicë (shih më lart) dhe nga disa monumente natyre (Qiriazhi & Sala, 2006):

- *Guri i Capit*, përfaqëson një bllok konglemerato-ranor me gjatësi 25 m, gjerësi e lartësi deri 10 m në formën e deveve të ulura, të krijuar nga erozioni e era.
- *Pisha e Shëndëllisë* (10 ha) afër fshatit Mborje, përbën një pyll pishe të zezë.
- *Bredhi Burimi i Çardakut*, Peizazhi i mbrojtur Bredhi i Drenovës, Sinicë, rreth 300-vjeçar.
- *Bredhi i Vishnjës* pranë fshatit Dardhë në lartësinë 1480 m është bredh i bardhë (*Abies alba*) 150-vjeçar me lartësi 30 m, diametër trungu 70 cm e perimetër 120 cm.

I.3 HISTORIA, KULTURA DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

Pozita e favorshme gjeografike dhe kushtet e mira klimatike kanë favorizuar popullim intensiv që zë fill që në kohët më të lashta. Pikërisht në afërsi të territorit të bashkisë, në pjesën veriore, janë zbuluar stacione të shumta prehistorike të epokës neolitike dhe eneolitike në Vashtëmi, Podgorie, Dunavec dhe Maliq. Vendbanimet e kësaj epoke janë ngritur në vende të hapura, me kushte të favorshme për kultivimin e bimëve bujqësore dhe për rritjen e bagëtive, të cilat ishin dy degët kryesore të ekonomisë. Të përhapura kanë qenë dhe vendbanimet e ngritura mbi shtylla druri (palafit), të cilat u shfaqën në neolitin e mesëm (Dunavec) dhe vazhduan të ruhen edhe gjatë periudhave pasardhëse, siç dëshmojnë gjetjet e neolitit në vendbanimin prehistorik të Maliqit në kufirin verior të bashkisë. Përveç këtij lloji banimi njihen dhe forma të tjera: vendbanimet mbi tokë dhe vendbanimet shpelllore. Një fazë më të lartë zhvillimi kaloi shoqëria në periudhën e bronzit, siç dëshmohet nga zbulimet e kryera në vendbanimet e Maliqit dhe Podgories, në afërsi me territoret e bashkisë së Korçës. Në aspektin etnologjik, periudha e bronzit është koha gjatë së cilës zë fill procesi i ngadaltë dhe i ndërlikuar i etnosit ilir. Edhe gjatë kësaj periudhe vendbanimet dhe banesat ruajtën të njëjtin karakter si në periudhat e mëparshme, por ato janë populluar më dendur. Ndryshime të ndjeshme pësoi karakteri i vendbanimeve duke filluar nga periudha e parë e hekurit. Ato kalojnë nga fusha në lartësi, në kërkim të vendeve me mbrojtje të mirë natyrore. Përhapen në këtë kohë gjerësisht vendbanimet e fortifikuara, gjurmë të të cilave janë Gjonomadhi, Kakaçi, Bellovoda, etj. Kështjellat zakonisht ishin të vendosura pranë shtigjeve natyrore që e lidhnin trevën e Korçës me krahinat përreth, duke krijuar në këtë mënyrë një sistem të plotë fortifikimi. Një sistem i tillë presupozon një organizim politik të qendëruar, që përkon me lindjen e federatave të para fisnore. Federata e Enkelejve u bë një fuqi e madhe aktive në shek. IV p.e.s., nën

udhëheqjen e Bardhytit, i cili krijoi një mbretëri të fortë. Fuqizimi i feudalëve shqiptare në shek. XIII solli ndarjen e territorit të vendit midis tyre. Një pjesë e mirë e zonës së Korçës, hyri në zotërimin e Muzakajve. Gjatë kësaj kohe patën një përhapje të madhe kështjellat e vogla, ku kishin selinë feudalët e krahinës. Gjurmë kështjellash të tilla ruhen në fshatin Mborje. Monumentet e tjera të kësaj periudhe, ku përfshihet edhe kisha e Ristozit në Mborje, shquhen për vlerat e tyre arkitektonike e artistike, dëshmojnë për një zhvillim të mirë të kësaj treve. Në periudhën e pushtimit osman deri në shek. XVI qytetet patën rritje të ngadaltë për shkak të karakterit natyror, që mbizotëronte në ekonomi. Shek. XVIII shënon fazën më të lartë të zhvillimit të ekonomisë në vendin tonë, gjë e cila u pasqyrua edhe në marrëdhëniet midis qyteteve, fshatrave dhe krahinave. Tregëtarë të pasur të Shkodrës, Beratit, Voskopojës zgjeruan rrjetin tregtar, duke u shtrirë në ballkan. Krahas zhvillimit ekonomik një hov të madh mori kultura dhe arti i Mesdheut, tregjet e Evropës perëndimore dhe lindore. Punimet dekorative të drurit që vishnin brenditë e banesave dhe të godinave të kultit, veshjet dhe stolitë e arit dhe argjendit, sendet e luksit etj., arritën lulëzimin e tyre të plotë. Arkitektura e kultit njohu realizimet më të larta në kishat e Voskopojës, Vithkuqit etj. Dallojnë piktorët Kostandin Shpataraku, Vellezërit Zografi, David Selenica, të cilët derdhën talentin e tyre në këto monumente. Në trevën e Korçës gjatë kësaj kohe lulëzuan qendrat e ndodhura kryesisht në thellësi, në troje të mbrojtura malore, si Vithkuqi, Nikolica, Shipska etj., e mbi të gjitha Voskopoja, e cila gjatë shek. VIII u bë një nga qendrat ekonomiko-kulturore më në zë të vendit. Më 1720 Voskopoja u pajis me shtypshkronjë, ndërsa në 1744 u ngrit “Akademia e Re”, programi mësimor i të cilës ishte i njëjtë me atë të shkollave të mesme të vendeve më të përparuara të Evropës. Zhvillimi i urbanistikës, arkitekturës, dëshmohet nga rrugët e gjera e të drejta të shtruara me kalldrëm që kanë mbetur deri në ditët tona, si dhe nga ndërtimi i pesë bazilikave madhështore, përveç ndërtimeve të tjera që i shoqëronin ato. Brenda një periudhe të shkurtër, tri nga këto azilika u ndërtuan për katër vjet,

që përbën një të dhënë tjetër për mundësitë e mëdha ekonomike, ndërsa vlerat e pikturave që vishnin muret e pikturuara nga mjeshtrat më në zë, dëshmojnë për kërkesat e larta artistike të shoqërisë së asaj kohe. Përsa i përket elementëve kulturorë dhe arsimorë, popullsia e gjithë trevave të qarkut karakterizohet nga tradita të pasura, të ndërthurura me elementë të civilizimit dhe të qytetarisë, që kanë ndihmuar në zhvillimin e kulturës mbarëkombëtare. Ajo ka qenë gjithnjë arsimdashëse dhe punëdashëse. Këto vlera u kurorëzuan në vitin 1887 me hapjen e Shkollës së Parë Shqipe në Shqipëri dhe në vitin 1891 me çeljen e Shkollës së Vashave, ndërkohë që figura të shquara të Rilindjes Kombëtare si Naum Veqilharxhi, Mihal Grameno, Thimi Mitko, Petro Nini Luarasi, Pandeli Sotiri, Jani Vreto, Sevasti Qiriaz, Aleksandër Drenova (Asdreni), Jovan Cico Kosturi etj., kanë kontribuar në përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare brenda dhe jashtë vendit.

Niveli i arsimit të popullsisë paraqitej i mirë dhe me premisa në rritje drejt arsimit të lartë. Kjo dëshmohet nga numri i madh i shkollave në arsimin parauniversitar. Në Bashkinë e Korçës ndodhen 3 gjimnaze të përgjithshme, 1 shkollë e mesme me orientim gjuhësor, 2 shkolla të bashkuara (klasa I-XII), 2 shkolla të mesme profesionale dhe 2 gjimnaze jopublike. Shkolla e bashkuar ndodhet në njësinë administrative Mollaj, ndërsa gjimnazet e tjera janë në qytetin e Korçës. Numri i nxënësve që mësonin në këto shkolla në vitin akademik 2019-2020 ishte 2228 nxënës, ndërsa në vitin 2024-2025 ishin të regjistruar 1365 nxënës.

Trevat e Korçës dallohen për tradita të vjetra në punimet artizanale, si qëndistari, punimin e leshit, poçeri, punim të metaleve, gurit, drurit etj., kështu që mendojmë se do ishte me vlerë zhvillimi i kurseve në këto specialitete të kërkuara në tregun turistik.

Arsimi i lartë aktualisht luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen me specialistë të fushave të ndryshme, të inkuadruar në zhvillimin ekonomik e social të gjithë rajonit e më gjerë. Tregues të nivelit të lartë të arsimit është prania e Universitetit publik "Fan S. Noli" në qytetin e

Korçës, në të cilin ndodhen katër fakultete: Fakulteti i Bujqësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane dhe Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë. Në këtë universitet studiojnë rreth 5000 studentë. Programet e studimit “Marketing-Turizëm”, “Histori-Gjeografi” ndihmojnë në forcimin e njohurive në fushën e turizmit dhe të trashëgimisë, duke ndihmuar në përgatitjen e specialistëve në këto fusha. Nisur nga tërheqja turistike dhe interesi i saj në rritje drejt trashëgimisë kulturore, pasurimi i programeve të studimit me profile më të specializuara nga këto fusha, do t’i vinte në ndihmë orientimit të zhvillimit social-ekonomik drejt turizmit kulturor. Bashkia e Korçës trashëgon objekte me vlera të rëndësishme kulturore dhe historike, me rëndësi rajonale, kombëtare e më gjerë, si objekte arkeologjike, sende të ndryshme me vlerë: ikona, dorëshkrime, libra dhe periodikë, të cilët ruhen në muzetë e qytetit të Korçës: *Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar*, *Muzeu i Arsimit*, *Muzeu Arkeologjik*, *Muzeu Bratko*, *Shtëpia muze e piktorit Vangjush Mio*, *Fonoteka Sotiri*, *Muzeu i fotografisë Gjon Mili*.

Në territorin e bashkisë ndodhen mjaft objekte kulturi që për vlerat që mbartin gëzojnë statusin e “*Monumentit të kulturës*”, Përmendim *manastirin e Shën Prodhomit (1634)*, *kishën e Shën Thanasit (1724)*, *kishën e Shën Kollit (1747)*, *kishën e Shën Mëhillit (1722)*, *kishën Fjetja e Hyllindëses (1712) në Voskopojë*, *kishën e Shën Gjergjit (1838, Dardhë)*, *kishën e Shën Gjergjit, Shipskë*, *kishën e Shën Mëhillit (1682)*, *Manastirin e Shën Pjetrit dhe Pavlit (1764)*, *kishën e Shën Gjergjit (shek. XVIII) dhe kishën e Shën Mërisë (Vithkuq)*, *kishën e Ristozit (1389-Mborje)*, *kishën e Shën Jovanit dhe Shën Mitrit (Boboshticë)*.

Me veshjet popullore, prodhimet e artizanatit në dru, gur, tekstile, qëndisje dhe thurje si dhe punimet prej metali, trashëgimia etnografike përbën një pjesë të trashëgimisë kulturore shqiptare, me vlera të pazëvendësueshme. Trashëgimia dhe ruajtja e kostumeve popullore të zonave të veçanta të trevave të Korçës, fshatit dhe qytetit është një element mjaft i rëndësishëm për t’u vlerësuar. Referuar morisë së

studimeve arkeologjike, historike dhe kulturore, studiuesja dhe etnografa Andromaqi Gjergji ka bërë klasifikimin e veshjeve popullore shqiptare të burrave dhe grave, nga ku do të prezantojmë tipet kryesore të tyre në zonën e Korçës. Veshja e burrave me fustanellë, kostumi me këmishë të gjatë e dollama (cibun), veshja me poture, veshja e grave me këmishë të gjatë dhe një përparëse. Karakteristikë për trevat e Korçës janë edhe veshjet e modës qytetare për burra dhe gra, të pranishme atje ku kushtet e zhvillimit ekonomik ishin pjekur për një asimilim të tillë. Përmendet veshja me dolloma të gjatë e xhybe me gëzof, që mbanin burrat ortodoksë të qytetit të Korçës, të Voskopojës që nga shekulli XVIII deri në shpalljen e Pavarësisë. Veshja me origjinë qytetare ishte ajo që mbanin gratë ortodokse të qytetit të Korçës në çerekun e fundit të shek. XIX, përfaqësuar nga fustane të gjera të shoqëruara me një xhybe cohe të zezë, me gëzof te qafa e me shami të zezë në kokë. Veshjet e grave ishin të zbukurura me qëndisma dhe stoli metalesh të çmuara dhe shoqëroheshin me byzylykë, breza metalikë, kollanë, unaza etj., kryesisht të përdorshme në raste të veçanta dhe raste festash. Ndonëse në kulturën shpirtërore të bashkisë Korçë nuk ka elementë të mirëfilltë të trashëgimisë shpirtërore të mbrojtur me statusin e trashëgimisë shpirtërore kombëtare, këtu gjejmë vlera të cilat janë trasmetuar brez pas brezi deri në ditët tona dhe kanë nevojë të vlerësohen dhe të mbrohen (Menkshi E., 2020).

I.4. VENDBANIMET DHE POPULLSIA

Nisur nga karakteristikat e relievit dhe lartësia mbi nivelin e detit, që i japin territorit të bashkisë karakter malor, vendbanimet janë vendosur në pjesën më të madhe në territore me kushte natyrore të përshtatshme për të jetuar. Në varësi të vendosjes së tyre dallohen tre tipe vendbanimesh: *vendbanime fushore* të vendosura në fushëgropën e Korçës, si: (qyteti i Korçës, fshati Shamoll, Malavec, Bulgarec, Lumalas, Ciflik, Turan, Ravonik, Qatrom dhe Mollaj; *vendbanime kodrinore*, fshatrat: Kuçi i Zi, Neviçisht, Dishnicë, arç, Mborje, Drenovë, Boboshticë, Kamenicë, Floq, Ujëbardhë, Pulahë, Dërsnik, Polenë, Voskop, Goskovë, Vinçan, Porodinë dhe Melçan; *vendbanime malore*, Dardhë, Krushovë, Shipskë, Voskopojë, Gjonmadh, Goskovë, Lavdar, Bozdovec, Mazrekë, Tudas, Xerie, Lekas, Shkozanjë, Gjergjevicë, Popovinë, Marjan, Gjonbabas, Gurmujas, Cemicë, Shtyllë, Vithkuq, Panarit, Rehovë, Grabockë, Trebickë, Treskë, Stratobërdhë, Lubonjë dhe Roshanj, të cilat shtrihen mbi 1000 m mbi nivelin e detit etj.

Pas vitit 1990, si rezultat i ndryshimeve politike që ndodhën në Shqipëri, këto zona u prekën masivisht nga lëvizja hapësinore e popullsisë, e cila u shoqërua me rënie të numrit të saj. Një nga efektet më të rëndësishme sociale ishte lëvizja e popullsisë brenda dhe jashtë vendit si dhe ndryshimet në strukturat e saj.

Nga të dhënat statistikore, por edhe nga evidentimi në terren largimi i popullsisë është evident në zonat rurale të bashkisë por edhe në qytetin e Korçës. Mundësitë e pakta të punësimit, niveli i ulët i të ardhurave, largësia dhe infrastruktura e dobët rrugore, në lidhje me qendrën e bashkisë dhe pjesët e tjera të vendit, konsiderohen ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në situatën e krijuar pas viteve '90.

Destinacionet kryesore të migrimit të popullsisë janë drejt Greqisë, Italisë, SHBA-së dhe Kanadasë. Migrimi brenda vendit u shoqërua me lëvizje të popullsisë kryesisht në drejtim të qyteteve Tiranë, Durrës, Elbasan, Berat, Fier, Vlorë etj. Pjesa më e madhe e atyre që kanë migruar (65%) i përkiste moshave të reja nga 20-34 vjet. Një tjetër destinacion i migrimit të popullsisë është zhvendosja nga fshati drejt qytetit, por edhe nga fshati në fshat.

Popullsia fshatare u shpërngul nga fshatrat malorë Lekas, Shtyllë, Lavdar, Panarit, Gorë, Moglicë, etj., kryesisht drejt qytetit të Korçës. Vitet e fundit popullsia në zonat e thella malore është zvogëluar aq shumë, sa disa fshatra të thellë malorë gati janë shpopulluar me më pak se 200 banorë. Si rezultat i lëvizjeve migruese brenda dhe jashtë vendit, ndryshoi edhe raporti midis popullsisë së fshatit dhe qytetit.

Mungesa e alternativave të zhvillimit, ka bërë që në një pjesë të mirë të zonave rurale të vazhdojë prirja e popullsisë për t'u larguar në drejtim të qytetit, veçanërisht të rinjtë. Kjo braktisje është shoqëruar me probleme në infrastrukturë, shërbime (pothuajse nuk funksionojnë) dhe mjedis, duke shtuar përpara institucioneve qendrore dhe vendore nevojën e analizimit të resurseve të territorit dhe rishikimin e mundësive për rijetëzimin e këtyre zonave. Dëndësia e popullsisë në bashkinë e Korçës është 80 b/km², ku dëndësinë më të madhe e ka qyteti i Korçës 200 banorë për km², kurse më të vogël e kanë fshatrat e malore Lekas.

Aktualisht bashkia Korçë popullohet nga 60754 banorë në 18 658 familje (Cens, 2023). Shpërndarja e popullsisë sipas njësive administrative është e ndryshme, ku përqendrimin më të madh të popullsisë e ka qyteti i Korçës me 43 254 banorë dhe numrin më të vogël të banorëve e ka njësia administrative Lekas me 201 banorë. (shih.tab.1).

Sipas përbërjes gjinore numrin më të madh e zënë femrat me 30 465, kundrejt meshkujve që përbëjnë 30 289 të numrit të përgjithshëm të banorëve në gjithë territorin e bashkisë. Struktura moshore e popullsisë së bashkisë Korçë përfaqësohet nga 7 930 individë të moshës 0-14 vjeç (13 %), 37 460 individë të moshës 15-64 vjeç (61.6 %) dhe 15 364 individë të moshës mbi 65 vjeç (25.4 %) (Cens, 2023). Të dhënat statistikore janë tregues të rënies së numrit të lindjeve në bashkinë Korçë dhe rritjes së përqindjes së popullsisë në moshën e tretë.

Rreth ¼ e popullsisë së bashkisë Korçë janë mbi 65 vjeç, çka tregon për një plakje të popullsisës të bashkisë. Popullsia jo shqiptare që jeton në bashkinë e Korçës zë vetëm 0.5 % të popullsisë bashkiake ose 316 persona.

Përsa i përket elementëve kulturorë dhe arsimorë, popullsia e gjithë trevave të qarkut karakterizohet nga tradita të pasura, të ndërthurura me elementë të civilizimit dhe qytetarisë, që kanë ndihmuar në zhvillimin e kulturës mbarëkombëtare. Ajo ka qenë gjithnjë arsimdashëse dhe

punëdashëse. Këto vlera u kurorëzuan në vitin 1887 me hapjen e Shkollës së Parë Shqipe në Shqipëri dhe në vitin 1891 me çeljen e Shkollës së Vashave, ndërkohë që figura të shquara të Rilindjes Kombëtare si Naum Veqilharxhi, Mihal Grameno, Thimi Mitko.

Nr.	Njësitë Administrative	Sip.në km ²	Popullsia	% ndaj popullsisë së bashkisë	Dendësia b/km ²
1.	Qyteti Korçë	17	43 254	71	2 544
2.	Nj.A. Qendër Bulgarec	77	6 475	10.6	84
3.	Nj.A.Drenovë	92	4 501	7.4	49
4.	Nj.A.Mollaj	69	2 615	4.3	38
5.	Nj.A.Voskop	72	2 279	3.7	31.6
6.	Nj.A.Vithkuq	243	918	1.5	3.7
7.	Nj.A.Voskopojë	135	511	0.8	3.7
8.	Nj.A.Lekas	122	201	0.7	1.6
	Bashkia Korçë (Total)	827	60 754	100	73

Tab.8 Shpërndarja dhe dendësia e popullsisë sipas Nj.A. në bashkinë Korçë

Burimi: Cens, 2023 dhe Arc GIS 10.1.

I.5 ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PERSPEKTIVA

Pasuritë natyrore dhe ato njerëzore kanë bërë që Korça të jetë një zonë e zhvilluar në të gjitha periudhat kohore. Në shekujt XVII–XVIII spikatën qendrat e para zejtaro-tregtare, si Voskopoja, Vithkuqi, Shipska në bashkinë e Korçës, të cilat njohën një zhvillim të rëndësishëm për vendin dhe qytetërimet e asaj kohe. Voskopoja në shekullin XVIII u zhvillua me ritme të shpejta si për nga rritja e popullsisë, ashtu edhe për nga zgjerimi i veprimtarive social-ekonomike duke marrë tiparet e një qendre urbane. Ekzistenca e shumë zejeve i dha shkas zhvillimit të shpejtë të tregtisë. Voskopojarët tregtonin jo vetëm në krahinat e vendit, por edhe në vende të ndryshme të Europës Qëndrore, Lindore dhe Jugore. Zhvillimi i artizanatit të tekstileve të leshta u shoqërua me prodhimin e artikujve të ndryshëm, të preferuar në shtroje (qilima, levenxa, etj) dhe veshmbathje. Përmenden gjithashtu mjeshtërit kovaçë, jorganxhinjtë, muratorët, gurëskalitësit, lëkurëregjësit etj. Prania e objekteve të shumta të kultit (kisha) dhe objekteve me karakter kulturor, si edhe stili qytetar i jetesës kanë qenë dëshmi e nivelit të lartë kulturor. Pas shkatërrimit të Voskopojës, jeta ekonomike mori zhvillim në qytetin e Korçës. Ndikuar nga pozicioni gjeografik në kryqëzimin e rrugëve që lidhnin lindjen me perëndimin në shekullin XIX, Korça u bë një nga qendrat e rëndësishme ekonomike dhe kulturore në Shqipërinë juglindore. Në fillim të shekullit XX Korça figuronte si një qendër me tipare kapitaliste në zhvillim.

Gjatë periudhës 1945-1990 ekonomia e Shqipërisë cilësohet si më e izoluara dhe më e prapambetura. Në këtë periudhë fushëgropa e Korçës përbënte njësinë e dytë më të rëndësishme fiziko-gjeografike në Shqipëri për nga prodhimet bujqësore (pas Ultësirës Perëndimore). Gjatë kësaj periudhe rëndësia që iu dha zhvillimit të industrisë së rëndë çoi në rritjen e shfrytëzimit të burimeve të qymyrgurit dhe ngritjen e ndërmarrjeve industriale. Industria minerare përfaqësohej nga nxjerrja e qymyrgurit përkatësisht në Mborje-Drenovë, Lozhan,

Rehovë. Rehova (Vithkuq) dallohej gjithashtu për nxjerrjen e bakrit dhe po këtu u ngrit edhe Uzina e Pasurimit të Bakrit. Deri në fundin e viteve '80 struktura e ekonomisë në bashkinë e Korçës mbizotërohej nga industria e lehtë dhe ushqimore, (1960-1990). Kjo industri u përfaqësua nga një sërë ndërmarrjesh të përqendruara më së shumti në qytetin e Korçës. Në fundin e viteve '80, si në të gjithë vendin, edhe kjo zonë filloi të përballej me vështirësi të dukshme në aspektin social dhe ekonomik. Politikat e punësimit gjithëpërfshirës nuk justifikonin praninë e mallrave të konsumit jetik dhe për rrjedhojë as nivelin e jetesës dhe të mirëqënies së popullsisë.

Ndryshimet politike dhe social-ekonomike që ndodhën në Shqipëri pas viteve '90 në të gjithë vendin, patën një ndikim të dukshëm edhe në bashkinë e Korçës. Ndërmarrjet shtetërore filluan të privatizoheshin dhe një numër i madh i tyre dolën jashtë funksionit. Ndërkohë një pjesë e popullsisë që ishin të punësuar në to mbeti e papunë. Sektori privat filloi të zhvillohej me shpejtësi sidomos pas viteve 2000, çka u shoqërua me rritjen e veprimtarive ekonomike në këtë sektor. Aktualisht në territorin e bashkisë kryejnë veprimtari ekonomike 3454 subjekte nga të cilat 44 në sektorin shtetëror, 3366 në sektorin privat dhe 44 OJF (Organizata jofitimprurëse). Bazën e biznesit e përbëjnë bizneset shumë të vogla dhe të vogla 2666 biznese, ndërsa bizneset e mesëm dhe të mëdhenj 700 biznese. Pjesa më e madhe e të punësuarëve janë në sektorin privat, kryesisht në sektorin e ndërtimit, tregtinë me pakicë, fasoneri, që siguron një pjesë të madhe të punësimit të femrave. Të punësuarit në sektorin shtetëror janë kryesisht në pozicionet e nëpunësve të administratës publike, specialistë, ekonomistë, juristë të punësuar në sektorin e shëndetësisë: mjekë, infermierë, teknikë, punëtorë, etj. Për sa i përket nivelit të papunësisë, në bashkinë e Korçës rezultojnë të regjistruar 2006 persona të regjistruar si punëkërkuar të papunë. Përsa i përket nivelit arsimor, numrin më të madh e zenë të papunët me arsim 9-vjeçar dhe me arsim të mesëm. Shkalla e papunësisë është edhe më e lartë pasi një pjesë e personave të papunë nuk janë të regjistruar në Zyrën e Punësimit.

Niveli i mirëqenies së popullsisë paraqitet i ndryshëm në zona të ndryshme të qarkut. Të ardhurat që sigurohen nga emigracioni, përbëjnë një ndihmesë për një pjesë të mirë të familjeve. Këto të ardhura janë dhe vazhdojnë të përdoren kryesisht për ndërtime banesash, në bujqësi dhe në disa raste për hapjen e bizneseve. Niveli i varfërisë është i lartë, sidomos në zonat e thella malore.

Resurset e pasura natyrore, tokat pjellore, emigracioni janë faktorë që kanë ndikuar në nivelin e mirëqenies së popullsisë në zonat rurale, por numri i familjeve në skemën e ndihmës ekonomike mbetet ende i lartë. Pjesa më e madhe e popullsisë në fshat i siguron të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Problem për këtë kategori përbën mungesa e një tregu të garantuar, që në disa raste shoqërohet edhe mbetjen stok të produkteve të fshatarëve.

Zhvillimi ekonomik bazohet tek disa sektorë të zhvilluar siç është bujqësia dhe blegtoria në zonat rurale, tregtia, ndërtimi, sektori agropërpunues, tekstilet dhe turizmi. Në prodhimin e përgjithshëm bujqësor, vendin kryesor e zë dega e bujqësisë. Në pjesën më të madhe të tokave të punueshme janë kultivuar bimët e arave (gruri, misri), drurët frutorë, foragjeret për blegtorinë dhe perimet. Bashkia e Korçës është dalluar tradicionalisht si një nga furnizuesit kryesorë të tregut me fruta dhe sidomos me mollë. Klima e favorshme, tokat pjellore dhe përdorimi me racionalitet i plehrave kimikë mundësojnë që prodhimet e gjithë zonës të dallohen si produkte bioorganike. Problematike për sektorin e bujqësisë dhe për fermerët mbetet sigurimi i tregut për produktet e tyre. *Sektori i blegtorisë* ka arritur të plotësojë më së miri nevojat për ushqim të popullsisë, si dhe të industrisë përpunuese. Zonat rurale dallohen kryesisht për rritjen e gjedhit dhe dhenve në fshatrat malorë.

Pasuritë e shumta natyrore, mundësitë e mira të komunikacionit në hapësirat brenda dhe jashtë vendit dhe fuqia punëtore e kualifikuar janë disa nga faktorët që kanë mundësuar zhvillimin e industrisë. Kjo pjesë e zhvillimit ekonomik po tenton të strukturohet drejt degëve të reja, në të cilat me përparësi për zhvillim *Industria agropërpunuese* është e

zhvilluar kryesisht në sigurimin e lëndës së parë në vend për përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Sot në bashkinë e Korçës, në industrinë ushqimore, sektorë prioritarë janë: industria e përpunimit të drithrave, industria e përpunimit të mishit, qumështit, e përpunimit të frutave dhe perimeve, e prodhimit të pijeve alkolike, konservave, sallamit, duhanit etj. Rol të rëndësishëm luan prania e fabrikave të përpunimit të produkteve blegtorale (baxhot) të pajisura me teknologji bashkëkohore, ndërkohë që ruhet edhe tradita e përpunimeve në mënyrë artizanale.

Industria e prodhimit të alkoolit, pijeve alkoolike, si e verës, birrës, konjakut, prodhimi i pijeve të buta (lëngjeve) etj., furnizon tregun me produkte tradicionale. Këtu mund të përmendim kantinën “Rilindja”, “Korça 2000”, “Birra Korça” dhe disa punishte tradicionale të prodhimit të verës.

Sektorit i tekstileve është i zhvilluar kryesisht në trajtën e ndërmarrjeve që operojnë me kapital të huaj ose me sipërmarrje të përbashkëta të realizuara nga biznesmenë shqiptarë dhe grekë. Në përgjithësi këto ndërmarrje importojnë lëndën e parë (fasonë) dhe i kanë tregjet e siguruar kryesisht jashtë vendit. Ky sektor përbën edhe tregun më të madh të punësimit për gratë dhe vajzat.

Rol të ndjeshëm në zhvillimin e bashkisë Korçë po merr *sektori terciar* veçanërisht *infrastruktura*, *transporti* dhe *turizmi*. Pozicioni gjeografik i qarkut (nëpërmjet pesë doganave) ofron kontakt të drejtpërdrejtë me Greqinë dhe me Maqedoninë e Veriut. Rrjeti rrugor siguron lidhje hapësinore të qendrave urbane me qarqet e tjera dhe vendet fqinjë, sikundër edhe lidhjen me të gjitha njësitë administrative. Në infrastrukturën rrugore janë bërë investime dhe përmirësime në rrugët që lidhin qytetin e Korçës me zonat rurale përreth. Përmirësimet në infrastrukturë kanë lehtësuar jo vetëm përdorimin e burimeve natyrore, por kanë nxitur zhvillimin e turizmit në zonat malore me interes të veçantë si në Voskopojë, Dardhë, Vithkuq, Boboshticë, etj. Vlen për t’u theksuar se turizmi është një ndër sektorët ekonomik, që po zhvillohet me ritme të shpejta. E përcaktuar tashmë si destinacion


turistik në zhvillim, bashkia Korçë ofron mundësi dhe sfida drejt zhvillimit të një turizmi të qëndrueshëm, çka do të ndikojë në rritjen e të ardhurave dhe në përmirësimin e jetës së komunitetit në territorin e saj.

Shërbimi i telefonisë fikse dhe celulare në bashkinë e Korçës sigurohet nga operatorë privatë: Vodafon, ONE, që operojnë në qytetin e Korçës dhe zonat rurale duke siguruar sinjal të pandërprerë.

Nga ana tjetër, potencialet kulturore përfaqësohen nga vendet arkeologjike, objekte të shumta të kultit, të traditave kulturore dhe fetare. Vlerave natyrore dhe kulturore u bashkohen edhe traditat dhe niveli i lartë kulturor dhe i qytetarisë së popullsisë. Në funksion të zhvillimit të turizmit është ndërtuar edhe infrastruktura turistike me shërbimet hoteleri, restorante, banka etj.

2.1 NJËSIA ADMINISTRATIVE KORÇË (Qyteti i Korçës)

Qyteti i Korçës përbën qendrën urbane të bashkisë dhe qarkut Korçë. Gjeografikisht gjendet në verilindje të bashkisë në një sipërfaqe prej 17 km², ose 2 % të sipërfaqes së bashkisë. Kufizohet me Nj.A. Qendër Bulgarec dhe Nj.A. Drenovë. Territori i qytetit të Korçës gjendet midis 40° 36'18'' e 40° 38'59'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 43'50'' e 20° 47' 46'' gjatësi gjeografike lindore. Distanca km veri-jug është 4.9 km, ndërsa distanca lindje-perëndim është 7.2 km.



Harta 3. Shtrirja gjeografike e Njesisë Administrative Korçë (Qyteti i Korçës) Burimi: Arc GIS 10.1. bazuar në Hartën Administrative të Shqipërisë 1:200 000 të prodhuar GC C në 1999. (B:E.Braholli)

Qyteti i Korçës shtrihet në fushëgropën e Korçës dhe pjesërisht në rrëzën e malit të Moravës. Lartësia më e ulët është 829 m mbi nivelin e detit dhe lartësia më e lartë është 980 m mbi nivelin e detit. Korça si qendër e qarkut karakterizohet nga një pozitë gjeografike e favorshme. Në nivel kombëtar ajo është pjesë e një rrjeti të gjerë të qyteteve shqiptare, ndërkohë që në kontekstin rajonal, përta i përket madhësisë, popullsisë, administrimit, aktiviteteve ekonomike dhe kulturore, qyteti përbën qendrën kryesore urbane të rajonit juglindor të Shqipërisë.

Lokacioni gjeografik i qytetit ka mundësuar lidhje të rëndësishme të komunikimit me Shqipërinë dhe rajonin. Nëpërmjet transportit rrugor qyteti lidhet me qendrat urbane në veri dhe në jug të Shqipërisë. Largësia e disa qendrave të rëndësishme nga qyteti i Korçës është përkatësisht: 163 km nga kryeqendra e vendit Tirana, 189 km nga qendra e jugut Gjirokastra.

Favorizuar nga pozicioni gjeografik, roli i qytetit konsiderohet gjithashtu i rëndësishëm edhe në këndvështrimin historik ndërrajonal, ku dominojnë lidhjet e hershme me qendrat urbane në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Ohrin, Manastirin, Shkupin) dhe në Greqi (Kosturin, Follorinën dhe Selanikun). Qyteti i Korçës ndodhet në një territor ndërkufitar me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut. Nëpërmjet doganës së Kapshticës (30 km) Korça lidhet me Selanikun në Greqi në një distancë prej 248 km dhe nëpërmjet doganës së Tushemishtit (41 km) Korça lidhet me Ohrin në një distancë prej 75 km dhe nëpërmjet doganës së Goricës së Madhe me Bitolën në Maqedoninë e Veriut në një distancë prej 66 km. Pozicioni gjeografik dhe faktorët natyrorë, kanë ndikuar në shtrirjen dhe zgjerimin e qytetit, në orientimin e sistemit rrugor apo orientimin e ndërtimeve nga lindja drejt perëndimit.

Korça, si njësi administrative, gjendet në zonën tektonike të Mirditës dhe gropave Ndërmalore (cito gjeologjinë). Të pranishëm janë depozitimet aluviale (alevrolite, rëra, zhavore) të Holocenit dhe depozitive deluviale-koluviale dhe aluviale të Pleistocenit (Harta gjeologjike 1:200 000).

Në aspektin fiziko-gjeografik qyteti shtrihet në lindje të fushëgropës së Korçës dhe pjesërisht rrëzë kodrave të Partizanit (kodrat e Shën Thanasit dhe e Shëndëllisë). Morfologjia e relievit me pjerrësi nga lindja në drejtim të perëndimit ka kushtëzuar zgjerimin dhe shtrirjen e qytetit në pjesën më të madhe të tij, në drejtim të perëndimit. Kodrat përfaqësojnë mbetje terrigjene (mbizotërim të argjilave) të strukturës grabenore të Korçës (Gruda, 2020), (Qiriaz, 1985).

Klima është tipike mesdhetare paramalore, me ndikim të masave ajrore që vijnë nga kontinenti. Kushtet klimatike të qytetit të Korçës janë ndikuar nga pozicioni gjeografik dhe në veçanti gjerësia gjeografike. Korça ndodhet në gjerësinë gjeografike veriore $40^{\circ} 36' 22''$. Gjerësia gjeografike si faktor klimatik, përcakton këndin e rënies së rrezeve të diellit, gjatësinë e ditës, pozitën në raport me rrymat ajrore. Përveç gjerësisë gjeografike, faktorë të rëndësishëm klimatikë për qytetin e Korçës janë relievi (lartësia mbi nivelin e detit 870-900 m), ekspozimi në raport me malet përreth largësia nga deti, pozita në raport me rrymat lokale të ajrit etj.

Vlera mesatare vjetore e energjisë së përgjithshme të **rrezatimit diellor** është relativisht e lartë 1414.29 këh/m^2 me një mesatare prej rreth 144 këh/m^2 në muaj.

Vranësirat luajnë rol të rëndësishëm në kushtet e motit të qytetit dhe në jetën e banorëve. Të mbuluarit e qiellit me vranësira luhet nga muaji në muaj. Në paraqitjen me vranësira ndikojnë faktorë të ndryshëm ndër të cilët edhe relievi. Në Korçë numri më i madh i ditëve me vranësira është në muajt dhjetor 14 ditë, janar 13 ditë, shkurt 12 ditë dhe mars 13 ditë. Numri më i madh i ditëve të kthjellëta rezulton në vitet 1981-1985 me 102 ditë.

Temperatura e ajrit është element i rëndësishëm i motit, që bën lëkundje të ndryshme gjatë ditëve, muajve, viteve. Temperatura mesatare e ajrit në Korçë varet nga gjerësia gjeografike, relievi, lartësia mbi nivelin e detit etj. Temperatura mesatare vjetore e ajrit në Korçë është 10.5°C , në muajin korrik është $+20^{\circ}\text{C}$ dhe në gusht është 0.5°C . Muaji më i ftohtë i vitit është janari me temperaturë minimale -6°C .

pastaj dhjetori me -4°C . Temperatura maksimale absolute ka arritur deri në 34°C . Me rëndësi në aspektin klimatik janë ditët me ngrica, sidomos fillimi dhe mbarimi i tyre. Gjatë muajve të dimrit në Korçë paraqiten disa ditë në të cilat temperatura mesatare ditore kalon nën 0°C . Rol të rëndësishëm në temperaturat e ulëta në Korçë luan lartësia e relievit, masat e ftohta të ajrit që vijnë nga pjesa lindore e qytetit.

Në Korçë dhe në fushëgropën e Korçës ekzistojnë kushte të përshtatshme për paraqitjen e **mjegullës** gjë që lidhet edhe morfologjinë e relievit. Fushëgropa e Korçës është e rrethuar me male në lindje dhe perëndim. Mjegulla qëndron nga disa orë në disa ditë. Numri më i madh i ditëve me mjegull paraqitet në muajin dhjetor (12 ditë) në muajin janar (10 ditë) dhe numri më i vogël në korrik (3 ditë) dhe gusht (5 ditë).

Reshjet janë element i rëndësishëm klimatik me ndryshime horizontale dhe vertikale. Sasia e reshjeve është përcaktues i disa elementëve të mjedisit gjeografik. Sasia mesatare vjetore e reshjeve për Korçën është 650-700 mm, ndërsa faktorët që kanë ndikuar është afërsia me malin e Thatë, ose masat ajrore ose një faktor tjetër. Regjimi i reshjeve në Korçë i takon më tepër regjimit mesdhetar ku sasia e madhe e tyre bie në dimër sesa në verë. Reshjet bien në formën e shiut dhe të dëborës. Dëbora haset më shumë në muajin e janarit. Trashësia maksimale e borës ka arritur deri në 30-40 cm. Dekadat e fundit klima dhe elementët klimatikë kanë pësuar një çrregullim rrjedhojë edhe e ndryshimeve klimatike në nivel global.

Territori i njësisë administrative bën pjesë në **pellgun ujëmbledhës të lumit të Dunavecit**, degë e majtë e lumit Devoll. (Pano, 2016)

Tokat janë kryesisht të brezit të kafenjtë. Tokat e fushëgropës së Korçës janë të pasura me humiditet me veti fiziko-kimike mjaft të mira për kultivimin e kulturave bujqësore.

Zona përreth qytetit të Korçës, për shkak të krakteristikave klimatike dhe të relievit, është e pasur me **botën bimore**. Megjithë zgjerimin e zonës urbane në vitet e fundit, qyteti ka mundur të ruajë vegjetacionin dhe hapësirat e gjelbra. Qyteti rrethohet nga një kurore e gjelbër, në

kodrat përreth (kodrat e Moravës) të pyllëzuar me dushqe, pishë, bredh dhe ahishte. Brenda zonës urbane hasen hapësira të gjelbëra të cilat përfaqësohen nga parqet, lulishtet, hapësirat midis ndërtimeve etj. Parku "Rinia", është parku urban më i madh i qytetit.

2.1.1.Konteksti historik

Gjetjet arkeologjike (vendbanime, vendvarrime, fortifikime) që janë zbuluar në zonat përreth qytetit të sotëm të Korçës, si në Maliq, Vashtëmi, Dunavec, Barç, Kamenicë, Mborje etj. dëshmojnë për ekzistencën e jetës dhe vazhdimësinë e pandërprerë të saj, që në prehistori (Menkshi, 2020). Referuar këtyre dëshmive, studiuesit mendojnë se qyteti mund të ketë ekzistuar si vendbanim qysh në antikitet, megjithatë origjina e krijimit dhe ekzistencës së tij, është ende e diskutuar në mes të studiuesve. Dokumentet kishtarë dhe burimet e shkruara e përmendin Korçën si vendbanim, në gjysmën e parë të shek. XV (Selenica, 1928). Të dhëna për ekzistencën e qytetit përcjellin edhe shkrimet e Gjon Muzakës (1510), feudal shqiptar, i cili në një testament të lënë prej paraardhësit të tij Andrea Muzaka (1280-1319) Sebastokrator, përmend si zotërime të Muzakajve, krahas Myzeqesë, Tomoricës, Oparit, Devollit, Kosturit edhe Korçën (Pepo, 1981). Në Kodikun e Korçës dhe Selaforit (shek.XVIII-filling shek.XX), shkruhet se në regjistrat osmanë të viteve 1431-1432, bëhet fjalë për një kala të banuar që numëronte 26 shtëpi, pranë së cilës ndodheshin Mborja me 90 shtëpi dhe Peskepja me 70 shtëpi (Pepo, 1981).

Në qoftë se do t'i referohemi studiuesit Nuçi Naçi, në librin e tij "Korça dhe fshatrat për qark", në vitin 1900 ai shkruan se "*...Korça përpara 1487 ka qenë një fshat i vogël me bujq, që ka pasur jo më shumë se 10-15 shtëpi dhe atëherë quhej Pes-stëpi...dhe kishin një kishë me emër Shën e Premte..Koxa Mirahori e bleu, e bëri së pari teqe dhe pastaj xami dhe kjo sot është xami e madhe*". Po këtu studiuesi shprehet "*...se në një ferman, Sulltan Bajaziti II, i fal Koxha Mir'ahorit viset e Gjorxesë....*", Gjorxhesë. Kjo fjalë është turqisht dhe në shqip do të


thotë “*shiko dhe shko*” (N.D.N., 1901). Diskutimet e studiuesve në lidhje me origjinën e emrit dhe me kohën e ekzistencës së vendbanimit janë të shumta, por themelet e qytetit u hodhën në periudhën e ngritjes së xhamisë së Iliaz Bej Mirahorit (1496) (Ramo, 2012), përreth së cilës u konfigurua forma urbane e qytetit të sotëm. Në dokumentet historike të kohës thuhet se Iliaz bej Mirahori shpërnguli pazarin pranë xhamisë dhe ndërtoi gjithashtu edhe një medrese, hamam dhe imaret (instituton bamirësie) dhe zotërimet e tij i ktheu në vakëfe (N.D.N., 1901), (Pepo, 1981), (Ramo, 2012). Këto ndërtime përbënin bërthamën e një qendre të re socio-ekonomike, tregtare dhe arsimore dhe po kështu të një qendre të re urbane, që u zgjerua në mënyrë të qëndrueshme shekujt në vazhdim. Zhvendosja e pazarit dhe nevoja e afërsisë me të, diktoi ardhjen e popullsisë nga zonat kodrinore përreth duke çuar në zgjerimin e territorit në shek. XVI, XVII me ndërtime të reja, kryesisht të tipit të banesave në drejtim të zonës fushore në perëndim dhe veriperëndim. Për sa i përket formës urbane të qytetit të Korçës, po të shikojmë hartat e vjetra, në shekullin XVIII kemi të bëjmë me një vendbanim me tri njësi kryesore përbërëse (ngastra) të ndara nga lumi i Moravës që buron nga mali me të njëjtin emër (harta 1. b). Në të djathtë të lumit në verilindje ndodhej Varoshi (popullsi ortodokse) dhe në të majtë në jugperëndim ndodhej Kasabaja (popullsi myslimane). Pazarin ndahej nga lumi, ku pjesa më e madhe e tij ndodhej pranë Kasabasë (N.D.N., 1923). Gjurmët urbanistike, për të paraqitur sa më mirë elementët dhe formën urbane të qytetit në shek XVIII, janë të zbehta (Thomo 2012). Megjithatë disa nga tiparet kryesore që kanë shoqëruar zgjerimin e qytetit në këtë periudhë kanë të bëjnë me një rritje spontane të favorizuar edhe nga terreni i butë në drejtim të fushës. Rrjeti rrugor i çrregullt, me rrugë të ngushta që krijojnë parcela të mbyllura ndërtimesh në trajtë qarqesh. Ndërtimet janë kryesisht banesa të vendosura buzë rrugës, të tipit dy katëshe, ku kati i dytë del mbi katin e parë. Oborri shoqëron banesën që rrethohet nga mure kryesisht të ulët (elementë që i konstatojmë edhe në disa banesa aktuale). Në të njëjtën kohë banesat ruajnë lidhjen e familjes me ekonominë bujqësore, duke

kushtëzuar në mjediset e tyre, praninë e një sërë mjedisesesh ndihmëse si oborri, plevicat, hajati, çardaku, ashefi, pusi (Pepo, 1981), (Riza, 1991), (Thomo, 2012). Nuk mungojnë gjithashtu ndërtimet e kultit, në veçanti kishat (në 1707 u ngrit katedralja “Burimi Jetëdhënës” etj.).

Në gjysmën e parë të shek. XIX prodhimi zejtar u rrit ndjeshëm dhe qyteti u fut në rrugën e zhvillimit të shpejtë ekonomik. Për rrjedhojë u zgjerua zona e ndërtimeve (harta 1.ç) dhe u krijuan i ansamblet e ndërtimeve sipas një ndarjeje funksionale të tyre në rezidenciale dhe ekonomike. Veprimtaria zejtare dhe tregtare ishte përqendruar tek tregu apo pazari, ndërkohë që ansamblet e banimit ishin dukshëm të veçuara. Ato vazhdojnë të ruajnë tiparet e trashëguara ndërkohë që pajisen me elementë të rinj në fizionominë e jashtme. Nga dëshmitë e kohës struktura urbanistike e banesave evidentonte ndryshimin klasor dhe fetar (myslimanë dhe ortodoksë), ku binin në sy banesat dykatëshe me oborre dhe kopshte, përkundrejt atyre të ulëta njëkatëshe të shtresave të varfëra (Pepo, 1981), (N.D.N, 1923), (Thomo, 2012). Përpos tendencës së zgjerimit me ndërtime të reja, nga pikëpamja e formës urbane, qyteti dallohet për zgjerim me parcela të reja ndërtimesh, por me probleme në mungesën e infrastrukturës (fig.c).

Në mesin e shek. XIX qyteti shënon një fazë të re të zhvillimit ekonomik, ku prodhimi zejtar mbulon gjithë veprimtarinë ekonomike dhe rrjeti i tregtisë shtrihet në të gjitha qendrat brenda dhe jashtë vendit, me një strukturë shoqërore të organizuar. Në nivel kombëtar, Korça konsolidoi pozitën administrative-krahinore dhe fuqinë ekonomike, duke u shndërruar në qendër të rëndësishme prodhimi dhe shkëmbimi në gjithë jugun e Shqipërisë. Popullsia u rrit me mbi 10 000-13 000 banorë, çka çoi në rritjen e kërkesës për ndërtime, por edhe për cilësinë e tyre (Pepo, 1981). Këto zhvillime ndikuan në fizionominë e qytetit, që përfitoi tipare të reja urbane. Siç mund të shihet edhe nga harta (d), zgjerimi i territorit në këtë periudhë konsiston me krijimin e një rrjeti të dendur ndërtimesh. Qyteti zhvillohet me ritme të shpejta përtej bërthamës së tij. Konkretisht zgjerimi i qytetit ndodh në dy akset kryesore, rrugën e Shën Gjergjit (bulevard “Shën Gjergji”) dhe rrugën

e Follorinës (sot bulevard “Republika”). Sistemi rrugor i rregullt dhe ortogonal lidh blloqet e ndërtimeve dhe ndërtimet.



Harta 4. Zgjerimi i formës urbane të qytetit të Korçës gjatë periudhave historike, (krijuar sipas planit të vitit 1920). a) qyteti shek. XVII; b) qyteti shek. XVIII, c) qyteti shek. XIX; d) qyteti fund shek. XIX-fill. shek.XX; e) qyteti gjysma e dytë e shek. XX. (Burimi: Menkshi& Braholli 2023)

Në të njëjtën kohë vlen të përmenden krijimi i lagjeve të reja dhe zgjerimi i atyre ekzistuese: Varoshi, Kasabaja, Varoshi i Poshtëm apo

Katavaroshi (N.D.N., 1901), (Thomo, 2012), (Pepo, 1981). Lagjet përshkruhen nga rrjeti i dendur rrugor me kalldrëm, me prirje për krijimin e formave të rregullta gjeometrike.

Nga ekzistenca e disa banesave të kësaj periudhe dëshmohet rregullsia që ndjek vendosja e tyre. Sigurimi i materialeve të ndërtimit nga mali i Moravës, por edhe zonat përreth qytetit, si gurët, argjila, materialet e drurit dhe metalet në vend të plitharës dhe qerpiçit të përdorur më parë, ndikuan në cilësinë e ndërtimeve dhe në pasurimin e elementëve dekorativ në pamjen e jashtme. Krahas rindërtimeve sipas tipologjisë së vjetër në këtë periudhë konstatohet lindja e një tipi të ri banese, e cila i përgjigjej kërkesave të shtresës së re të borgjezisë (Riza, 1991). Tipologjia e banesës dallohet për elementë të pasur si në pamjen e jashtme ashtu edhe në mjediset e brendshme (Thomo, 1978). Një element që vlen për t'u përmendur në arkitekturën e veçantë të ndërtimeve dhe karakterin dekorativ të tyre, është pasqyrimi në të i elementëve të kulturës përendimore të sjellë nga korçarët e udhëtuar nëpër vendet e Europës.

Ndër ansamblet ndërtimore kryesore të qytetit ishte pazari, roli i të cilit në gjysmën e dytë të shek. XIX, ishte fuqizuar duke shprehur qartë natyrën zejtaro-tregtare të zhvilluar të këtij qyteti (Riza, & Strazimiri, 1972). Pazari i Korçës, tërhiqte tregtarë dhe udhëtarë nga zonat përreth, por edhe nga vise të tjera të Shqipërisë dhe vendeve fqinje. Sipas dëshmive historike rindërtimi i pazarit pas zjarrit të vitit 1879 (u dogjën mëse 600 dyqane) nxori në pah një strukturë të rregullt ndërtimesh. Nëse shihej në hapësirën e zonës të pazarit binte në sy një ndarje funksionale e aktiviteteve prodhuese, tregtuese, nga mjediset e pushimit (hanet, 16 të tilla) (Thomo, 2012). Midis 15-16 haneve që mendohet të kenë ekzistuar, më tipikët dhe më me interes aktualisht paraqiten hani i Elbasanit, hani i Gjelit dhe hani i Manastirit, të cilët për vlerat e tyre arkitekturore gëzojnë statusin e monumentit të kulturës dhe së bashku me pazarin i janë nënshtruar rikonstruksionit të plotë. Nga dëshmitë historike gojore, fotografike, si edhe nga gjurmët që ka trashëguar pazari i sotëm sheshet e tregtimit ishin të shpërndara në pika

të ndryshme të pazarit, në të cilat tregtoheshin prodhime zejtarie, bujqësore dhe blegtorale, por edhe veshje apo produkte të tjera. Sipas dëshmive këto aktivitete/dyqane kanë qenë të përqendruara sipas zejeve (kovaçinjve, kallajxhinjve, tregtarëve të mishit, tregtarëve e bulmetit, këpucarët, rrobaqepësit, etj.). Dyqanet dykatëshe rrethonin sheshin kryesor të pazarit, ndërsa njësitë brenda pazarit lidheshin nëpërmjet tyre me një sërë rrugicash të drejta. Në fund të shek. XIX, struktura urbane e qytetit të Korçës kishte fituar kompaktësinë e vet me një fizionomi të konsoliduar urbane.



Foto 1. Pazarit i Korçës
qytetit (Korça në vitet '20 shek.XX).



Foto 2. Një nga lagjet në qendër të
Burimi: (Biblioteka e qytetit të

Korçës)

Në fillim të shek. XX qyteti kishte formuar një strukturë të rregullt urbanistike, në bazë të të cilit qëndronte sistemi ortogonal, me rrugë dhe rrugica me dritë dhe korrente ajrore për jetën ekologjike të qytetit (Velo, 2014). Popullsia e qytetit erdhi duke u rritur dhe në vitin 1927 Korça ishte qyteti me popullsinë më të madhe ndër qytetet e Shqipërisë, me 25 593 mijë banorë (Karaguni, & Alizoti, 2013).

Industrializimi i viteve 20-30 në Shqipëri pasqyrohet në qytet me ngritjen e disa fabrikave të vogla si fabrika e leshit, e tullave, e miellit, e alkoolit, e lëkurëve, e duhanit, fabrika e birrës (vitet 30) etj. Po kështu brenda territorit urban rriten ndërtimet (4000 m rrugë, me gjerësi 18, 10,8,6 m, 150-200 dyqane e shtëpi të reja sipas sistemit të ri, kanalizimi i ujërave të zeza etj.). Nuk mungojnë edhe ndërtimet me

karakter shoqëror si kinema “Luksi”, Biblioteka e qytetit (1927-30), kinoteatri “Mazhestik”, kisha e re katedralja “Burimi Jetëdhënës” (1927-1936), Spitali (1933-1934), ndërtesa e Bashkisë, etj., pa lënë pa përmendur ndërtimet e konsiderueshme të banesave private (Arkiva e Bashkisë, 1950). Një fenomen që spikat dukshëm këtu është kontributi i dhuruesve të ndryshëm (familja Turtulli) dhe ndihmesa e punës vullnetare (*Në të dhënat e bashkisë në buxhetin e viteve 30 të bashkisë ishin planifikuar fonde për punime komunale dhe ndërtimin e rrugëve, kanaleve, çezmave, por të pamjaftueshme ndërkohë që ato për ndërtime themelore mungonin*). Rritja e kërkesave të popullsisë për strehim, mungesa e investimeve shtetërore për ndërtime socio-kulturore apo administrative çuan në dominim të banesave në lagjet e vjetra ekzistuese, por edhe në territoret e reja, çka ndikoi dukshëm në zgjerimin e qytetit. Sipas të dhënave të kohës ndërtimi i lagjeve të reja sipas një skeme ortogonale dëshmon për ekzistencën një plani që ka disiplinuar ndërtimet e qytetit, që në kohën e pushtimit turk. Po kështu në arkivat e bashkisë në vitin 1910 gjendet njoftimi i parë për planin e qytetit, ku parashikohej hapja dhe sistemi i rrugëve të vjetra me gjerësi 8-12m, për të ardhur tek rregullime dhe zgjerime të përcaktuara të qytetit sipas planit të vitit 1930 (dy inxhinierë të huaj vienezë, Kohler dhe Bertoldi) (Thomo, 2012).

Pas çlirimit të vendit, qyteti iu nënshtrua një sërë transformimeve në fizionominë urbane. Krahas ndërtimeve me karakter industrial zunë vend edhe ndërtimet me karakter rezidencial, në trajtën e blloqeve të ndërtimit. Disa prej ndërtimeve të trashëguara nga periudhat e mëparshme u prishën dhe vendin e tyre e zunë ndërtimet të reja të realizmit socialist. Një ndër ndryshimet e dukshme në fizionominë e qytetit në vitet ‘60, ishte devijimi i lumit të Moravës, që kalonte përmes qytetit dhe ndërtimi në rrjedhën e tij të një prej bulevardeve ekzistues. Popullsia erdhi duke u rritur dhe në vitin 1968 numëronte qyteti 46 300 banorë (Sheri, 1970). Zonifikimi i ndërrmarë në vitin 1973 vuri në mbrojtje qendrën historike të qytetit me tre ansamble; dy Zona Muze, një Zonë e Mbrojtur dhe 14 banesa Monument Kulture. Zonimi i dytë

në 1984 rriti qendrën historike me katër zona; dy Zona Muze dhe dy Zona të Mbrojtura dhe 23 Monumente Kulture. Pas viteve '90 kushtet e reja të zhvillimit socio-ekonomik dhe rritja e kërkesës për banesë e përballën qytetin e Korçës me zhvillime të dukshme. Në këtë kuadër qendra historike e qytetit pësoi disa ndryshime në vitet 2002, 2005, 2011, 2017, ku u përcaktuan zonime të reja, që sipas rregullores së mbrojtjes së saj ka synuar ruajtjen e rrjetit rrugor duke kushtëzuar rikonstruksionet dhe ndërtimet e reja.

Në vazhdim qyteti i Korçës ka arritur deri në ditët tona me një fizionomi të formuar urbanistike dhe arkitekturore ku pasqyroheshin elementë të suksesshëm të zhvillimit, ashtu sikurse mangësi si rezultat i kufizimeve gjatë periudhave të ndryshme. Për sa i përket tipologjive urbane të periudhave të ndryshme historike ato bashkëjetojnë të ndërthurura me njëra-tjetrën, duke krijuar një mjedis të veçantë ndërtimesh. Ndonëse investimet e bëra pas viteve 1990, dhe në veçanti në dekadën e fundit, janë shoqëruar me disa ndryshime të dukshme të formës urbane, ajo çka evidentohet ende nga struktura urbane është natyra e saj kompakte. E projektuar si një zonë rrethore me diameter 1.5-2.5 km qyteti është rrethuar nga parku Rinia dhe kompleksi sportiv në veri; nga unaza në perëndim e jug dhe kodrat e Moravës në lindje (Bashkia Korçë, 2017). Për sa i përket strukturës së organizimit hapësinor kemi të bëjmë me një qytet tipik koncentrik me sistem të rrugëve që takohen në qendër (pa nënqendra të tjera pavarësisht disa dyqaneve të vegjël të nevojave të përditëshme dhe objekteve publike të shërbimit) (Menkshi, 2020). Nga ana administrative qyteti përbëhet nga 3 rajone dhe 18 lagje. Për sa i përket zonave funksionale, ato krijojnë një panoramë të qartë të sistemit urban, zhvillimit dhe funksionimit të tij. Kështu Qyteti historik përbëhet nga dy elementë të rëndësishëm të strukturës urbane të qytetit me trashëgimi të pasur historike dhe arkitekturore; Qendra tradicionale, (të shek. XIX dhe fillimit të shekullit XX); Qendra e qytetit, e cila ruan vendosjen e objekteve tregtare, kulturore dhe argëtuese së bashku me ndërtesat administrative. Zona rezidenciale në aspektin vizual dhe kompozicionit shpreh tipologjitë urbane të periudhave të ndryshme të

përfaqësuar nga ndërtimet rezidenciale të periudhës së socializmit, kryesisht ndërtesa kolektive apartamentesh (4-5 kate), ndërtimet e periudhës së fundit të socializmit (1980-90) me ndërtesa 6 kate; ndërtimet shumëkatëshe (pas '90) (shumëfunktionale 8-9 kate të lartë), të lokalizuara në zonën ish-industriale në hyrje të qytetit, por edhe zona të tjera. E dallueshme është zona informale në periferi të qytetit (pas 1990) përgjatë rrugëve që të çojnë në vendbanime të afërta (Voskopoja, Polena) që rrethojnë qytetin. Zgjerimi i zonave rezidenciale ka ardhur si rezultat i rritjes së popullsisë në qytet (87.554 banorë, të regjistruar në gjendjen civile 2021), por edhe kërkesës së lartë për strehim.



Fig. 1. Imazh satelitor i qytetit të Korçës, 2025. (Burimi: Google Earth)

Zona ekonomike e qytetit përfaqësohet nga një zonë industriale e zhvilluar në periudhën e regjimit socialist, ku aktiviteti industrial ka degraduar në objekte të braktisura. Zona shtesë me aktivitete të reja

ekonomike janë zhvilluar përgjatë aksit rrugor të Bilishtit dhe akseve të tjera rrugore. Një vend të rëndësishëm zenë edhe objektet apo ndërtimet me karakter publik si ato të arsimit, shëndetësisë, objektet kulturore dhe të argëtimit, etj. *Hapësirat e lira dhe të gjelbra* përfaqësohen nga hapësirat publike, si parqet, lulishtet, hapësirat midis ndërtimeve etj., por ekzistojnë edhe një mori hapësirash të lira të përdorura për qëllime të ndryshme. Parku Rinia është parku urban më i madh i qytetit, në verilindje të tij.

Struktura urbane e qytetit të Korçës është ndikuar jo vetëm nga zhvillimet historike të vendbanimit në dy shekujt e fundit, por edhe nga zhvillimi i infrastrukturës, e cila ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e qytetit dhe përmnmbushjen e nevojave të komunitetit që jeton në të. Konstatohen rrjete infrastrukturore urbane të mira dhe funksionale. ndërkohë përmirësimet që në infrastrukturën publike fizike kanë sjellë edhe zhvillimin e mëtejshëm të territorit urban.

Sistemi i transportit bazohet kryesisht në infrastrukturën rrugore, krijuar nga organizimi i një sistemi rrugësh të kategorive të ndryshme, si rrugë automobilistike, këmbësorësh dhe rrugë për biçikleta. Bazuar në karakteristikat e tyre fizike dhe funksionale rrugët në qytetin e Korçës ndahen në disa kategori: *Rrugët ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale* të cilat lidhin qytetin e Korçës me qytetet e tjera të Shqipërisë dhe rajonit ndërkufitar. (me dy korsi, standarde projektimi të ulët dhe shpejtësi trafiku të kufizuar; rrugë rajonale; *rrugë kryesore urbane; rrugë kryesore të lagjeve (rrugët mbledhëse) rrugë dytësore të lagjeve dhe rrugët historike* të veshura me kalldrëm (gur). Për vet madhësinë dhe organizimin e tij hapësinor qyteti i Korçës, mundëson përdorimin e transportit publik, përdorimin e biçikletave dhe ecjes në këmbë.

Sistemi energjitik bazohet tek furnizimi me energji elektrike (OSSH) nëpërmjet linjave 20, 10 dhe 0.4 KV. Rrjeti është i bazuar në një nënstacion të vetëm 110KV dhe është ndërtuar në vitin 2005, ndërsa një sistem shpërndarje i ri është kompletuar kohët e fundit. Rrjeti i ri elektrik me shtrirje nëntoksore ku përfshihen edhe zonat informale,

mund të përballojë një numër banorësh rezidentë 3 herë më të lartë se numri aktual i banorëve.

Për sa i përket sistemit të *ngrohjes*, në të gjithë hapësirën urbane të qytetit realizohet duke përdorur si lëndë djegëse drurin. Mungesa e një sistemi elektrik të përshtatshëm, apo alternativave të tjera për ngrohje, përbëjnë një problem për komunitetin por edhe vetë mjedisin urban, cilësia e ajrit e të cilit në stinën e dimrit paraqitet mjaft problematike. *Sistemi i furnizimit të ujit* mundëson cilësi të lartë dhe furnizim të pandërprerë (që prej vitit 2001), duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe të shëndetit publik.

Sistemi i ujërave të zeza është rikonstruktuar dhe përfshin dhe një impiant modern të trajtimit të ujërave të zeza që është në përdorim që prej 2011, i projektuar të përballojë një popullsi prej 100,000 banorësh. Brenda impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, një rezervuar rregullon prurjet e ujërave të zeza dhe largimin e ujërave të bardha, duke ju nënshtruar një trajtimi të caktuar përpara se të shkarkohen në lumë.

Sistemi i drenazhimit përbën aktualisht tëvetmin rrjet infrastrukturor që ka nevojë për rikostruksion. Ekzistojnë kanale drenazhimi (rrëzë të kodrave të Moravës) të cilët nuk kanë qenë në punë për një periudhë të gjatë kohe.

Rrjeti i telekomunikacionit mundëson lidhjen me sinjal të popullsisë së qytetit dhe zonave informale. Sipas të dhënave rreth 15,000 shtëpi kanë kontrata me kompaninë (rreth 60,000 banorë), një shifër e përafërt me numrin e popullsisë rezidente të qytetit, por ka mungesa në linjat sekondare.

Menaxhimi i mbetjeve urbane bëhet nëpërmjet depozitimit në vendgrumbullimet e caktuara. Aktualisht nuk kryhet grumbullimi i diferencuar i mbetjeve gjë që nuk e favorizon riciklimin e mundshëm të tyre. Projekti i vend depozitimit të mbetjeve urbane në fshat Maliq, me financim të Bankës Gjermane KFË (13 milion euro) ka zgjidhur problemin e mbetjeve urbane në të gjithë qarkun e Korçës. Fizionomia e veçantë e qytetit e gërshetuar me arkitekturën tradicionale kanë tërhequr vëmendjen e vizitorëve vendas dhe të huaj. Aktualisht

qyteti dhe rrethinat e tij janë kanë konfirmuar tashmë si destinacione turistike në zhvillim. Në funksion të zhvillimit të turizmit krahas rehabilitimit të rrjetit rrugor janë rikonstruktuar një sërë objektesh kulturore (pazari i vjetër, banesa, parku i qytetit etj.). Qyteti, dhe në veçanti qendra e tij, është përfshirë nga ndërtime të reja me qëllim gjallërimin e jetës dhe tërheqjen e vizitorëve. Ndërtimet kanë të bëjnë kryesisht me përshtatjen e banesave ekzistuese për funksion turistik, (hotele, bujtina dhe restorante). Në disa raste këto kanë ruajtur karakterin ekzistues tradicional, në disa të tjera kanë synuar stilin modern, jo vetëm në formë dhe arkitekturë por madje edhe në ngjyra. Nj.A. Korçë është më e populluara në të gjithë bashkinë. Numri i popullsisë është 43 254 banorë, nga të cilët 21 100 meshkuj dhe 22 154 femra (cens 2023). Mosha e re (0-14 vjeç) zë 13.2 % të popullsisë, mosha aktive (15-64 vjeç) zë 60.9 % dhe mosha e tretë (65+ vjeç) 25.9 % të popullsisë. Në popullsisë me moshë mbi 10 vjeç, rreth 27.2 % e tyre është me arsim 7/8/9 vjeçar; 35.8% me arsim të mesëm dhe rreth 24.6 % me arsim të lartë dhe pasuniversitar.

2.1.2.Zhvillimi ekonomik

Qyteti i Korçës karakterizohet nga një zhvillim i hershëm social-ekonomik dhe kulturor. Pas shkatërrimit të Voskopojës jeta ekonomike mori zhvillim në qytetin e Korçës. Ndikuar nga pozicioni gjeografik në kryqëzimin e rrugëve që lidhnin lindjen me perëndimin në shekullin e XIX, Korça u bë një nga qendrat e rëndësishme ekonomike dhe kulturore në Shqipërinë juglindore. Në fillimi të shekullit të XX figuronte një qendër me tipare kapitaliste në zhvillim. Shprehje të këtyre marrëdhënieve u bënë ngritja e disa aktiviteve të vogla industriale dhe fabrikave: në vitin 1923 u ngrit një fabrikë e vogël duhani dhe në 1934 filloi prodhimin fabrika e birrës. Mbështetur në traditën e popullsisë për përpunimin e lëkurëve në 1929-1930 u ngrit fabrika e lëkurëve, ndërsa në vitet 1937-1938 u ngritën disa punishte të

vogla të mekanizuara për prodhimin e tekstileve ndërkohë që vazhduan të ekzistonin edhe punishtet me vegla të dorës.

Industria mekanike (1960-1990) përfaqësohej nga një sërë ndërmarrjesh të përqendruara më së shumti në qytetin e Korçës. Uzina Mekanike Bujqësore prodhonte vegla dhe pjesë këmbimi, jo vetëm për rajonin por gjithë vendin. Gjithashtu u ngrit Uzina e Preçizionit ku bëheshin veglat e dorës dhe mjetet matëse, si edhe Uzina e Spampave dhe Kushinetave. TEC-i i Korçës i ndërtuar në vitin 1970 furnizonte me avull dhe energji elektrike ndërmarrjet e mësipërme, për proceset teknologjike që kryenin Industria e ndërtimit funksiononte nëpërmjet Fabrikës së Tullave dhe Fabrikës së Fajancës, (prodhim materiale ndërtimi) ndërkohë që në qytetin e Korçës kishte Ndërmarrje Sharre për shfrytëzimin e lëndës drusore dhe Ndërmarrje të Prodhimit të Mobiljeve.

Industria e transportit përfaqësohej nga Parku i Mallrave në qytetin e Korçës, nga ku bëhëj transporti i produkteve industriale të rajonit në gjithë Shqipërinë.

Zhvillim të dukshëm mori industria e tekstileve që përfaqësohej nga Kombinati Trikotazhit i njohur për prodhimet e tij të pambukta dhe të leshta në të gjithë vendin. Gjithashtu zona ishte e njohur edhe për përpunimin e lëkurëve dhe prodhimin e këpucëve nëpërmjet Fabrikës së Prodhimit të Këpucëve në Korçë. E mbështetur në traditat e hershme të artizanatit Ndërmarrja Artizanale dallohej për prodhimet e shumëllojshme dhe me cilësi të lartë të qilimave, sixhadeve etj.

Rol të rëndësishëm në ekonominë e rajonit dhe vendit luante industria e përpunimit të produkteve bujqësore, e cila përfaqësohej nga industria ushqimore që prodhonte reçelra të ndryshme, marmalatë dhe konservonte fruta dhe perime.

Deri në fundin e viteve '80 struktura e ekonomisë në qytetin e Korçës dominohej nga industria e lehtë dhe ushqimore. Në fundin e viteve '80 si në të gjithë vendin edhe qyteti filloi të përballej me vështirësi të dukshme në aspektin social dhe ekonomik. Politikat e punësimit

gjithëpërfshirës nuk justifikonin praninë e mallrave të konsumit jetik dhe për rrjedhojë nivelin e jetesës dhe mirëqënies së popullsisë.

Me ndryshimet politike që pësoi Shqipëria pas vitit 1990, ndryshoi edhe situata e zhvillimit socio-ekonomik në qytetin e Korçës. Një nga efektet më rëndësishme sociale ishte lëvizja e popullsisë brenda dhe jashtë vendit si dhe ndryshimet në strukturat e saj. Për shkak të afërsisë me shtetin grek emigracioni i popullsisë u drejtua kryesisht drejt Greqisë dhe më pak drejt Italisë. Një pjesë e mirë e banorëve kanë emigruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanada. Pjesa më e madhe e të emigruarëve (65 %) i përkiste moshave të reja nga 20-34 vjet. Migrimi brenda vendit u shoqërua me lëvizje të popullsisë kryesisht në drejtim të qyteteve Tiranë, Durrës, Elbasan, Berat, Fier, Vlorë etj.

Dukuri e pranishme ishte dhe lëvizja e popullsisë nga fshatrat përreth në drejtim të qytetit. Popullsia fshatare u shpërngul nga fshatrat malorë Gorë, Lekas, Moglicë, Mokër, Piskal etj, kryesisht drejt qytetit të Korçës, por edhe nga qytetet e tjera të qarkut. Si rezultat i lëvizjeve migruese brenda dhe jashtë vendit gjatë kësaj periudhe ndryshoi edhe raporti midis popullsisë së fshatit dhe qytetit.

Industria e prodhimit të verës, birrës, konjakut, prodhimi i pijeve të buta (lëngjeve) etj. furnizon tregun me produkte tradicionale, kantina Korça 2000, "Rilindja" dhe disa punishte tradicionale të prodhimit të verës në qytet. Prodhimit i "Birra Korça" me një traditë dhe eksperiencë gati 90-vjeçare, teknologji moderne dhe kapacitet 1000 litra në ditë e njohur brenda dhe jashtë vendit, përbën një pikë të fortë për zhvillimin e zonës.

Sektorit i tekstileve, është i zhvilluar kryesisht në trajtën e ndërmarrjeve që operojnë me kapital të huaj ose sipërmarrje të përbashkëta të realizuara nga biznesmenë shqiptarë dhe grekë. Në përgjithësi këto ndërmarrje importojnë lëndën e parë (fasonë) dhe i kanë tregjet e siguruara kryesisht jashtë vendit.

Në infrastrukturën rrugore janë bërë investime dhe përmirësime në rrugët që lidhin qytetin e Korçës me qendrat turistike si: Pogradecin, Voskopojën, Dardhën, Liqenasin, pikën turistike të Moravës etj.

Shërbimi i telefonisë sigurohet nga Vodafon dhe One, duke siguruar sinjal të pandërprerë.

Turizmi ka kushte optimale për zhvillim. Popullsia ka tradita të pasura të mikpritjes dhe nivel të mirë kulturor. Në funksion të zhvillimit të turizmit është ndërtuar edhe infrastruktura turistike me shërbimet hotelieri, restorante, banka, agjenci të informacionit turistik etj.

Fizionomia e veçantë e qytetit e gërshetuar me arkitekturën tradicionale kanë tërhequr vëmendjen e vizitorëve vendas dhe të huaj. Aktualisht qyteti dhe rrethinat e tij janë kanë konfirmuar tashmë si destinacione turistike në zhvillim.

Në funksion të zhvillimit të turizmit krahas rehabilitimit të rrjetit rrugor janë rikonstruktuar një sërë objektesh kulturore (pazari i vjetër, banesa, parku i qytetit etj.). Qyteti dhe në veçanti qendra e tij, është përfshirë nga ndërtime të reja, me qëllim gjallërimin e jetës dhe tërheqjen e vizitorëve. Ndërtimet kanë të bëjnë kryesisht me përshtatjen e banesave ekzistuese për funksion turistik, (hotele, bujtina dhe restorante). Në disa raste këto kanë ruajtur karakterin ekzistues tradicional, në disa të tjera kanë synuar stilin modern, jo vetëm në formë dhe arkitekturë, por madje edhe në ngjyra.

Në funksion të zhvillimit të turizmit dallohen disa atraksione kulturore.

2.1.3. Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar

Është hapur në vitin 1980 dhe tashmë ndodhet në godinën e re të muzeut në bulevadin "Fan Noli", përballë me Spitalin Rajonal të Korçës. Ekspонатet dhe fondet e pasura të tij me objekte historike, kulturore e artistike, që lidhen kryesisht me trashëgiminë e krishtere bizantine dhe pasbizantine, janë shembuj të një pasurie e larmie vlerash të paçmuara. Në vitet diktaturës komuniste (1967), u zhvillua një luftë e ashpër ndaj objekteve të kultit nga e cila u dëmtuan edhe mjaft vepra ikonografike. Të shpëtuara nga humbja dhe shkatërrimi ikonat dhe

objekte të tjera u vendosën në mjediset e Mitropolisë së qytetit që u konvertua në një muze. Artifaktet të bëra prej guri, metali, druri, cope, letre, etj., përfaqësojnë një pasuri artistike dhe vlerat e rajonit natyrën vendase dhe integritetin e kombit shqiptar nëpërmjet gjuhës së artit. Ekspozimi i ekspozateve është realizuar në disa salla të muzeut dhe paraqesin pjesë të veprave më të mira mesjetare nga autorë anonimë apo të identifikuar. Kështu midis tyre dallohen ikonat e shek. XIII-XIV, duke vijuar më pas me krye-mjeshtër si: vellezërit Zografi, David Selenicasi, Oufri, Nikolla, Onufër Qiprioti, Simoni i Ardenicës, Kostandin Jeromanaku, etj. Në mes të këtij koleksioni janë rreth 150 autorë ikonografë shqiptarë dhe të huaj të zbuluar deri më sot. Krahas ekzpozitave të objekteve muzeu disponon laboratorë bashkëkohorë për ruatjen dhe restaurimin e iko-nave dhe veprave të tjera ikonografike, magazina dhe sistem për kontrollin e atmosferës. Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar është nga objektet më të vizitueshme në qytetin e Korçës, veçanërisht nga turi-stët ndërkombëtarë. Ekspozita e muzeut është vizituar nga ekspertë të fushës së artit mesjetar dhe restaurimit, nga një numër i konside-rueshëm artdashësish, pelegrinësh, studentësh, nxënësish vendas dhe të huaj. Në vitin 2009 muzeu u vizitua nga 3180 vizitorë vendas dhe të huaj, ndërkohë që në vitin 2012 numri i vizitorëve ishte 4652, prej të cilëve 1534 vizitorë vendas dhe 3118 vizitorë të huaj. Numri i vizitorëve në vitin 2017 ishte 10 418 vizitorë vendas dhe të huaj. Prezantimi i vlerave për vizitorët e huaj bëhet nga dy specialistë të muzeut, kryesisht në anglisht dhe italisht, por nuk mungon edhe prezantimi në gjuhë të tjera. Të ardhurat e siguruara nuk administrohen nga muzeu për nevoja të tij, por kalojnë në buxhetin e ministrisë përkatëse. Në të njëjtën kohë në muze zhvillohen edhe veprimtari të tjera kulturore si konferenca, promovime dhe praktika profesionale për studentët dhe nxënësit e shkollave.

2.1.4. Muzeu i Arsimit apo Mësonjëtorja e Parë Shqipe

Përbën një nga simbolet e qytetit të Korçës dhe Shqipërisë. Ai është i lidhur me një nga ngjarjet më të rëndësishme historike dhe kulturore

në mbarë territoret shqiptare, çeljen e shkollës së parë shqipe më 7 mars në 1887. Godina në të cilën është vendosur muzeu (dhuruar nga patrioti korçar Diamanti Tërpo) dallohet për vlerat e pasura arkitekturore dhe skemë planimetrike të konceptuar sipas dobisë funksionale të banesës korçare. Si e tillë ajo gëzon statusin Monument Kulture i kategorisë I. Të gjitha materialet e ekspozuara në muze si fotokopja e “Abetares së parë shqipe” (Kostandin Kristoforidhi), libra, dokumente, fotografi, objekte personale të mësueve dhe patriotëve kontribues të kohës janë pjesë e koleksionit dhe fondit të muzeut. Një kontribut të rëndësishëm për pasurimin e koleksionit të muzeut më materiale fotografike, libra apo dokumente të rëndësishme të kohës kanë dhënë familjet e qytetit të Korçës dhe gjithë qarkut duke dhuruar dëshmitë dhe sendet e tyre personale për muzeun. Mbi 300 libra historikë, foto dhe materiale të skeduar me të dhëna historike janë gjithashtu pjesë e arkivit të muzeut. Ekspozimi i gjithë materialeve që muzeu disponon është organizuar në dhoma dhe mjedise të veçanta në të gjithë hapësirën e brendshme të tij. Një prej mjediseve improvizon një klasë mësimi me sendet përkatëse, bango, tabelë dhe fotografi. Me koleksionin e tij historik dhe kulturor muzeu ka qenë qendër e vazhdueshme arsimore dhe edukative e fëmijëve dhe të rinjve me vlerat e trashëgimisë sonë kombëtare. Krahas vlerave historike, kulturore dhe edukative që bart, Muzeu i Arsimit përbën një nga atraksionet kryesore për tërheqjen e vizitorëve vendas dhe turistëve të huaj, që vizitojnë qytetin dhe rajonin e Korçës. Në vitin 2017 Muzeu i Arsimit u vizitua nga 14.418 vizitorë. Është shpallur monument kulture në vitin 1973 dhe muze kombëtar me një Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.13, datë 13.01.1997 “Për shpalljen e muzeut të arsimit në Korçë, muze kombëtar”. Pas dëmtimeve të shumta që kishte pësuar godina u krye rikonstruksioni në arkitekturën e jashtme dhe mjediset e brendshme të saj.

2.1.5. Muzeu Arkeologjik

U krijua në vitin 1985, por formë të plotë mori pas vitit 1990. I vendosur në një ndërtesë karakteristike korçare, të fillimit të shek XIX,

muzeu arkeologjik i përket prehistorisë së zonës juglindore dhe është i veçantë në llojin e vet. Këtu janë të ekspozuar 1200 objekte autentike të zbuluara nga gërmimet arkeologjike në shumë vendbanime prehistorike, që tregojnë zhvillimin e kulturës në Shqipërinë Juglindore, që nga mijëvjeçari i gjashtë para Krishtit deri në shek.VI. Me mjaft interes paraqiten maketet e disa vendbanimeve të rëndësishme prehistorike, si Maliqi, Dunavec, Trajani, etj. Ky muze vizitohet nga nxënës, vizitorë vendas dhe të huaj. Në vitin 2017 muzeu u vizitua nga 1 220 vizitorë vendas dhe të huaj.



Foto 3. Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Foto.4. Muzeu i Arsimit)

2.1.6 Muzeu Bratko

Është një muze oriental, kryesisht me vepra arti nga vendet në të cilat ka qenë vetë dhuruesi. Veprat e artit që ndodhen në muze (rreth 430) janë vepra si piano, altar kinez, veshje për gra japo-neze, rripa kineze, shpate indoneziane, piktura japoze, fotografi të ndryshme të bëra nga dhuruesi gjatë misioneve të tij. Ndonëse i vendosur në një ndërtesë tërësisht të ndryshme nga ndërtimet tradi-cionale, pëlqehet të vizitohet për shkak të natyrës së tij të veçantë.

Shtëpia muze e piktorit Vangjush Mio, përbën një tjetër atraksion turistik (monument kulture) me një fond pikturash të ekspozuara me larmi peizazhes, natyrë të qetë si dhe shumë vizatime, të cilat janë të njohura për stilin e veçantë të realizimit. Vangjush Mio është piktori i parë shqiptar i peizazhit që ka hapur ekspozitën e parë në Tiranë në 1920. Fondi i punimeve ndodhet në banesën e piktorit, e cila nuk mund të

thuhet se përbën një objekt të hapur për vizitorët, megjithë vlerat kulturore, artistike dhe arkitekturore që disponon.

Krahas muzeve të përmendur më sipër *banesa ku patrioti i shquar Themistokli Gërmenji ngriti flamurin e shpalljes së vetëqeverimit të krahinës autonome të Korçës*, (Republika Autonome e Korçës) më 10 dhjetor 1916, përbën një muze me vlera të rëndësishme historike.

Krahas gjinive të përmendura më sipër, fotografia është një gjini artistike e trashëgimisë kulturore që përmendet në trevën e Korçës, në gjysmën e dytë të shekullit të XIX. Në fillim të shekullit XX (1923) në Korçë u çel studioja e fotografit Kristaq Sotiri, ndërkohë që në qytet kishte edhe studio të tjera fotografësh të njohur. Tradita e fotografisë dëshmohej në organizimin e herëpashershëm të ekspozitave të fotografive dhe ekzistencën e disa studiove fotografike në qytetin e Korçës dhe të Pogradecit.

2.1.7. Fonoteka Sotiri

U çel së pari në vitin 2014 nëpërmjet ekspozimit të fondit të punëve të një arkivi të pasur materialesh me vlera kulturore dhe turistike.

Në kuadër të kësaj gjinie të trashëgimisë në qytetin e Korçës në vitin 2018, u çel **Muzeu i fotografisë Gjon Mili**. Ai paraqet një ekspozitë të punëve të fotografit të njohur korçar Gjon Mili, i cili zhvilloi jetën dhe veprimtarinë e vet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Fotografitë që kanë prekur kopertinat e revistave më të njohura të kohës (LIFE) si edhe teknikat unike të fotografimit (drita stroboskopike) janë vlerë e shtuar e pasurisë kulturore të qytetit të Korçës. Muzeu është vendosur në banesën rumune në zonën këmbësore të qytetit. Ai vizitohet nga turistë vendas dhe në veçanti nga turistët e huaj që vizitojnë qytetin.

Objektet e kultit mysliman përfaqësohen nga **Xhamia e Iliaz Bej Mirahorit** në qytetin e Korçës është më e vjetra e këtij tipi në vendin tonë (xhami me sallë të mbuluar me kupolë). Sipas mbishkrimit të vonë (1872-1873) mbi portën e hyrjes, xhamia është ndërtuar në vitin 1495-1496, (901 H) nga Iliaz Beu, me origjinë nga Panariti, Mirahor, komandant i stallave të Sulltan Bajazitit II. Xhamia përbëhet nga salla

e lutjeve, portiku tripjesësh dhe minarja dhe mendohet të jetë ndërtuar mbi rrënojat e kishës së Shën e Premtes në fshatin Peshkëpi, fare pranë qytetit të Korçës. Për nga arkitektura është vlerësuar si ndërtim nga më të arriturit, që ndonëse e vogël është një ndërtesë monumentale. Studiuesit e krahasojnë atë me mjaft xhami bashkëkohore të Stambollit. Por, teknika e ndërtimit të mureve, ndryshon tërësisht nga ndërtimet turke, gjë që flet për një traditë ndërtimore vendase. Gjendja e mirë arkitekturore pas restaurimit e ka kthyer në një objekt atraktiv për vizitorët e huaj.

Një objekt kulti me vlera të rëndësishme është edhe **Katedralja Ringjallja e Krishtit** në qytetin e Korçës. Ajo është ndërtuar në vitin 1994 dhe shërben për kryerjen e të gjitha riteve fetare të besimtarëve të krishterë ortodoksë. Katedralja është simbol i kishës së Shën Gjergjit e ndërtuar në vitin 1881 (përfunduar në 1905) në vendin ku sot është vendosur bashkia (ish-biblioteka). Për fat të keq kisha u shka-tërrua nga regjimi komunist në vitin 1967. Ndonëse e re dhe nuk gëzon statusin e monumentit të kulturës, katedralja Ringjallja e Krishtit, përbën një nga simbolet kulturore të qytetit, me vlera artistike në arkitekturën e jashtme dhe zbukurimet e brendshme murale të saj. Në vazhdim të traditës së pikturimit të kishave, është për t'u evidentuar fakti se besimtarët ortodoksë janë duke kontribuar në veshjen e brendshme me piktura murale. E ndodhur në qendër të qytetit katedralja është objekti kulturor që vizitohet dhe vlerësohet nga të gjithë turistët e huaj dhe vizitorët që vijnë në qytetin e Korçës.

Krahas monumenteve më karakter religjioz, **skulptura** është një gjini artistike që ka gjetur mishërimin e vet edhe në qarkun e Korçës me vepra të realizuara nga mjeshtrat e skulpturës kombëtare. Në gjithë fondin e kësaj gjinie, vetëm dy prej tyre që ndodhen në qytetin e Korçës kanë statusin e "*Monumentit të Kulturës*": *Monumenti i Luftëtarit Kombëtar* ose siç njihet ndryshe "*Ushtari i panjohur*", që ndodhet në zonën këmbësore të qytetit, i ndërtuar me mjeshtëri nga Odhise Paskali në vitin 1932. Monumenti mishëron vlerat atdhetare të një krijimi realist por edhe vlera artistike dhe turistike. *Monumenti i Themistokli*

Gërmenjit, gjithashtu monument kulture, ndodhet brenda lulishtes me të njëjtin emër dhe është ndërtuar në 1932, përsëri nga mjeshtri Odhise Paskali. Me vlera kulturore paraqiten edhe disa monumente të tjera si: Monumenti "Koci Bako" ndërtuar nga Dhimitër Çani (1950); monumenti "Naim Frashëri" në rrugën "28 Nëntori" vepër e Avni Bilibilit më 1956; monumenti "Partizani" pranë varrezave të dëshmorëve ndërtuar (1969) nga Avni Bilbili, Piro Dollaku e Ilia Xhano; monumenti "Mihal Grameno" (1969) nga Muntas Dhrami; monumenti "Naum Veqilharxhi" (1974); Obelisku ABC-së në oborrin e muzeut "Mësonjëtorja e Parë Shqipe" ndërtuar nga Naumq Mara (1987); busti "Tre kokat" (Naum Veqilharxhi, Thimi Mitko dhe Asdreni) ndërtuar nga Vladimir Topi, Avni Bilbili dhe Vladimir Kaçaku (2002); monumenti "Mitrush Kuteli" dhe "Lasgush Poradeci" në qytetin e Pogradecit, etj.


2.2 NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR BULGAREC

Njësia administrative (Nj.A.) Bulgarec është pjesë e bashkisë së Korçës. Territori i Nj. A. shtrihet në verilindje të bashkisë, midis $40^{\circ}36'50''$ e $40^{\circ}41'55''$ gjerësi gjeografike veriore dhe $20^{\circ}41'22''$ e $20^{\circ}51'39''$ gjatësi gjeografike lindore. Distanca veri-jug është 9.4 km, ndërsa lindje-perëndim 19 km. Ka një sipërfaqe prej 77 km^2 , ose 9.3 % të sipërfaqes bashkiake. Kufizohet në lindje me Nj. A. Hoçisht dhe Nj.A. Progër (të bashkisë Bilisht), në veri me Nj.A. Pojan dhe Nj.A. Libonik (të bashkisë Maliq), në perëndim me Nj. A. Voskop dhe në jug me Nj. A. Korçë dhe Drenovë.

Bulgareci si Nj.A. gjendet në zonën tektonike të Mirditës dhe të gropave ndërmallore. Të pranishme janë depozitimet aluviale (alevrolite, rëra, zhavore) të holocenit (Q_h); depozitive deluviale-koluviale të pleistocenit (Q_p); mergele, argjila mergelore, alevrolite dhe gëlqerorë të Burdinalianit (N_1^{lb}); ranorë masivë, argjila me shtresa qymyresh e gëlqerorë të Oligocenit të Sipërm (Pg_3^3) dhe argjila, rëra, konglomeratë e qymyre të Oligocenit të Mesëm (Pg_3^2). Disa prej materialeve shkëmbore përdoren si lëndë të parë në ndërtim. Në lindje të malësisë së Voskopojës janë të pranishme guoret.

Territori i Qendër Bulgarecit shtrihet në malësinë e Voskopojës, fushëgropën e Korçës dhe në vargun malor të Moravës. Lartësia minimale është 820 m dhe lartësia maksimale arrin 1573 m (m. i Lajthisë, Moravë) mbi nivelin e detit. Klima është tipike mesdhetare paramalore, me ndikim të masave ajrore të ftohta që vijnë nga brendësia e kontinentit. Hapësira territoriale është pjesë e pellgun ujëmbledhës të lumit Devoll. Tokat janë kryesisht të brezit të kafenjës dhe të murrme pyjore, kurse bota bimë dominohet nga brezi i dushqeve dhe i ahut. Trashëgimia natyrore përfaqësohet me biomonumentin (kategoria III e Zonave të Mbrojtura) Venjat e Dishnicës.

Njësia Qendër Bulgarec ka në administrim fshatrat Barç, Dishnicë, Neviçisht, Belorta, Kuç i Zi, Malavec, Shamoll, Çiflig, Bulgarec, Biranj, Lumalas, Melçan dhe Porodinë. Fshatrat Barç, Dishnicë, Neviçisht, Belorta, dhe Kuç i Zi gjenden në të djathtë të rrugës Korçë-Bilisht, ndërsa fshati Malavec dhe Shamoll gjenden në anën e majtë të po të kësaj rruge. Fshatrat Çiflig dhe Bulgarec gjenden në të djathtë të rrugës Korçë-Pogradec, ndërsa fshati Biranj, Lumalas, Melçan dhe Porodinë gjenden në anën e majtë të rrugës në fjalë.



Harta 5. Shtrirja hapësinore e Nj.A. Qendër Bulgarec. Burimi: Arc GIS 10.1. bazuar në Hartën Administrative të Shqipërisë 1:200 000 të prodhuar në 1999 nga GC C.

Popullsia në Nj.A. Qendër Bulgarec është 6 475 banorë, nga të cilët 3 316 meshkuj dhe 3 159 femra (Cens 2023). Në vitin 2023 mosha e re (0-14 vjeç) zë 13.5 % të popullsisë, mosha aktive (15-64 vjeç) zë 62 % dhe mosha e tretë (65+ vjeç) 24.5 % të popullsisë së njësishë. Në popullsinë me moshë mbi 10 vjeç, rreth 51.5 % e tyre është me arsim 7/8/9 vjeçar; 23.3% me arsim të mesëm dhe rreth 7.4 % me arsim të lartë dhe pasuniversitar.

Popullsia e moshës së tretë është në rritje. Ajo zë rreth $\frac{1}{4}$ e popullsisë së njësishë. Largimet e popullsisë dhe rënia e numrit të lindjeve janë ndikuesit kryesorë të plakjes së popullsisë. Në 22 vitet e fundit, sipas të dhënave të Censurit 2001, 2011 dhe 2023, numri i popullsisë në Nj.A. Qendër Bulgarec ka rënie graduale me 37 %, përkatësisht : v. 2002 me 10 322 b., v.2011 me 9 022 b. dhe v. 2023 me 6 475 b. Të dhënat e Censusve nuk përkojnë me të dhënat demografike të Zyrtarëve të Gjendjes Civile, sipas të cilave numri i popullsisë është më i lartë. Këto ndryshime në të dhëna shkaktohen nga rregjistrimet e emigrantëve ndërkombëtar në Shqipëri dhe nga mosdeklarimi i lëvizjeve migruese kombëtare e ndërkombëtare. Të ardhurit në Nj.A. Qendër Bulgarec i përkasin fshatrave malorë të malësisë së Vithkuqit dhe Voskopojës, të cilët janë vendosur kryesisht përgjatë rrugës nacionale Korçë- Pogradec (në territoret e fshatrave Çiflig, Bulgarec, Lumalas dhe Biranj).

Në Nj.A. Qendër Bulgarec fondi i tokave të punueshme është 4 317, 75 ha, ku pjesa më e madhe është tokë arë. Sipërfaqet më të mëdha të tokave të punueshme i përkasin fshatit Dishnicë dhe Bulgarec, për shkak edhe të numrit më të lartë të popullsisë. Sipërfaqet më të vogla të tokave të punueshme i përkasin fshatit Lumalas (156, 02 ha) dhe fshatit Malavec (115,20 ha).

Aktivitetet kryesore ekonomike të Nj.A. Qendër Bulgarec janë bujqësia dhe blektoria, produktet e cilave shkojnë në tregun kombëtar, lokal dhe për konsum familjar. Bulgareci, si njësi, dallohet për kultivimin e grurit, mistrit, foragjereve, perimeve dhe më pak frutikulturë. Ujitja e tokave para 1990 bëhej nëpërmjet kanalit të

Gjançit, ndërsa tashmë tokat e punueshme ujiten me ujrata e malit të Moravës dhe të malësisë së Voskopojës, si dhe ujrata e lumit Dunaveç (për tokat nënujë).

Infrastruktura e Nj.A. Qendër Bulgarec është e mirë. Rrugët që lidhin fshatrat me qytetin e Korçës janë të gjitha të asfaltuara. Rrjeti energjitik ofron energji elektrike të pandërprerë 24 orë në të gjithë vendbanimet, vetëm në raste të rreshjeve të dendura të dëborës dhe erërave të forta evidentohen ndërprerje. Fshatrat furnizohen me ujë 24 orë. Uji i pijshëm sigurohet nga qyteti i Korçës (ujërat nëntokësore) dhe pjesërisht nga burimet e malit të Moravës. Telekomunikacioni ofrohet nëpërmjet shërbimit të telefonivë celulare dhe Fast Netit, të cilët mbulojnë me sinjal interneti të gjitha fshatrat. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza ka ardhur duke u përmirësuar. Mbetjet urbane të njësisë administrative depozitohen në përrenj dhe në gropa septike. Edhe mbetjet inerte trajtohen në vendgrumbullime të posaçme.

Transporti i banorëve në vendbanimet e njësisë mundësohet nëpërmjet linjave private, të tipit të furgona dhe taksi. Fshatra të veçantë kanë edhe transport publik. Shërbimi shëndetësor ofrohet në çdo fshat. Qendra kryesore shëndetsore gjendet në fshatin Dishnicë. Mjekët janë të pranishëm nëpër fshatra një/ dy herë në javë, ndërsa infermieret çdo ditë të javës. Në Nj.A. Qendër Bulgarec janë të pranishme katër shkolla 9-vjeçare dhe pesë shkolla fillore.

Trashëgimia kulturore në territorin e njësisë është e pasur me arkeologji, objekte kulti, ndërtime tradicionale, tradita, zakone, festime dhe kulinari. Statusin e Monumentit të Kulturës e mbajnë: Kalaja e Dishnicës, Kalaja e Kuçit të Zi, Kulla e Malavecit, Kulla e Dishinicës dhe Vendbanimi prehistorik i Barçit.

2.2.1. BARÇI

Vendbanim rural në Nj.A. Qendër Bulgarec. Gjendet në gjerësinë gjeografike: 40° 37' 41'' dhe gjatësinë gjeografike: 20° 48' 19''; në vargun malor perëndimor të Moravës; në shpatin perëndimor të malit

të Padishtës (1 456m); midis lartësive 855-982 m mbi nivelin e detit; rreth 3.5 km larg qendrës së qytetit të Korçës, në të djathtë të rrugës nacionale Korçë-Bilisht. Kufizohet me fshatin Dishnicë në veri, me fshatin Çiflig në perëndim, qytetin e Korçës në jug dhe fshatin Mborje në juglindje.

Territori i Barçit përbëhet nga depozitime aluviale-proluviale të pleistocen-holocenit (Q_{p-h}), të përfaqësuara nga përzjerje rërash, zhavorësh dhe alevritesh, si dhe nga shkëmbinj të jurasikut të mesëm (σJ_2). Relievi i ndërtuar prej tyre dallohet për ndërthyrje të luginave me shpatet malore në pjesën e sipërme dhe shpatet e butë e me pjerësi në drejtim të perëndimit në pjesën më të poshtme. Fshati është ndërtuar mbi materialet e sjella nga përrrenjtë e malit të Moravës dhe të depozituara në pjesën fundore të tij.



Fig.2. Imazh satelitor i fshatit Barç, 2025

Relievi paraqitet i tipit kodrinor, me forma të rumbullakosura, me shpate me pjerrësi mesatare, të përshkruara nga përrrenj që i takojnë pellgut ujëmbledhës të lumit të Dunavecit. Majat më të afërta në vargmalin (v.m.) e Moravës janë mali i Padishtës (1 456 m) dhe mali i Kalasë (1 248m). Përbëhen nga ranorë, argjila e konglomeratë e

qymyre dhe veçohen midis tyre nga luginat e përrrenjve. Pjesa e sipërme e luginave paraqitet me pjerrësi të shtratit dhe të shpateve, ndërsa në pjesën e poshtme me pjerrësi më të vogël e shpate të cekët. Klima është mesdhetare paramalore, me verë të ngrohtë e të thatë e dimër të ftohtë e të lagësht. Të pranishme janë rreshjet e dëborës. Rreshjet në formë shiu janë nën mesataren vjetore të Shqipërisë.

Territori i fshatit Barç është i pasur me burime ujore, që vijnë nga brendësia e v.m. të Moravës. Njihen burimi i Grykave dhe burimi i Ankos, të cilat rrjedhin në përrrenj e përfundojnë në lumin e Dunavecit. Të përhapura janë tokat e kafenjta, të cilat zhvillohen deri në lartësitë 1000 m mbi nivelin e detit. Tokat e punueshme gjenden në perëndim të fshatit, pjesërisht në fushën e Korçës dhe pjesërisht në rrëzë të malit. Në territorin e fshatit gjenden bimë të katit të dushkut dhe ahut. Të pranishme janë dushqet, pishat, akaciet etj.

Territoret e fshatit Barç kanë qënë të populluar që në shek VIII p.e.r. Gjetjet arkeologjike të një vendbanimi kodrinor me gurë në grykën e Barçit (lokalisht njihet si kalaja e Barçit) janë dëshmi të jetëgjatësisë së vendbanimit rural. Sipas dokumentacioneve në 1900, në fshat gjendeshin 42 familje me 193 banorë, të besimit myslimanë. Në vitet 1945-1990 pati rritje të numrit të popullsisë, organizim të aktivitetit ekonomik dhe social të fshatit. Popullsia ishte i organizuar në kooperativë bujqësore.

Mbas vitit 1990, në Braç u shfaqën ndryshime demografike, infrastrukurore dhe ekonomike. Sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile numri i popullsisë është në rritje, si: 175 b. (v. 1920), 1028 b. (v. 1997), 1154 b. (v. 2002), 1410 b. (v. 2011), 1412 b. (v. 2016) dhe 1429 b. (v. 2019). Shtimi i numrit të popullsisë lidhet me regjistrimin, si banorë të fshatit, të fëmijëve të lindur jashtë territorit shqiptar dhe me ardhje të banorëve nga fshatrat Blush e Lavdar, por dhe nga qyteti i Korçës. Pjesa më e madhe e popullsisë së rregjistruar në fshat jeton në Greqi, Itali, Gjermani, SHBA etj. Emigrimi ndërkombëtar shprehet në mungesën e popullsisë në fshat; në ndërtimet e banesave të reja dhe në tokat e lëna djerrë, në pjesën më të poshtme të fshatit.

Barçi është i organizuar në tri lagje të shpërndara (Reparti Ushtarak, Mëhalla dhe Osman Xhakolli) pa një qendër fshati. Dy lagjet e vjetra janë më banesa 1-katëshe, prej guri e çati tjegullash, të grumbulluara, ndërsa lagjia e re është me banesa 2-3 katëshe me tulla, të suvatuara e me çati. Ndërimet e reja popullohen në periudhën e verës dhe në ditët e festave.



Foto 5,6. Tipe të banesave në fshatin Barç

Ulja e numrit të nxënësve dhe afërsia me qytetin ka bërë që shkolla 9-vjeçare e Barçit të mbyllet dhe fëmijët të arsimohen në shkollat e Korçës. Në fshat gjendet ambulanca, ku ofrohet shërbim nga mjeku dy ditë në javë dhe dy infermieret çdo ditë. Furnizimi me ujë bëhet nga burimet e Moravës dhe uji i qytetit të Korçës, me stacion pompimi. Kanalizimet e ujrave të zeza mungojnë, ato qarkullojnë pjesërisht nëpër përrenjtë e fshatit e përfundojnë në Dunavec. Në fshat mungon transporti publik, lëvizje e banorëve drejt qytetit të Korçë realizohet në këmbë ose me taksì. Të pranishme janë rrjeti i internetit, tri bar-e, tri dyqane ushqimore dhe një restaurant për raste festash/ vakish. Në fshat mungojnë institucionet dhe aktivitetet kulturore. Jeta sociale dhe kulturore plotësohet në qytetin e Korçës, për shkak të afërsisë me të. Në Barç gjendet një vakëf, një xhami dhe kisha e Shën Kollit. Dominojnë banorët e besimit mysliman.

Banorët e fshatit janë të angazhuar në bujqësi, blektori, industri përpunuese dhe tregëti. Tokat e punueshme (arë) zenë një sipërfaqe

prej 375.92 ha. Një pjesë kultivohen me perime, grurë, misër dhe foragjere dhe disa janë të lëna djerrë për shkak të emigrimeve të popullsisë dhe mungesës së ujitjes. Para viteve 1990, tokat ishin të gjitha të kultivuara me duhan, panxhar, misër, grurë, patate, etj dhe ujitja bëhej nëpërmjet kanalit të Gjançit.

Aktualisht, zhvillimi i blektorisë realizohet nga mbarështimi i 300 deleve, 80 dhive dhe 10 lopëve. Në fshat mungon qumështi dhe nënproduktet e tij. Ato sigurohen nga baxhot që gjenden në rajon. Krahas karakterit bujqësor dhe blektoral që ka fshati, përgjatë rrugës automobilistike Korçë-Bilisht janë ngritur fabrika të përpunimit të drurit (mobileri); fabrika të përpunimit të mishit (sallameri), përpunimit të brumit (pasteri); pika të tregëtimit të materialeve drusore, materiale ndërtimit, pjesë këmbimi të makinave, tregëtimit të naftës, etj. Shërbimet që ofrohet në restorantet dhe baret që ka fshati Barç frekuentohen edhe nga banorët e qyteteve dhe zonave rurale përreth.

2.2.2. DISHNICA

Vendbanim rural në Nj.A. Qendër Bulgarec. Gjendet në koordinatat gjeografike: 40° 39' 04'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 48' 54'' gjatësinë gjeografike lindore; në shpatin perëndimor të malit të Moravës; midis lartësive 862-960 m mbi nivelin e detit; midis m. të Belerit, m. të Lëmit dhe m. të Kalasë e fushëgropës së Korçës; rreth 5 km nga qyteti i Korçës, në të djathtë të rrugës Korçë- Bilisht. Kufizohet me fshatin Neviçisht në veri, fshatin Malavec në perëndim dhe fshatin Barç në jug.

Territori i Dishnicës përbëhet nga depozitime të përziara aluviale-proluviale, të përfaqësuara nga rëra, zhavorre dhe alevritë të periudhës Pleistocen-Holocen (Q_{p-h}) dhe depozitive deluvionale-koluvionale të Pleistocenit (Pg^2_3). Relievi i formuar prej tyre paraqitet me kontrast midis kreshtave, luginës dhe fushë. Fshati është ndërtuar mbi depozitime aluviale-proluviale, midis malit të Belerit (1043 m) dhe

malit të Kalasë (1248 m). Relievi është kryesisht kodrinor, me kurrize e maja të rrumbullakosura e shpate me pjerrësi të butë, të përshkuara nga përroi i Lashtës, përroit i Dishnicës dhe përroit i Mollës. Shtrati i rrjedhjes së përrenjve paraqitet i ngushtë e me pjerrësi mesatare. Në relief shfaqen forma erozivo-denuduese, si rezultat i mungesë së bimësisë dhe daljes në sipërfaqe të shkëmbit rrënjësor.

Klima është tipike mesdhetare paramalore, me verë të freskët dhe dimër të ftohtë. Territori i fshatit është i pasur me ujëra sipërfaqësore, që vijnë nga brendësia e malit të Moravës. Ujërat e burimeve grumbullohen në një përrua të vetëm, i cili konsiderohet degë e djathtë e lumit Dunavec.

Në fshat janë të përhapura tokat e brezit të kafenjhtë, me trashësi të tokës mesatarisht 120 cm, me pH ujqor 6.5, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 2.5 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1, 6%; azoti i përgjithshëm mes. 1.6%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 1.5 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes.20 mg. Bimësia natyrore e fshatit i përket brezit të dushqeve dhe ahut. Të pranishme janë pishat dhe ahu. Pjesë e trashëgimisë natyrore të fshatit janë "Venjat e Dishnicës". Ato bëjnë pjesë në kategorinë e tretë të Zonave të Mbrojtura, "Monumentet e Natyrës, nënkategoria biomonument". Venjat janë shkurre të rralla, që për Shqipërinë përfaqësojnë kufirin më perëndëndimor të shtrirje së tyre. Venjat e Dishnicës gjenden në lartësinë 968 m mbi nivelin e detit.



Fig.3. Imazh satelitor i fshatit Dishnicë, 2025

Fshati ka histori të gjatë popullimi. Të dhënat e para për numrin e popullsisë vijnë nga viti 1900. Numri i popullsisë ka ndryshuar në vite: 951 b. (v. 1900), 1001 b. (v. 1920), 1757 b. (v. 1997), 1854 b. (v.2002), 1905 b. (v.2005), 1992 b. (v. 2011) dhe 2004 b. (v. 2016) dhe 2016 b. (2019). Në vitin 2024 në fshat janë regjistruar rreth 1 700 banorë, rreth 12 lindje dhe 20 vdekje. Vitet e fundit po vihet re shtesa natyrore negative, e cila reflektohet në uljen e numrit të popullsisë. Ndikim edhe më të madh në ndryshimet e numrit të popullsisë ka lëvizja hapësinore. Në 20 vitet e fundit rënia e numrit të popullsisë është përcaktuar nga dominimi i vdekjeve kundrejt lindjeve, si dhe nga emigrimi kundrejt imigrimit. Në fshat gjenden familje të pakta të ardhura nga fshatrat malorë, si: Panariti, Lozhani, Moglica dhe Lavdari. Shumica e të larguarve janë zhvendosur në qytetin e Korçës, Tiranës, Greqisë, Italisë dhe tashmë Gjermanisë. Pjesa më e madhe e të larguarve i përkasin grupit etnik të vlehëve (arumunë). Popullsia e mbetur e fshatit dominohet nga mosha e tretë, e cila është e angazhuar në bujqësi dhe blegtori. Popullsia aktive është përfshirë në punë sezonale jashtë

vendit, në punësim administrative dhe ndërmarrje përpunuese/prodhuese në qytetin e Korçës.




Foto 7, 8. Pamje të banesave në lagjet e fshatit Dishnicë,

Fshati Dishnicë është ndërtuar në anën e djathtë të rrugës Korçë-Bilisht. Banesat janë të grumbulluara e të organizuara në lagjen e Poshtme, lagjen e Çobenëve dhe në lagjen Lart. Ndërtimet e vjetra janë me mure guri ose tulle e çati tjegullash. Ndërtimet e reja janë me mure tulle dhe blloqesh, e me çati tjegullash. Shtëpitë janë 1 dhe 2 katëshe, me oborr të përpamë e të rregulluara me pjerrgulla rrushi. Rrugët brenda fshatit janë të asfaltuara. Të gjitha bashkohen në qendër ku ndodhet një çezmë dhe xhamia 5-shekullore. Rreth 70 % e popullsisë i përket besimit mysliman, rreth 30% janë të besimit ortodoks. Në pjesën e sipërme të fshatit gjenden 7 kisha, si: kisha e Shën Kollit, kisha e Shën Marenës, Satrivaçi, etj. Fëmijët arsimohen në shkollën 9-vjeçare “Xhavit Dishnica” që nga koposhti e deri në klasën e 9-të. Në fshatin Dishnicë gjendet qendra shëndetësore e Nj.A Qendër Bulgarec. Aty janë të punësuar 4 mjekë (për 13 fshatrat e Nj.A) dhe 19 infermierë. Mjeku i fshatit ofron shërbim ambulator në dy ditë të javës. Dishnica ka 24 orë ujë në ditë. Uji merret nga burimet e malit Morava dhe grumbullohet në dy depozita, të ndërtuara nga vetë banorët. Në pjesën e sipërme të fshatit është ndërtuar një hidrocentral, i cili punon me ujërat e burimeve. Fshati ka mungesë të ujit për ujitjen e tokave të punueshme, të cilat zënë një sipërfaqe prej 642.81 ha. Një pjesë e tyre

janë lënë djerrë. Ato pak toka që kultivohen zihen me grurë, patate, fasule e perime të stinës.

Vitet e fundit janë ngritur 2-3 ferma me pemë frutorë, kryesisht mollë. Produkti shkon për konsum familjar dhe në tregun lokal. Rënia e numrit të bagëtimeve të trasha dhe të imta është shoqëruar me mungesë të nënprodukteve të qumështit, mishit, leshit etj. Tregtimi i mallrave ofrohet në 5-6 mini-markete, në një dyqan mishi dhe në një farmaci private. Një nga figurat më të njohura të fshatit është mjeku dhe politikani Ymer Dishnica.

2.2.3. NEVIÇISHTI

Fshati Neviçisht është pjesë e Nj.A. Qendër Bulgarec. Shtrihet në gjerësinë gjeografike: 40° 39' 33'' dhe gjatësinë gjeografike: 20° 49' 27''; në perëndim të vargut malor të Moravës, në rrëzë të malit të Vakëfit; midis lartësive 876-940 m mbi nivelin e detit; rreth 6.8 km larg nga qyteti i Korçës, në të djathtë të rrugës nacionale Korçë- Bilisht. Shtrihet midis fshatit Belorta në veri, fshatit Shamoll në perëndim, fshatit Malavec në jugperëndim dhe fshatit Dishnicë në jug.

Territori i Neviçishtit përbëhet nga depozitime të përziera aluviale-proluviale, të përfaqësuara nga rëra, zhavorre dhe alevritë të periudhës Pleistocen-Holocen (Q_{p-h}) dhe depozitive deluvionale-koluvionale të Pleistocenit (Pg^2_3).



Fig.4. Imazh satelitor i fshatit Neviçisht, 2025

Relievi i ndërtuar prej tyre paraqitet me kontraste. Mali i Vakëfit (1162 m) diferencohet prej fushës së Korçës me një shpat të pjerrët, ku dallohen format erozivo-denuduese. Ky mal paraqitet me majë të rrumbullakosur, shpate perëndimore të pjerrët dhe me disa modelime nga përrenjtë që vijnë nga brendësia e malit të Moravës. Fusha paraqitet me pjerrësi në drejtim të perëndimit.

Klima është mesdhetare paramalore, me prani të rreshjeve të formës së dëborës në ditë të caktuara të periudhës së ftohtë të vitit. Rreshjet në formë shiu janë në sasi të pakët dhe janë të përqendruara kryesisht në gjysëm e ftohtë të vitit. Të pranishme janë edhe rreshjet në formë bore dhe breshëri. Burimet ujore mungojnë në fshat. Ujërat e freskëta vijnë nga burimet në brendësi të malit të Moravës. Përrenjtë e krijuar janë pjesë e pellgut ujëmbledhës të lumit Dunavec.

Të përhapura janë tokat e kafenjta. Profili i tokave është 70-100 cm i trashë, me horizont humusor me trashësi deri në 50 cm dhe me ph ujor rreth 7.5. Zakonisht tokat e Neviçishtit përmbajnë 2-3 % humus në sipërfaqe dhe 1-2% në thellësi. Tokat e punueshme shtrihen në lartësitë më të vogla të fshatit, në të dyja anët e rrugës nacionale të sipërpërmendur. Në territorin e fshatit Neviçisht shfaqet kati i dushkut dhe pjesërisht kati i ahut, në lartësi të maleve.

Fshati është i organizuar në dy lagje: Mëhalla sipër dhe Mëhalla poshtë. Konsiderohet fshat i grumbulluar, me një qendër. Banesat e para vitit 1990 janë të ndërtuara me gurë dhe tulla, të mbuluara me tjegulla të kuqe. Banesat e reja janë ndërtime me blloqe dhe tulla. Shtëpitë janë një dhe dy katëshe, të rrethuara me avlli, e me kopsht përpara. Në fshat janë të pranishme banesat e rënuara, të braktisura. Emigrimi kombëtar dhe ndërkombëtar ka zvogëluar numrin e popullsisë në fshat, pavarësisht ardhjeve të popullsisë nga Skrapari, Erseka, në vitet që pasuan 1990-n. Numri i popullsisë në vite është: 231 b. (v. 1900), 232 b. (v. 1920), 573 b. (v. 1997), 616 b. (v. 2002), 673 b. (v. 2011), 670 b. (v. 2016), 680 b. (v. 2019) dhe 486 b. (v. 2024). Aktualisht gjenden

rreth 45 familje me 1, 2 dhe 3 antarë. Në fshat ofrohet mësim nga klasa e parë deri në klasën e pestë. Kopshti është mbyllur në vitin 2024 për shkak të mungesës së fëmijëve. Shërbimet shëndetsore ofrohen në qendrën ambulatorie nga infermjerja dhe doktori që kryen vizita ditën e enjte. Shërbimi tregëtar ofrohet nga një market i vogël, vetëm për ushqimet bazë. Banorëve janë të detyruar të bëjnë pazar në qytetin e Korçës ose në fshatrat e afërt. Dy rrugët kryesore të fshatit janë të shtruara me asfalt. Në brendësi të fshatit rrugët janë të paasfaltuara. Fshati furnizohet me ujë të pijshëm në 24 orë; ka rrjet të mirë energjistik dhe mbulim interneti. Mungojnë kanalizet e ujrave të zeza. Prej një viti mungon transporti publik nga qyteti i Korçës.

Banorët i përkasin besimit mysliman. Shërbesat fetare kryhen në xhaminë e fshatit. Aktivitetet kryesore ekonomike janë bujqësia, blegtoria dhe shërbimi. Bujqësia është e tipit ekstensiv. Tokat mbillen me grurë, fasule, misër, perime. Pranë banesave gjendet toka të mbjella me qershi, kumbulla dhe mollë. Prodhimet shkojnë për konsum familjar. Pjesa më e madhe e tokave bujqësore janë lënë djerrë për shkak të emigrimit të banorëve.



Foto 9, 10. Pamje të fshatit Neviçisht, 2025

Sipërfaqet pyjore të fshatit janë zvogëluar në vitet e fundit për shkak të prerjeve pa kriter. Të gjitha familjet në fshat ngrohen me soba druri. Blegtoria zhvillohet me mbarështimin e 13 krerë lopë, rreth 200 kockë dele dhe disa dhi. Mungojnë kafshët e punës. Neviçishti dallohet për rritjen e bletëve. Në fshati gjenden mbi 100 koshere, ku prodhimi i

mjaltit shkon në tregun lokal. Deri në vitin 1990, Neviçishti kishte një mulli dhe një sharrë, por tashmë të mbyllura. Përgjatë rrugës nacionale ofrohet shërbime në bar-e dhe restorante në tri biznese. Në fshat gjendet një mini fushë futbolli për aktivitete sportive.

2.2.4. BELORTA

Vendbanim rural në Nj.A. Qendër Bulgarec. Gjendet në koordinatat gjeografike 40° 40'01'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 49'56'' gjatësi gjeografike lindore; në shpatin perëndimor të malit të Moravës, midis malit të Vakëfit dhe malit të Strugarit; midis lartësive 834-1000 m mbi nivelin e detit; rreth 8 km nga qyteti i Korçës, përgjatë rrugës automobilistike Korçë- Bilisht. Fshati kufizohet me fshatin Kuç i Zi në veri, fshatin Neviçisht në jug dhe fshatin Shamoll në perëndim. Territori i fshatit Belorta përbëhet nga depozitime të përziera aluviale-proluviale, të përfaqësuara nga rëra, zhavorre dhe alevritë të periudhës Pleistocen-Holocen (Q_{p-h}) dhe depozitive deluvionale-koluvionale të Pleistocenit (Pg^2_3). Relievi i ndërtuar prej tyre paraqitet me kontraste. Në fshat shfaqen format e relievit fushor, kodrinor dhe malor. Relievi malor i përfaqësuar nga mali i Vakëfit (1162 m) në jug dhe mali i Strugarit (1461 m) në lindje, paraqiten me kurrize të rrumbullakosur e me shpate të pjerrët në perëndim. Ndahen midis tyre nga lugina e përroit të Rruxhetit. Fshati Belorta shtrihet mbi depozitimet ranore e zhavorore të sjella nga përroi, të cilat kanë krijuar një kon depozitimi. Klima është mesdhetare paramalore, e ngjashme me klimën në fshatin Neviçisht. Në fshat janë të përhapura tokat e brezit të kafenjhtë, me trashësi të tokës mesatarisht 150 cm, me ph ujqor 7.8, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 2.4 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,7 %; azoti i përgjithshëm mes. 0.112%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 1- 5.15 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është 11-20 mg. Bimësia natyrore e fshatit i përket brezit të dushqeve dhe ahut. Të pranishme janë pishat dhe ahu.



Fig.5. Imazh satelitor i fshatit Belorta, 2025

Belorta është një vendbanim me periudhë të gjatë popullimi. Popullsia në vitet të ndryshme është: 239 b. (v.1990), 284 b. (v.1920), 1134 b. (v. 1997), 1180 b. (v. 2002), 1225 b. (v. 2005), 1296 b. (v. 2011), 1298 b. (v. 2016) dhe 1305 b. (v. 2019). Popullsia paraqitet në rritje, por të dhënat e ZGjC. Qendër Bulgarec nuk pasqyrojnë lëvizjet kombëtare dhe ndërkombëtare të banorëve. Largimet individuale dhe familjare janë për qëllime punësimi dhe sigurimi i të ardhurave monetare më të larta krahasuar me vendbanimin e tyre. Banorët i përkasin besimit mysliman. Në qendër të fshatit ka një xhami. Aty ku gjendet xhamia kryëzohen tri rrugët kryesore të tij.

Fshati është i grumbulluar, me një qendër dhe i tipit kodrinor. Banesat e fshatit shtrihen edhe në pjesën e fushë. Ato janë të shpërndara në tokat e punëshme, të pozicionuara kryesisht në të dyja anët e rrugës nacionale. Në fshat gjenden banesa tradicionale, 1-2 katëshe, me gurrë, por dhe shtëpi të reja 2-3 katëshe të suvatuara e të ndërtuara me tulla. Të gjitha shtëpitë janë të mbuluara me çati tjegullash.

Fshati ka shkollën 9-vjecare “Belorta” në të cilën arsimohen fëmijët e fshatit. Qendra ambulatorie funksionon me një mjek dhe dy infermjere.

Belorta është pajisur me një rrjet të ri ujësjellësi, i cili siguron ujin e pijshëm nga pusët e hapura midis fshatit Kuç i Zi -Belorta, në zonë fushore. Kanalizimet e ujërave të zeza në fshat mungojnë. Infrastruktura është e pranishme në rrugët kryesore të fshatit, në brendësi të lagjeve ka rrugë të paasfaltuara. Rrjeti elektrik është shumë i mirë.

Tokat arë zënë një sipërfaqe prej 388 ha. Banorët e fshatit janë të angazhuar në kultivimin e grurit dhe drithrave të tjera të bukës, si dhe në mbarështimin e blektorisë së imët. Nga periudha komuniste janë trashëguar tokat e mbjella me pemë frutorë (kryesisht qershi) dhe pjesërisht me vreshta. Blektoria është në rënie, për shkak të kostos së lartë, mungesës së lëndëve ushqyese dhe të fuqisë puntore.



Foto 11, 12. Pamje nga lagje dhe tokat e punueshme të fshatit Belorta, 2025

Blektoria zhvillohet më tepër nga popullsia e moshës mbi 50 vjec. Në 30-vitet e fundit janë të zhvilluar shërbimet në restorante, bare dhe hotele. Përgjatë rrugës Korçë- Bilisht gjendet një karburant dhe një mulli për bluarjen e misrit. Në fshat gjenden kafene, ushqimore dhe një minimarket.

2.2.5. KUÇ I ZI

Vendbanim rural në Nj.A. Qendër Bulgarec. Gjendet në koordinatat gjeografike 40° 40'16'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 50'05'' gjatësi gjeografike lindore; në shpatin perëndimor të malit të Moravës, midis kurrizit të Gurit të Vogël dhe malit të Gurit të Madh; midis lartësive 870 m- 950 m mbi nivelin e detit; rreth 8.4 km nga qyteti i Korçës, përgjatë rrugës automobilistike Korçë- Bilisht.

Fshati kufizohet me fshatin Plasë në verilindje, fshatin Belorta në jug dhe fshatin Shamoll e Tërovë në perëndim.

Territori i Kuçit të Zi përbëhet nga depozitime të përziera aluviale-proluviale, të përfaqësuara nga rëra, zhavorre dhe alevritë të periudhës Pleistocen-Holocen (Q_{p-h}); depozitive deluvionale-koluvionale të Pleistocenit (Pg^2_3), si dhe nga shkëmbinj të jurasikut të mesëm (σJ_2). Relievi i ndërtuar prej tyre paraqitet me kontraste. Relievi malor i përfaqësuar nga mali Guri i madh (1341 m) dhe kurrizi i Guri të Vogël paraqiten me kreshtë të rrumbullakosur e me shpate të pjerrët, të gërryer nga përrenjtë që rrjedhin nga majat e tyre. Malet ndahen midis tyre nga grykëlugina e formuar nga përroi i Çurishtës, i cili grumbullon ujëra nga brendësia e Moravës. Relievi malor ndërthuret me territorin fushor, i cili është me pjerrësi në drejtim të perëndimit. Klima është mesdhetare paramalore, me verë të ngrohtë e të thatë e dimër të ftohtë e të lagësht. Të pranishme janë rreshjet e dëborës. Rreshjet në formë shiu janë nën mesataren vjetore të Shqipërisë.

Territori i fshatit Kuç i Zi është i pasur me burime ujore. Ato ndodhen në lartësi, në lindje të fshatit. Ujrat e burimeve rrjedhin në përroin e Curishtës, i cili bashkohet me ujrat e lumit Dunavec. Çurishta, në periudhën e rreshjeve intensive kthehet në një përrua i rrëmbyer, që vitet e fundit ka sjellë përmytje në fshat dhe tokat bujqësore.

Të përhapura janë tokat e brezit të kafenjtë, me trashësi të tokës mesatarisht 130 cm, me pH ujor 7.5, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 2.3 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,5 %; azoti i përgjithshëm mes. 0. 110%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 1- 5.15 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është 11-20 mg. Mbi këto toka gjenden bimësitë e brezit të dushqeve dhe ahut.



Fig.6. Imazh satelitor i fshatit Kuç i Zi, 2025)

Emri i fshatit lidhet me zbulimin e tumave të tipit me gropa, të shekullit VIII-V p.e.r. Në territorin e fshatit (në Xhungëza e vogël) janë zhvilluar gërmime arkeologjike, ku janë zbuluar dy tuma, dëshmuere të popullimit dhe zhvillimit social-ekonomik të zonës në periudhën e Hekurit të hershëm. Të dhënat e para demografike vijnë nga viti 1900. Popullsia e fshatit ka ndryshuar ndër vite: 335 b. (v.1900), 358 b. (v.1920), 850 b. (v. 2002), 857 b (2005), 856 b. (v. 2011), 858 b. (v. 2016) dhe 862 b. (2019).



Foto 13,14. Pamje nga fshati Kuç i Zi, 2025

Në vitet e fundit vihen re largime të popullsisë, kryesisht të moshave të reja, të cilët braktisin prindit, të afërmit, banesën dhe tokat për t'u punësuar në Greqi, Gjermani, Francë dhe më gjerë.

Fshati është i tipit kodrinor, i grumbulluar, me një qendër të vogël dhe rrugë kryesisht kuadratike. Banesat e fshatit janë 1, 2 dhe 3- katëshe. Banesat me gurë janë përdhese dhe të mbuluara me çati tjegullash. Ndërtimet e reja janë kryesisht 2-3 katëshe, të ndërtuara me tulla, të suvatuara, të lyera me ngjyra të ndryshme dhe të mbuluara me çati tjegullash. Rrugët kryesore të fshatit janë të asfaltuara, por në brendësi të lagjeve gjenden rrugë me çakull dhe dhe. Fshati nuk ka një shkollë, fëmijët arsimoren në shkollën e fshatit Belorta. Në fshat gjendet një qendër shëndetsore, ku ofrohet shërbim ambulator nga infermjerja dhe mjeku 1 herë në javë.

Fshati furnizohet me ujë të pijshëm nga pusët e hapura midis tij dhe Belortasë. Uji nëpërmjet pompave ngjitet në depozitat në pjesën e sipërme të fshatit dhe më pas shpërndahet në banesa. Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza është shumë i mirë. Ujrat e përroit që kalon në veri të fshatit përdoren për ujiten e një pjese të tokave arë. Sipërfaqet e tokave të punueshme të fshatit janë 302 ha. Një pjesë e tokave janë të zëna me kultivimin e perimeve dhe drithërave të bukës, ndërsa pjesa më e madhe janë të zëna me pemë (mollë, kumbulla, qershi dhe arorë). Banorët e fshatit janë të angazhuar në mbarështimin e bagëtisë së imët (veçanërisht dhentë). Përgjatë rrugës nacionale

Korçë- Bilisht gjenden tri bujtina me shërbim bar-i e restoranti, si dhe shërbime të tjera të vogla tregëtare.

2.2.6. MALAVECI

Fshati Malavec është pjesë e Nj.A. Qendër Bulgarec. Gjendet në koordinatat gjeografike $40^{\circ} 39' 36''$ gjerësi gjeografike veriore dhe $20^{\circ} 47' 43''$ gjatësi gjeografike lindore, në fushën e Korçës, në lartësinë 836 m mbi nivelin e detit, në anën e majtë të rrugës Korçë- Bilisht, rreth 6.3 km larg nga qyteti i Korçës. Kufizohet me fshatin Shamoll në veri, fshatin Bulgarec në perëndim, fshatin Dishnicë e Neviçisht në lindje dhe fshatin Barç në jug.



Fig.7. Imazh satelitor i fshatit Malavec, 2025

Territori i fshatit pozicionohet mbi depozitime ranore, alevrite dhe zhavore të periudhës së Holocenit (Q_h). Konsiderohet një fshat fushor me shtrirje tërësore në fushëgropën e Korçës, lartësia e të cilës ka një pjerrësi të vogël në drejtim të veriut. Klima në fshat është mesdhetare paramalore, jugore. Ujërat sipërfaqësore grumbullohen në kanalet

kulluese dhe përfundojnë në lumin Dunavec. Mungojnë burimet ujore natyrore. Tokat arrë ujiten me ujrë e kanalit dhe/ose me ujrë e puseve të hapur nga banorët. Tokat e fshatit janë të kafenjta, me trashësi të tokës mesatarisht 150 cm, me pH ujor 7, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 2.5 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,6%; azoti i përgjithshëm mes. 1.6%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 1.5 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes.20 mg. Bimësia natyrore e fshatit i përket brezit të dushqeve.

Fshati Malavec njih një histori të gjatë të ekzistencës. Sipas gojëdhënave fshati ka egzistuar fillimisht mbi fshatin Dishnicë (në shpatin P. të malit të Moravës), më pas popullsia është zhvendosur në fushën e Korçë, por më në qendër të saj dhe më vonë në territorin e sotëm. Në historinë e gjatë të krijimit të fshatit dëshmon Kulla e Malavecit, që është edhe Monument Kulture. Numri i popullsisë së fshatit është rritur vetëm në periudhën 1945-1990, si rezultat i nxitje së rritjes së numrit të lindjeve dhe kontrollit të lëvizjeve hapësinore të popullsisë.



Foto 15,16. Pamje e kishës së Shën Stefanit dhe qendra e fshatit Malavec, 2025

Numri i popullsisë sipas ZGjC Qendër Bulgarec është: 113 b. (v. 1900), 106 b. (v. 1920), 305 b. (v. 1997), 193 b. (v. 2001), 309 b. (v. 2011), 303 b. (v. 2019) dhe 320 b. (v. 2024). Sipas vëzhgimeve në terren në fshat jetojnë rreth 120 banorë, në 35 familje. Dominojnë grupmosha e tretë e popullsisë. Numri i fëmijëve është shumë i ulët. Në fshat

mungon kopështi dhe shkolla. Ndërtesa e shkollës fillore është e rënuar. Fëmijët e fshatit arsimohen në shkollën e fshatit Dishnicë dhe në shkollat e qytetit të Korçës. Shërbimet shëndetsore ofrohen në ambulancën e fshatit, nga infermierja gjatë gjithë javës dhe mjeku një herë në javë. Rruga kryesore e fshatit është e asfaltuar, në qendër dhe në rrugët brenda fshatit mungon asfalti. Malaveci ka rrjet të mirë të energjisë elektrike, rrjet të kanalizimeve dhe ujësjellës. Fshati furnizohet me ujë nga qyteti i Korçës. Në fshat mungon transporti publik, shërbimet tregëtare, strukturat akomoduese dhe shërbimet kulturore. Toleranca fetare shprehet në praninë e një xhamie dhe e kishës së Shën Stefanit. Banorët janë të besimit mysliman dhe ortodoks. Fshati është i organizuar në dy lagje, që ndahen nga një kanal kullues. Malaveci është vendbanim i grumbulluar, e me një qendër ku ndodhet ambulaca, një burim uji dhe rënoja e shkollës. Ndërtimet gjenden në të dyja anët e 3 rrugëve kryesore të fshatit. Banesat e vjetra janë një dhe dy katëshe, të ndërtuara me gurë ose tulla. Ndërtimet e reja janë dy dhe tri katëshe, të suvatuara e të lyera me ngjyra të ndryshme. Ndërtimet e reja janë investime të emigrantëve ndërkombëtar. Ato bëhen të jetueshme vetëm në ditë festash dhe në muajt e verës. Rreth $\frac{2}{3}$ e popullsisë kanë emigruar drejt Greqisë, Italisë, Gjermanisë dhe Amerikës. Mbas vitit 1990 në fshat kanë ardhur vetëm dy familje nga zona e Oparit. Banorët e fshatit janë të angazhuar në bujqësi, blektori dhe bletari, por për konsum familjar. Tokat arrë kultivohen me foragjere, patate, fasule dhe perime. Ka edhe sipërfaqe toke të zëna me pemë frutore (mollë). Në fshat rriten rreth 12 lopë dhe rreth 20 dele. Po thuajse në çdo familje gjenden shpendë shtëpiake.

2.2.7. SHAMOLLI

Shamolli është pjesë Nj.A. Qendër Bulgarec. Gjendet në koordinatat gjeografike $40^{\circ} 40'40''$ gjerësi gjeografike veriore dhe $20^{\circ} 46'57''$ gjatësi gjeografike lindore; në fushëgropën e Korçës; në lartësinë 819 m mbi nivelin e detit; në anën e majtë të rrugës Korçë-

Bilisht, rreth 9.2 km larg qytetit të Korçës. Kufizohet me fshatin Rov e Tërovë në veri, fshatin Bulgarec e Malavec në jug, fshatin Kuç i Zi e Belorta në lindje dhe fshatin Vashtmi në perëndim.

Fshati vendoset mbi depozitime holocenike (Q_h) (rëra, zhavore dhe alevrite). Relievi është tërrësisht fushor, me një pjerrësi shumë të vogël në drejtim të veriut. Klima është mesdhetare paramalore jugore. Territori fushor bën që fshati të jetë i ekspozuar nga erëta e të gjitha drejtimeve, të cilat në periudhën e thatësirës zhvillojnë erozion eolik në sipërfaqet e tokave të punueshme. Në fshat gjenden kanale kullues të cilët janë mbledhës të ujrave të maleve përreth. Ato janë pjesë e pellgut ujëmbledhës të Dunavecit (degë e lumit Devoll). Mungojnë burimet ujore. Nëntoka është e pasur me ujëra të freskët.

Tokat e fshatit Shamoll janë të brezit të kafenjtë, me trashësi të tokës mesatarisht 100 cm, me pH ujor 8, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 2.08 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,78%; azoti i përgjithshëm mes. 1.12%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 2.5 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes. 18 mg. Biodiversitetet përfaqësohet me katin e dushqeve.



Fig.8. Imazh satelitor i fshatit Shamoll, 2025

Shamolli është një fshat fushor, i grumbulluar e me një qendër ku ndodhet shkolla dhe qendra shëndetësore. Është një vendbanim i

krijuar përpara viteve 1900. Kjo dëshmohet nga prania e lapidarit me dëshmorë të vitit 1911. Në periudhën 1945-1990 ka pasur ardhje të popullsisë nga fshatrat malorë të Devollit (veçanërisht nga fshati Arrëz). Mbas vitit 1990 popullsia është shtuar me disa familje nga zona e Oparit. Popullsia ndër vite: 52 b. (v. 1920), 815 b. (v.1997), 782 b. (2002), 800 b. (v. 2011), 791 b. (v. 2019). Rënia e numrit të popullsisë ka ardhur si rezultat i mbizotërimit të vdekjeve kundrejt lindjeve dhe emigrimeve kundrejt imigrimeve të popullsisë. Popullsia është përfshirë në emigrim të përhershëm dhe emigrim sezonal, veçanërisht në Greqi, e shtete të tjera të Europës. Popullsia e përhershme e fshatit pothuajse është përgjysmuar, në rreth 90 familje. Dominuese është mosha e tretë dhe mosha aktive e popullsisë. Numri i fëmijëve është shumë i ulët. Në shkollën fillore “Kamber Bajlozi” arsimohen 12 fëmijë. Më tej fëmijët arsimohen përkatësisht në shkollën e fshatit Dishnicë dhe shkollat e qytetit të Korçës. Në fshat ofrohen shërbime në rrjetin elektrik, ujësjellës, internet dhe shërbime tregëtare. Shamolli furnizohet me ujë të pijshëm nga tubacioni i qytetit të Korçës. Mungon transporti publik, kanalizimet e ujrave të zeza, shërbimet e restoranteve, hoteleve dhe aktiviteteve kulturore. Rrugët kryesore të fshatit janë të asfaltuara, në brendësi të lagjeve mungon asfalti.



Foto 17,18. Pamje të banesave dhe qendrës së fshatit Shamoll, 2025

Popullia e fshatit është e angazhuar në bujqësi dhe blektori. Tokat e punuëshme zënë një sipërfaqe prej 275.48 ha. Ato kultivohen me patate, qepë, fasule dhe foragjere, ndryshe nga vitet para 1990, ku tokat mbilleshin me panxhar, misër dhe grurë. Një pjesë e tokave arë jepen me qera për kullotë. Në fshat gjenden rreth 300 krerë bagëti e imët dhe shumë pak lopë. Qumështi i tyre tregëtohet me shumicë në baxhot më të afërta. Në fshat mungojnë shërbimet tregëtare dhe shërbimet turistike.

2.2.8. ÇIFLIG

Fshati Çiflig është pjesë e Nj.A. Qendër Bulgarec. Gjendet në koordinatat gjeografike 40° 38' 44'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 46' 03'' gjatësi gjeografike lindore; në fushëgropën e Korçës, në lartësinë 826 m mbi nivelin e detit; në të djathtë të rrugës Korçë- Maliq, rreth 3.9 km nga qyteti i Korçë.

Kufizohet me fshatin Lumalas, Bulgarec e Malavec në veri, qytetin e Korçës në jug, fshatin Dishnicë e Barç në lindje dhe fshatin Melçan e Porodinë në perëndim. Çifligu është i vendosur mbi depozitime aluviale (rëra, alevrolite, zhavore) të periudhës së Holocenit (Q_h). Territori është tërërisht fushor, me një pjerrësi shumë të vogël në drejtim të veriut. Nëntoka e fshatit është e pasur me rezerva ujore, të cilat gjejnë përdorim për konsum familjar nga banorët nëpërmjet puseve. Burimet ujore me rrjedhje natyrale mungojnë. Të pranishme janë disa kanale kulluese të tokave bujqësore. Çifligu është pjesë e pellgut ujëmbledhës së lumit të Dunavecit (degë e Devollit).

Tokat janë të brezit të kafenjtë, të formuar në ranorë në kushtet klimës mesdhetare paramalore. Tokat janë të brezit të kafenjtë, me trashësi të tokës mesatarisht 100 cm, me pH ujor 8, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 2.08 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,76%; azoti i përgjithshëm mes. 1.26%; P₂O₅ i asimilueshëm në 100g tokë është 3.5 mg; dhe K₂O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes. 14 mg. Tokat e punuëshme gjenden përreth vendbanimeve të fshatit. Në

fshat janë të pranishme bimët e katit të dushqeve. Mungojnë zonat e mbrojtura.



Fig.9. Imazh satelitor i fshatit Çiflig, 2025

Termi “Çiflig” është një fjalë turke për të përkufizuar njësinë më të vogël taksapaguese në perandorinë Osmane. Nuk ka të dhëna rreth vitit të formimit të fshatit. Të dhënat e para demografike vijnë nga viti 1920. Ndër vite popullsia ka ndryshuar: 205 b. (v. 1920), 772 b. (v. 1997), 867 b. (v. 2002), 1033 b. (v. 2011), 1042 b. (v. 2016), 1041 b. (v. 2019) dhe 1050 b. (v. 2024). Aktualisht, në fshat ka rreth 270 familje. Çifligu është një fshat me shtrirje gjatësore, përgjatë rrugës kryesore hyrëse. Fshati ka një qendër, ku janë të pozicionuara shkolla fillore “Pandi Guri Visi”, qendra shëndetsore dhe godina e braktisur e qendrës kulturore. Në shkollë arsimohen rreth 30 fëmijë, që nga kopshti e deri në klasën e pestë. Qendra shëndetësore ka një infermiere që shërben gjatë gjithë javës dhe një mjeke që kryen vizita dy ditë/javë. Shtëpitë e fshatit janë të periudhave të ndryshme, nga ndërtime me plitharë e gurë, e deri në ndërtime me tulla të vogla e të mëdha. Banesat e vjetra janë 1 dhe 2-katëshe, ndërsa banesat e reja shkojnë deri në 3-kate. Banesat janë të

mbuluara me çati tjegullash. Oborret e përparme janë të zëna me hardhi rrushi e të zbukuruara me lule. Në fshat gjendet kisha e Shën Thomait dhe manastiri i Shën Athanasit të Persisë. Banorët vendas janë të besimit ortodoks, ndërsa popullsia e ardhur i përket besimit musliman. Mbas vitit 1990 fshati ka pasur të ardhur nga fshatrat malorë, si: Lavdar, Nikollarë, Mazrekë etj. Distanca e afërt me qytetin e Korçës dhe lidhja e banorëve me punët e bujqësisë e blektorisë, e bën Çifligun një fshat të preferuar. Krahës të ardhurve, emigrimi ka përfshirë grupmoshat aktive. Drejtimet e lëvizjes janë kryesisht në Bashkimin Europian (BE), si: Greqi, Itali dhe Gjermani. Preferohen punët sezonale në bujqësi dhe pemtari në shtetin Grek.



Foto 19, 20. Tipi i banesa në fshat dhe kisha e Shën Thomait, 2025

Tokat arrë janë të kultivuara me jonxhë, misër dhe grurë, duke ndihmuar zhvillimin e blektorisë. Në fshat gjenden rreth 40 lopë, të mbarështuara me rregjim stallor, produktet e të cilave tregëtohen në qytetin e Korçës. Bagëtitë e imta (dhentë dhe dhitë) janë në numër të ulët, rreth 150 kokë. Rreth 2 familje janë rritës të bletëve, mjalti i të cilave shkon për konsum familjar. Në fshat mungojnë dyqanet tregëtare të produkteve ushqimore. Qyteti i Korçës është plotësues me mallra, shërbime restoranti dhe aktivitete kulturore. Në fshat është i pranishëm transporti publik (ora 07:00 me 15: 00). Banorët furnozohen me ujë të pijshëm për 20 orë/ ditë. Ujë merret në qytetin e Korçës me tubacione. Janë të pranishme kanalizimet e ujërave të zeza, rrugët e asfaltuara, rrjeti elektrik dhe lidhjet e internetit. Në territorin e fshatit, përgjatë

rrugës nacionale Korçë-Maliq ofrohen shërbime tregëtare të materialeve të ndërtimit, gomisteri, lavazh, hotele etj.

2.2.9. BULGAREC

Fshati Bulgarec është qendra e Nj.A. Qendër Bulgarec. Gjendet në koordinatat gjeografike $40^{\circ} 39' 30''$ gjerësi gjeografike veriore dhe $20^{\circ} 45' 25''$ gjatësi gjeografike lindore; në fushëgropën e Korçës, në lartësinë 825 m mbi nivelin e detit; në anën e djathtë të rrugës nacionale Korçë-Maliq, rreth 7 km nga qyteti i Korçës. Fshati kufizohet me fshatin Vashtmi e Shamoll në veri, fshatin Çiflig në jug, fshatin Malavec në lindje dhe fshatin Lumalas në perëndim.



Fig. 10. Imazh satelitor i fshatit Bulgarec, 2025

Fshati shtrihet mbi depozitime aluviale (alevrolite, rëra, zhavorre) të Holocenit (Q_h). I pozicionuar tërësisht në fushën e Korçës, bën që fshati të ketë një pjerrësi shumë të vogël në drejtim të veriut. Klima është mesdhetare paramalore, jugore, me dimër të ftohtë e të gjatë e verë të shkurtër e të freskët. Fshati është i ekspozuar ndaj erërave për shkak të mungesës së pengesave natyrore. Rrëshjet e borës janë të pranishme në disa ditë në stinën e dimrit. Bulgareci bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit Dunavec, degë e lumit Devoll. Mungojnë burimet

ujore. Të pranishme janë vetëm kanalet kulluese të tokave bujqësore. Tokat janë të brezit të kafenjtë, me trashësi të tokës mesatarisht 110 cm, me ph ujqor 7.9, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 2.07 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,66%; azoti i përgjithshëm mes. 1.25%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 3.5 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes. 14 mg. Bimësia natyrore përfaqësohet nga brezi i dushqeve.

Emërtimi i fshatit Bulgarec rrjedh nga fjala Bullgar. Sipas gojëdhënave në territorin e sotëm të fshatit është vrarë një ushtar bullgar (tek bullgari dhe mbeti fjala tek bullgari ose Bulgarec). Rregjistrat osmane kanë dokumentuar praninë e 32 shtëpive në vitin 1450. Banorët vendas shprehen se para vitit 1945 në fshat jetonin rreth 20 familje. Në periudhën e sistemit komunist fshati u zgjerua dhe popullsia u rrit. Në ato vite janë ndërtuar shtëpitë e gurit, një dhe dy katëshe, lënda e parë e marrë pranë fshatit Lumalas. Ndërtuesit vinin nga fshatrat përreth. Mbas vitit 1990, u shtua edhe më shumë numri i banesave. Ndërtimet e reja janë dy e tri katëshe, të suvatuara dhe me çati tjegullash. Ndërtimet e reja janë ngritur në tokat arrë.

Fshati është i grumbulluar, me një qendër fshati e me rrugë që vijnë nga drejtime të ndryshme e që kryqëzohen në qendër të tij. Popullsia ndër vite: 571b. (v.1990), 423 b. (v. 1920), 2 013 b. (1997), 2 242 b. (v.2002), 2 588 b. (v. 2011), 2 596 b. (v. 2016) dhe 2 615 b. (v. 2019). Në fshat janë rreth 630 familje, ku rreth 5% janë ortodoksë dhe rreth 95% janë myslimanë. Në fshat gjendet një xhami, nuk ka kishë. Sipas të dhënave të vitit 1990 fshati kishte një kishë dhe një xhami, popullsia ishte $\frac{1}{2}$ e krishterë dhe $\frac{1}{2}$ myslimane. Aktualisht, në fshat gjenden edhe grupe të racave egjiptiane dhe rome.



Foto 21, 22. Qendra kulturore dhe qendra e fshatit Bulgarec, 2025

Sipas gojëdhënave në fillimet e tij fshati ishte me rreth 20 familje. Gjatë periudhës 1945-1990 krahas shtimit natyror të lartë, pati popullsi të ardhur nga fshati Lavdar. Edhe mbas viteve 1990 rreth 90% e të ardhurve janë nga fshati Lavdar. Nga Bulgareci ka largime në Durrës, Tiranë, por edhe Greqi, Gjermani, Francë etj. Popullsia është larguar për mundësi punësimi me paga më të larta dhe kushte më të mira të jetesës. Bulgareci ka infrastrukturë rrugore dhe rrjet elektrik të mirë. Lidhja e fshatit me qytetin e Korçës bëhet me transport privat (furgona+ taksi). Rreth 70% e banesave kanë rrjet të rregullt të ujit të pijshëm me stacion pompimi. Pjesa tjerët e banorëve kanë puse private në oborret e shtëpive të tyre. Rrjeti i kanalizimeve është i pjesshëm. Shërbimi ambulator ofrohet nga mjeku dhe dy infermiere. Fëmijët e fshatit arsimohen në shkollën 9-vjeçare “Bulgarec”. Fëmijet e arsimit të mesëm udhëtojnë drejt qytetit të Korçës.

Territori fushor i fshatit dhe afërsia me qytetin e Korçës bën që veprimtaritë dominuese të jetë bujqësia dhe shërbimet. Tokat arrë (673.52 ha) mbillen me grurë, hudhra, qepë dhe patate, ndryshe nga vitet 1945-1990 ku kultivohej panxhari, gruri dhe foragjeret. Ka edhe toka arrë të kthyer në pemishte, kultivimi i mollës. Në fshat mungojnë sipërfaqet e kullotave të pyjeve. Kafshët shtëpiake (lopa, delet dhe shpendët) janë të pakta në numër. Lopët mbahen me rregjim stallor. Qumështi tregëtohet në familjet e qytetit të Korçës dhe në baxhot më të afërta.

Përgjatë rrugës nacionale Korçë-Maliq janë ngritur disa aktivitete si: dy frigoriferë për ruajtjeve e mollëve; tri servise makinash, 1 aktivitet të përpunimit të gurit; 2 mullinj të bluarjes së grurit dhe tri zdrukthtarë. Në fshat gjendet një mini fushë futbollit dhe dy pishina verore të frekuentuara nga banorët e fshatrave dhe të qytetit të Korçës.

2.2.10. BIRANJI

Birani është pjesë Nj.A. Qendër Bulgarec. Gjendet në koordinatat gjeografike 40° 39'37'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 43'26'' gjatësi gjeografike lindore; në lindje të malësisë së Voskopojës dhe në perëndim të fushëgropës së Korçës; në lartësinë 840-915 m mbi nivelin e detit, midis disa kodrinave; në anën e majtë të rrugës nacionale Korçë- Maliq, rreth 8 km larg qytetit të Korçës. Kufizohet me fshatin Vashtmi dhe Klocë në veri, fshatin Lumalas në lindje dhe fshatin Melçan në jug. Fshati është krijuar mbi mergele, argjila mergelore, alevrolite dhe gëlqerorë të Burdiganianit (N₁^{1b}) dhe në depozitime të përzierja aluviale-proluviale të pleistocen- holocenit (Q_{p-h}). Fshati është ngritur në një luginë midis majave me lartësi: 974m, 993 m, 1049m, 1139 m dhe 961m. Kodrat përreth paraqiten me maja të rrumbullakosura dhe me shpate me pjerrësi të vogël. Në anën veriore të fshatit shfaqen forma erozionale të relievit, të karakterizuara nga dalja e shkëmbit rrënjësor dhe mungesa e bimësisë. Përmes fshatit kaloi përroi i Kumanit, fillesa e të cilit është në burimin e Kumanit. Klima është mesdhetare paramalore, jugore. Burimet ujore sipërfaqësore të përfaqësuar nga burimet dhe përroi i Kumanit janë pjesë e pellgut ujëmbledhës të lumit Devoll. Në fshat janë të përhapura tokat e brezit të kafenjtit, me trashësi të tokës mesatarisht 150 cm, me pH ujor 7, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 2.6 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1, 7%; azoti i përgjithshëm mes. 1.8 %; P₂O₅ i asimilueshëm në 100g tokë është 1.6 mg; dhe K₂O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes.18 mg. Bimësia natyrore përfaqësohet me katin e dushqeve.

Emri i fshatit është vendosur që në kohën e pushtimit Osman (Biranj ose Bir i vetëm). Ka një histori të gjatë të krijimit të vendbanimit. Banesat aktuale i përkasin tri kohëve të ndryshme: ndërtime para viteve 1945, ndërtime të periudhës komuniste dhe ndërtime pas vitit 1990. Ndërtimet e para janë një dhe dy katëshe, me mure guri dhe çati me tjegulla.



Fig.11. Imazh satelitor i fshatit Biranj, 2025

Ndërtimet e reja janë të ndërtuara me tulla ose blloqe, një ose dy katëshe, të suvatuara dhe të lyera me bojë.




Foto 23,24. Lagje e vjetër në fshatin Biranj (sipër), 2025

Banesat janë të shtrira përgjatë rrugës kryesore të fshatit. Fshati është i organizuar në Lagjen e Sipërme dhe Lagjen e Poshtme. Numri i

popullsisë në vite ka ndryshuar: 221 b. (v. 1990), 243 b. (v. 1920), 648 b. (v. 1997), 758 b. (v. 2002), 945 b. (v. 2011), 950 b. (v. 2019) dhe 836 b. (v. 2024). Mbas vitit 1990 në fshat janë vendosur banorë të ardhur nga Gramshi dhe Panariti. Në vitet e fundit, pjesa më e madhe e grupmoshës së re janë larguar drejt Tiranës, Greqisë, Gjermanisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Mbizotëron mosha e tretë e popullsisë. Popullsia i përket besimit mysliman. Në fshat mungojnë institucionet fetare.

E pranishme është shkolla fillore “ Muharem Shëmbi” e ndërtuar vitet e fundit në ish-repartin ushtarak. Shërbimi shëndetësor ofrohet në ambulancën e fshatit nga një infermiere dhe një mjek, i cili ofron vizita vetëm një ditë në javë. Në fshat ka ujë 24 orë. Lagjia e Sipërme furnizohet me ujë burimi, ndërsa lagjia e poshtme furnizohet nga depot e ujit të fshatit Bulgarec. Rruga kryesore e fshatit është e asfaltuar, ndërsa rrugët dytësore janë të pashtuara. Lëvizja e banorëve bëhet nëpërmjet transportit publik Korçë- Maliq. Rrjeti elektrik dhe rrjeti i internetit janë të pranishëm në fshat. Mungon rrjeti i kanalizimeve, strukturat akomoduese dhe tregëtare. Në fshat ka vetëm një dyqan të vogël për tregëtim të ushqimeve të shportës.

Pjesa më e madhe e popullsisë janë të vetëpunësuar në bujqësi dhe blektori. Biranji ka rreth 269 ha tokë bujqësore. Një pjesë kultivohen nga banorët vendas dhe pjesa tjetër jepen me qera te banorët e fshatrave përreth. Tokat kultivohen me patate, qepë dhe perime. Në oborret e shtëpive gjenden hardhi rrushi dhe pemë frutorë. Blektoria zhvillohet nga një numër i vogël banorësh. Në fshat mbarështohen rreth 40 dele, 100 dhi dhe rreth 20 lopë. Qumështi tregëtohet me shumicë në baxhot e bashkisë Korçë dhe me pakicë në banorët e qytetit të Korçës. Në pjesën e sipërme të fshatit ka pasur rreth 400 ha tokë pyjore (akacie) me vlera në zhvillimin e bletarisë. Ato janë prerë pa kriter në vitet 1990. Në pjesën më malore të fshatit gjenden sipërfaqet e kullotave. Në oborret e shtëpive janë të pranishëm shpendët shtëpiake.

2.2.11. LUMALASI

Fshati Lumalas është pjesë Nj.A. Qendër Bulgarec. Gjendet në koordinatat gjeografike 40° 39'28'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 44'11'' gjatësi gjeografike lindore; në perëndim të fushës së Korçës, midis lartësive 830 -860 m mbi nivelin e detit; rreth 7 km nga qyteti i Korçës, në të majtë të rrugës Korçë- Maliq. Kufizohet me fshatin Vashmi në veri, fshatin Bulgarec në lindje, fshatin Melçan në jug dhe fshatin Biranj në perëndim.

Territori i fshatit përbëhet nga depozitime proluviale-aluviale (rëra, zhavore, alevrite) të Holocenit (Q_h) dhe mergele, argjila mergelorë, alevrolite dhe gëlqerorë lititamnike të Burdigalianit (N¹_{1b}). Relievi i formuar prej tyre paraqitet me kontraste të vogla. Territori më i lartë gjendet në kodrinën në perëndim të fshatit, me lartësi 917 m mbi nivelin e detit. Kodra paraqitet me kreshtë të rrumbullakosur e me shpate me pjerrësi të vogël. Territori fushor paraqitet me pjerrësi të vogël në drejtim të lindjes.

Klima është mesdhetare paramalore jugore. Fshati është i orientuar drejt lindjes. Topografia e relievit e mbron nga erërat veriore, perëndimore dhe jugore. Bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit Dunavec, degë e lumit Devoll. Tokat janë të kafenjta, Në fshat janë të përhapura tokat e brezit të kafenjtë, me trashësi të tokës mesatarisht 150 cm, me pH ujor 7.6, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 2.5 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,7 %; azoti i përgjithshëm mes. 1.6%; P₂O₅ i asimilueshëm në 100g tokë është 1.6 mg; dhe K₂O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes.21 mg. Bimësia natyrore e fshatit i përket brezit të dushqeve.



Fig.12. Imazh satelitor i fshatit Lumalas, 2025

Nuk ka të dhënat toponimike të fshatit. Këto territore kanë qenë të populluara që herët. Pranë fshatit gjenden rënojat e një kalaje ilire të mijëvjeçarit të parë p.e.r. Lumalasi është një fshat që ka pësuar ndryshime në numrin e popullsisë: 96 b. (v. 1900), 106 b. (1920), 406 b. (v. 1997), 484 b. (v. 2002), 540 banorë (v. 2005), 541 b. (v. 2011), 535 b. (v. 2016), 544 b. (v. 2019) dhe 565 b. (v. 2024) (Enciklopedia Shqiptare, 2008). Mbas vitit 1990 në Lumalas kanë ardhur banorë nga fshati i Gjonomadhit dhe Lavdarit. Pavarsisht largimeve të popullsisë drejt Korçës, Tiranës dhe përtej kufirit shtetëror, numri i popullsisë vazhdon rritjen si rezultat i dominimit të imigrimeve. Në fshat gjenden banorë të besimit katolik dhe mysliman. Në fshat gjendet vetëm një kishë.



Foto 25. Lagje e fshatit Lumalas, ndërtime 1 dhe 2-katëshe prej guri.

Foto 26. Shkolla 9-vjecare “Lumanas”

Fshati Lumalas është ndërtuar në anën e majtë të rrugës Korçë- Maliq. Lagjet e vjetra të fshatit janë me banesa të grumbulluara, ndërsa lagjia e re paraqitet me banesa të shpërndara. Lagjet e vjetra kanë karakteristikë banesat 1 dhe 2 katëshe, prej guri e çati rasash guri ose tjegullash. Banesat e reja janë 2 ose 3 katëshe, të ndërtuara me tulla, të suvatuara dhe me çati tjegullash. Fshati ka një qendër, ku bashkohen rrugët që vijnë nga fshati Melçan, fshati Biranj dhe rruga kryesore. Rrugët kryesore janë të asfaltuara, ndërsa në brendësi të lagjeve gjenden rrugë të pa shtruara. Pranë qendrës ndodhet qendra shëndetsore, shkolla 9-vjecare, një ushqimore dhe disa magazina të mbetura që nga periudha e sistemit komunist. Qendra shëndetsore ofron shërbim ambulator nga infermjerja (gjatë të gjithë javës) dhe mjeku (1herë/javë). Shkolla 9-vjecare “ Lumalas” ofron shërbim arsimor për fëmijët e fshatit, që nga moshë 5 vjeçare e deri në moshën 15 vjeçare.

Fshati furnizohet me ujë të pijshëm nga fshati Bulgarec, ujë i siguruar nga sistemi i pompimit. Rrjeti elektrik, i internetit dhe transporti publik ofrohet mirë. Në fshat mungon sistemi i kanalizimit të ujrave të zeza. Në vitet 1945-1990 Lumalasi ka qenë qendër e fshatit të bashkuar ku përfshiheshin fshatrat Biranj, Melçan, Bulgarec, Porodinë, Vinçan, Gjonmadh, Damjanec, Goskovë e Poshtme dhe Goskovë e Sipërme (Enciklopedia Shqiptare, 1985). Gjatë kësaj periudhë fshati ishte i orientuar me drejtim bujqësor dhe blektoral. Në tokat bujqësore

prodhohej drithi i bukës, panxharsheqeri, patatet, pemët dhe rritja e lopëve. Aktualisht jo të gjitha tokat arë (156 ha) kultivohen. Një pjesë e tyre janë lënë djerrë, ndërsa pjesa tjetër kultivohen me drithëra të bukës, prime, patatet vreshta dhe pemë frutorë. Në fshat është e zhvilluar shumë pak blektoria. Në fshat gjenden rreth 2-3 kope me dele dhe shumë pak lopë. Pranë fshatit, në jug të tij, gjenden dy gurore për prodhimin e lëndëve të para në ndërtim. Pranë rrugës kryesore Korçë-Maliq gjenden shërbime hotelerie, shërbime tregëtare me shumicë e pakicë, servise makinash, karburant dhe kafene. Në fshat gjenden 3-4 ushqimore, të cilat plotësojnë pjesërisht nevojat familjare dhe 1 furrë buke.

2.2.12. MELÇAN

Fshati Melçan është pjesë e Nj.A. Qendër Bulgarec. Gjendet në koordinatat gjeografike 40° 38' 51'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 43' 18'' gjatësi gjeografike lindore; në lindje të Malësisë së Voskopojës; midis lartësive 830-900 m mbi nivelin e detit; midis disa majave me lartësi 913m, 983 m, 1141m, 1139 m dhe 956m, rreth 9 km larg qytetit të Korçës. Fshati mund të arrihet nëpërmjet rrugës Korçë-Lumalas-Melçan dhe nëpërmjet rrugës Korçë- Turan-Melçan. Kufizohet me fshatin Biranj e Lumalas në veri, fshatin Prodinë në jugperëndim, fshatin Çiflig në lindje dhe fshatin Vinçan në perëndim. Territori i fshatit shtrihet mbi depozitimet ranore, argjilore dhe konglomeratike të oligocenit të mesëm. Relievi i ndërtuar prej tyre dallohet për kontraste të vogla morfologjike, me maja të rrumbullakosura të maleve dhe shpate të butë. Mungojnë format erozionale natyrore për shkak edhe të mungesës së dendësisë së përrrenjve. Relievi është kryesisht kodrinor, pothuajse i zhveshur nga bimësia natyrore.



Fig.13. Imazh satelitor i fshatit Melčan, 2025

Fshati Melčan është i rrethuar nga kodrat në lindje, veri dhe perëndim dhe i hapur në drejtim të fushës së Korçës në juglindje. Relievi kodrinor e mbron vendbanimin nga erërat e ftohta veriore dhe lindore. Fshati ka ekspozim të mirë ndaj rrezeve të diellit gjatë të gjithë ditës. Klima në fshat është mesdhetare paramalore jugore, me karakteristikë verën e freskët dhe dimrin e gjatë e të ftohtë. Bien rreshje në formën e dëborës përgjatë disa ditëve në dimër.

Burimet ujore të fshatit (si; burimi i Kumanit), të cilët burojnë në lartësi të kodrës, përfundojnë në lumin e Dunavecit. Territori bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit Devoll. Tokat e fshatit janë të brezit të kafenjtit me trashësi të tokës mesatarisht 140 cm, me ph ujqor 6.7, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 2.7 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,5 %; azoti i përgjithshëm mes. 1.6%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 1.5 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes.18 mg. Ato gjejnë përdorim si toka të punueshme, janë të sistemuara në parcela. Bimësia natyrore është e brezit të dushqeve.

Sipas gojëdhënave emri i fshatit Melčan vjen nga tog fjalëshi “vendi i mjaltit”. Njihet si një vendbanim i hershëm, e vërtetuar nga gjetjet

arkeologjike në tokat arrë të fshatit. Thuhet se para pushtimit osman territoret e Melçanit ishin tepër të populluara. Në territoret kodrinore ka pasur kisha dhe një manastir (tashmë kanë mbetur si toponime të vendeve). Në vitet 1945-1990 fshati ishte pjesë e kooperativës bujqësore të Lumalasit. Tokat kodrinore ishin të taracuara e të kultivuara me rrush e pak bajame, ndërsa tokat fushore kultivoheshin me grurë, misër, panxhar etj.

Ndër vite fshati ka pasur zhvillime të ndryshme demografike, ekonomike dhe sociale. Të dhënat e numrit të popullsisë janë: 242 b. (v. 1900), 231 b. (v. 1920), 543 b. (v. 1997), 541 b. (v. 2002), 554 b. (v. 2011), 548 b. (v. 2016), 557 b. (2019) dhe 410 b. (2024).

Popullsia është në rënie për shkak të largimeve të popullsisë në Korçë, Tiranë, Durrës dhe përtej kufirit të Shqipërisë, në Greqi, Gjermani, Itali e më tej. Donimojnë banorët e moshës së tretë. Fshati Melçan nuk ka imigrime nga fshatrat më të largëta e më malore të rajonit. Kjo për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore vite më parë dhe lidhjes jo të drejtpërdrejtë me qytetin e Korçës. Fshati i Melçanit ka banesa që shtrihen përgjatë rrugës kryesore, duke i dhënë vendbanimit një trajtë gjatësore.

Të pranishme janë ndërtimet e hershme 1-katëshe, me mure guri e çati tjegullash të kuqe. Oborret e banesave janë të rregulluara me hardhi rrush dhe pemë frutorë. Të pranishme janë edhe ndërtimet e reja, 2-3 katëshe, me mure tulle/blloku, të suvatuara e me çati tjegullash. Fshati është i organizuar në lagje sipas fiseve që e përbëjnë atë (Dinellari, Qylaflari, Devolli, etj). Ka një qendër fshati ku gjendet një lapidar, ambulanca dhe 2 bar-e e 1 dyqan. Rrugët dytësore të fshatit janë të pashtruara. Në fshat mungon transporti publik. Rrjeti elektrik, ujësjellësi, kanalizimet dhe rrjeti i internetit janë në kushtet të mira. Fshati furnizohet me ujë prej burimit të Kumanit, pranë të cilit është ndërtuar depoja e ujit. Në pjesën e poshtme të fshatit janë ndërtuar gropa septike ku mblidhen të gjithë ujërat e zeza. Rrjeti i internetit vjen nga qyteti i Korçës.

Fshati ka shkollën fillore “Melçan” ku arsimohen fëmijët e fshatit nga kopështi e deri në klasën e 5-të. Shërbimi ambulator ofrohet nga infermierja e fshatit gjatë të gjithë javës dhe mjeku një herë në javë. Në fshat gjenden tri dyqane ushqimore dhe tri bar-e. Mungojnë shërbimet dhe institucionet kulturore.



Foto.27 28. Qendra e fshatit Melçan dhe Teqeja e Melçanit, 2025

Aktualisht fshati është me orientim bujqësor dhe blektoral. Tokat arrë zënë një sipërfaqe prej 228.58 ha. Një pjesë janë të lëna djerrë ndërsa pjesa tjetër kultivohen me perime, qershi dhe mollë. Sipërfaqet e tokave kodrinore janë braktisur, duke mos u zhvilluar më vreshtaria. Ndryshimet klimatika ka ndikuar negativisht në kulturën e fasules dhe të bajameve.

Blektoria është e zhvilluar nëpërmjet mbarështimit të rreth 500 krerë dele, 100 krerë dhi dhe rreth 90 lopë. Qumështi dhe mishi tregëtohet përkatësiht në baxho dhe dyqanet e mishit të zonës.

Fshati njihet për turizmin fetar. Në fshat gjendet Teqeja e Melçanit, një objekt i lashtë fetar, e rikonstruktuar në v. 2014 në themelet e vjetra të objektit ekzistues. Teqeja daton në vitin 1640, ndër 5 teqetë më të vjetra shqiptarë, dhe më e vjetra në Shqipërinë JL. Është ndërtuar në një kodër rreth 960 m, në veri të fshatit. Konsiderohet me vlera shpirtërore, fetare dhe turistike.

2.2.13. PORODINË

Porodina është pjesë e Nj.A. Qendër Bulgarec. Gjendet në koordinatat gjeografike 40° 38'11'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 42'50'' gjatësi gjeografike lindore, në rëzë të disa majave të malësisë së Voskopojës; në lartësitë 845-935 m mbi nivelin e detit; në anën e djathtë të rrugës Korçë- Voskopojë, rreth 8 km larg qytetit të Korçës. Fshati kufizohet me fshatin Vinçan e Damjanec në perëndim, fshatin Biranj, Lumalas dhe Melcan në lindje dhe fshatin Goskovë e Turan në jug. Territori i fshatit shtrihet në rrëzën lindore të malësisë së Voskopojës dhe në fushën e Korçës.

Territori i fshatit shtrihet mbi depozitimet ranore, argjilore dhe konglomeratike të Oligocenit të Mesëm (Pg²₃) dhe në depozitime ranore, zhavorore, alevrite të pleistocen-holocenit (Q_{h-p}). Relievi është i tipit kodrinor dhe fushor. Fshati rrethohet nga veriu nga disa maja me lartësi: 983m, 1141 m dhe 1120 m. Klima në fshat është mesdhetare paramalore jugore. Territori malor në veri dhe kodra në lindje e mbron fshatin nga erërat e ftohta. Territoret bëjnë pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit të Dunavecit. Mbi fshat ka një burim të vogël ujqor. Tokat janë të brezit të kafenjtë me trashësi të tokës mesatarisht 130 cm, me pH ujqor 6.6, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 2.3 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,5%; azoti i përgjithshëm mes. 1.3%; P₂O₅ i asimilueshëm në 100g tokë është 1.4 mg; dhe K₂O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes. 21 mg. Tokat arrë janë të ndara në parcela. Bimësia natyrore është e brezit të dushqeve



Fig.14. Imazh satelitor i fshatit Porodinë, 2025

Emërtimi “Porodinë” rrjedh nga fjala “Poro=burim nga greqishtja+dinë=e din”, në kërkim të ujit. Fshati ka një histori të gjatë krijimi, përpara pushtimit osman. Kjo dëshmohet nga prania e vakëfit të Shën Mërisë në pjesën e sipërme të fshatit. Deri në vitin 1945 fshati shtihej në lartësinë mbi 900 m. Kjo dëshmohet nga lagjet e vjetra të fshatit të ndërtuara me gurë, e të mbuluara me çati rrasa guri. Mbas vendosje së rregjimit komunist, si rezultat edhe të shtimit të popullsisë fshati filloi të zgjerohej deri në lartësitë 850 m. Shtëpitë e periudhën 1945-1990 janë të ndërtuara me gurrë ose tulla, me çati tjegullat, një katëshe. Ndërtimet e mbas 1990 karakterizohen nga përmasat e mëdha, dy e tre katëshe, të suvatuara e të “modernizuara”. Ndërtimet e reja nuk kanë ruajtur artitekturën e peizazhit të fshatit. Banesat e vjetra përfaqësojnë lagjen “Mëhallën lart”, ndërsa ndërtimet e reja përfaqësojnë lagjet “Mëhalla poshtë” dhe “Stallat e reja”. Fshati shtrihet përgjatë rrugës kryesore të fshatit, që ngjitet në lartësi.



Foto 29, 30. Pamje të fshatit Porodinë, 2025


Të dhënat e Zyrës së Gjendjes Civile Qendër Bulgarec tregojnë se numri i popullsisë ka ndryshuar në vite: 380 b. (v. 1900), 384 b. (v. 1920), 1053 b. (v.1997), 1051 b. (v.2002), 1019 b. (v. 2011), 1014 b. (v. 2016) dhe 1016 b. (v. 2019). Fshati ka 2-3 familje të ardhur nga fshatrat e Oparit. Fshati karakterizohet nga largimet drejt qytetit të Korçës, qytetit të Tiranës dhe përtej kufirit (Gjermani, Francë, Angli etj). Në vitin 2024 Porodina ka 637 b. me banim të përhershëm, në 170 familje. Rreth 1/3 e popullsisë së moshës deri në 40-vjec është përfshirë në emigrim.

Banorët e fshatit i përkasin besimit mysliman. Në fshat gjendet një xhami dhe vakëfi i Shën Mërisë, në mjediset e secilës organizohet një festë e përvitshme më 8 shtator, dita e lindjes së saj. Fshati ka një shkollë fillore “Shaban Mukallari” ku arsimohen rreth 17 fëmijë nga kopështi e deri në klasën e 5-të. Fëmijët e klasave të 6-ta deri në të 9-ta arsimohen në shkollën 9-vjeçare Vinçan. Arsimi i mesëm merret në shkollat e qytetit të Korçës. Shërbimi shëndetësor ofrohet nga 2 infermjere gjatë gjithë javës dhe mjeku 1 herë në javë. Porodina e ka rrugën kryesore të asfaltuar, ndërsa rrugët midis banesave janë të paasfaltuara. Rrjeti elektrik dhe ujësjellës janë në gjendje të mirë. Rrjeti i ujësjellësit është i ri. Janë bërë shpime pranë ish-fushës së Aviacionit Lumalas dhe me stacion pompimi uji dërdhet në dy depozitat e ujit në pjesën e sipërme të fshatit. Porodina nuk ka rrjet të ujrave të kanalizimeve. Sipas zyrës kadastrale Porodina ka rreth 400 ha tokë bujqësore. Toka përdoret për kultivimin e perimeve (domate,

kastraveca), qepë, patate për konsum familjar dhe tregëtar. Përreth fshatit ka vreshta, ku rrushi përdoret për prodhimin e rakisë. Në fshat rriten rreth 100 lopë me rregjim stallor dhe rreth 1 000 kokë dele. Qumështi tregëtohet në baxhot e bashkisë Korçë. Kullotat dhe sipërfaqet e pyjeve gjenden në lartësitë e maleve përreth. Në Porodinë mungojnë aktivitete industriale dhe përpunuese. Sektori i tretë i ekonomisë përfaqësohet nga tregëtia e produkteve bujqësore dhe blektorale; 2 dyqane ushqimore dhe 2 kafene. Festa e lindjes së Shën Mërisë (8 shtatori) është aktiviteti i vetëm kulturor në fshat, e cila mbledh banorët vendas dhe të larguarit në këtë ditë të shenjtë.

2.3. NJËSIA ADMINISTRATIVE DRENOVË

Njësia administrative (Nj.A.) Drenovë është pjesë e bashkisë së Korçës. Territori i njësisë administrative shtrihet në lindje të bashkisë midis $40^{\circ} 30' 52''$ e $40^{\circ} 37' 43''$ gjerësi gjeografike veriore dhe $20^{\circ} 42' 41''$ e $20^{\circ} 51' 21''$ gjatësi gjeografike lindore. Distança veri-jug është 12.6 km dhe lindje-perëndim është 16 km. Kufizohet në lindje me Nj. A. Hoçisht dhe Nj.A. Miras (të bashkisë Bilisht), në veri me Nj.A. Qendër Bulgareç dhe Nj.A. Korçë, në perëndim me Nj. A. Voskop dhe në jug me Nj. A. Mollaj.



Harta 7 . Shtrirja gjeografike e Njesisë Administrative Drenovë

Ka një sipërfaqe prej 92 km², ose 11% të gjithë sipërfaqes së bashkisë. Njësia administrative Drenovë përbëhet nga 8 fshatra: Mborje Drenovë, Moravë, Dardhë, Boboshtiçë, Qatrom, Ravonik dhe Turan. Drenova si njësi administrative gjendet në zonën tektonike të Mirditës dhe gropave ndërmallore. Të pranishëm janë depozitimet aluviale (alevrolite, rëra, zhavore) të Holocenit; depozitive deluviale-koluviale dhe aluviale të Pleistocenit; argjila, rëra, konglomeratë e qymyre të Oligocenit të Mesëm; gëlqerorë konglomeratikë të Kretës së Poshtme; breçke ofiolitike, ranorë tufogjenë të Jurasikut të Sipërm dhe depozitime të Jurasikut të Mesëm (Harta gjeologjike 1:200 000). Territori i njesisë shtrihet në fushëgropën e Korçës dhe në malin e Moravës. Lartësia më e ulët është 830 m mbi nivelin e detit dhe lartësia më e lartë është 1740.5 m (Guri i Mprehtë) mbi nivelin e detit. Klima është tipike mesdhetare paramalore dhe malore. Territori i njesisë administrative bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit të Dunavecit, dhe të lumit Devoll. Brenda territorit të Nj.A. gjenden burime të shumta ujore (sidomos në fshatin Dardhë) dhe përrenj (i Dardhës, i Qytetit etj). Tokat janë kryesisht të brezit të kafenjtë dhe të murrme pyjore, kurse bota bimore dominohet nga brezi i dushqeve edhe i ahut. Trashëgimia natyrore përfaqësohet nga Biomonumenti “ Bredhi i Vishnjës” dhe Peizazhi i Mbrojtur “ Bredhi i Drenovës- Sinicë”.

Nj.A.Drenovë ka të regjistruar gjithsej rreth 4 501 banorë në 2023, nga të cilët 2 471 meshkuj dhe 2 030 femra. Moshë e re (0-14 vjeç) zë 11.5 % të popullsisë, moshë aktive (15-64 vjeç) zë 64.7 % dhe moshë e tretë (65+ vjeç) 23.8% të popullsisë. Në popullsi me moshë mbi 10 vjeç të Nj.A. Mollaj, rreth 42.3 % e tyre është me arsim 7/8/9 vjeçar; 27.2% me arsim të mesëm dhe vetëm 12.1 % me arsim të lartë dhe pasuniversitar. Popullsia e regjistruar në gjendjen civile të njesisë nuk përkon me popullsi të prezente, për shkak të lëvizjeve të vazhdueshme migratore brenda vendit në drejtim të Tiranës, Durrësit dhe qyteteve në perëndim të vendit. Një pjesë e konsiderueshme e banorëve kanë migruar dhe migrojnë jashtë vendit kryesisht në drejtim të Greqisë,

Italisë, Amerikës, Gjermanisë etj. Përpos lëvizjeve migruese në fshatrat e Nj.A. Drenovë ka patur edhe ardhje të popullsisë nga zonat e thella si Opari, Panariti, Lavdari, por edhe zona jashtë qarkut si Skrapari. Në 22 vitet e fundit, sipas të dhënave të Censuseve 2001, 2011 dhe 2023, numri i popullsisë në Nj.A. Drenovë ka rënie graduale me 22 %, përkatësisht v.2001 me 5 743b.; v. 2011 me 5 581 b. dhe v.2023 me 4 501 b.

Aktivitetet kryesore ekonomike në Nj.A.Drenovë janë bujqësia dhe blegtoria, e cila në një numër të konsiderueshëm të familjeve përdoret për të mbuluar nevojat vetiake të familjes dhe në raste të tjera edhe për treg. Në këtë njësi ka tre baxho të përpunimit të qumështit dhe prodhimit të nënprodukteve të tij, të cilat ndodhen një në Drenovë dhe dy në Boboshticë. Prodhimet furnizojnë tregun e bashkisë, qarkut dhe qytete të tjera të Shqipërisë. Në Qatrom dhe në Boboshticë (Shehu, Arna) ndodhen gjithashtu disa pulari dhe thertore që furnizojnë tregun vendas me produkte të mishit dhe nënprodukteve të tij. PROFast fabrikë e përpunimit të mishit që furnizon tregun me nënprodukte të tij.

Nj.A.Drenovë zotëron 2556 ha tokë bujqësore, nga të cilat 2363 ha janë toke arë, 150 ha drurë frutorë (mollë, arra, mana) dhe 43 ha vreshta. Drenova njihet për kultivimin e grurit, elbit dhe jonxhës ku kultivimi i grurit zë rreth gjysmën e sipërfaqes. Interes për banorët ka kultivimi i perimeve për nevoja familjare. Uji që përdoret për vaditje vjen nga Rezervuari i Gjancit dhe perrenjtë që zbresin nga mali i Moravës. Blegtoria bazohet në rritjen dhe mbarështimin e dhenve dhe lopëve. Familjet kanë mesatarisht 1-2 krerë lopë. Ka familje që kanë edhe dhen dhe dhi. Në këtë njësi ndodhen 2 ferma me 25-30 krerë lopë dhe 700-800 krerë dhen.

Infrastruktura bazohet tek infrastruktura fizike dhe infrastruktura e shërbimeve. Rrugët që lidhin fshatrat janë të asfaltuara dhe kanë lehtësi komunikimi me njëri-tjetrin. Rrjeti energjitik ofron energji elektrike të pandërprerë 24 orë në të gjithë vendbanimet. Mbulimi i territorit me ujë 24 orë nuk mungon në vendbanimet fushore ndërkohë që në ato malore furnizimi me ujë realizohet edhe nëpërmjet puseve familjare. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza ka ardhur duke u përmirësuar.

Telekomunikacioni ofrohet nëpërmjet shërbimit të telefonisë celulare, Fast Net mbulon me sinjal interneti të gjitha fshatrat. Mbetjet urbane të njësisë administrative depozitohen në landfildin e Maliqit. Edhe mbetjet inerte trajtohen në vendgrumbullime të posacme.

Transporti i njëjërve në vendbanimet e njësisë mundësohet nëpërmjet transportit privat, furgona dhe taksi. Mungon transporti publik që lidh qytetin me fshatrat e njësisë.

Shërbimi shëndetësor ofrohet nëpërmjet qendrave shëndetësore të pranishme në cdo vendbanim. Mjekët janë të pranishëm dy herë në javë dhe shërbimi ambulator ofrohet nga infermjerët e përhershëm. Në njësinë administrative Drenovë mungojnë cerdhet ndërsa kopshtet i gjejmë të pranishme në fshatrat Mborje, Drenovë, Qatrom, Ravonik, Turan. Shkollat 9-vjecare ndodhen në Turan, Ravonik, Mborje, Boboshticë dhe Drenovë. Largimi i popullsisë dhe afërsia e vendbanimeve të njësisë me qytetin e Korcës ka mundësuar arsimin e mesëm për kontigjentin e fëmijëve që mbarojnë arsimin 9-vjecar.

Trashëgimia kulturore në territorin e njësisë është e pasur me objekte kulti, ndërtime arkitekturore, tradita, zakone, festime dhe kulinari. Dallohen kishat e hershme të cilat gëzojnë statusin Monument Kulture, Kategoria e Parë si: Kisha e Ristozit në Mborje, Kisha e Shën Gjergjit në Dardhë, Kisha e Shën Jovanit në Boboshticë, Teqeja e Turanit etj. Dardha dhe Boboshtica janë kthyer tashmë në destinacione turistike të vizitueshme nga vizitorët vendas dhe të huaj.

Drenova njihet si vendlindja e shkrimtarit të njohur Aleksandër Stavre Drenova, (Asdreni) vargjet e të cilat këndohen në Hymni i Flamurit. Monumenti dhe banesa e tij ndodhen në fshatin Drenove. Figurë e njohur është gjithashtu filantropi Selim Mborja.

2.3.1. DRENOVË

Vendbanim rural dhe qendra e Nj.A. Drenovë. Gjendet në koordinatat gjeografike: $40^{\circ}34'58''$ gjerësi gjeografike veriore dhe $20^{\circ}47'29''$ gjatësi gjeografike lindore; në perëndim të vargut malor të Moravës; në rëzë të shpati perëndimor të malit të Thanasit (1401.6 m) dhe malit të Kopkës (1461.8 m); në lartësinë 940-1000 m mbi nivelin e detit, rreth 4.7 km larg qytetit të Korçës.



Fig. 15. Imazh satelitor i fshatit Drenovë dhe Moravë, 2025

Fshatrat më të afërt janë: Mborja në veri, qyteti i Korçës në veriperëndim, Qatromi në perëndim dhe Boboshtica në jug. Territori i Drenovës përbëhet nga depozitime të përziera aluviale-proluviale, të përfaqësuara nga rëra, zhavorre dhe alevritë të periudhës Pleistocen-Holocen (Q_{p-h}); depozitive deluvionale-koluvionale të Pleistocenit (Q_h) dhe sekuenca mantelike me ndërthurje të rralla të dunitëve në pjesën e sipërme (σJ_2). Në zërë të Moravës, pranë fshatit janë rënojat e dy minierave qymyrnxjerrëse të Drenovës (fusha e parë dhe fusha e dytë) që funksionuar deri në vitet e para të shekullit XXI. Fshati shtrihet në depozitimet ranore, zhavorore e alevrite të sjella nga mali i Moravës prej përrenjve, e që formojnë një territor me pjerrësi në drejtim të

fushës së Korçës. Relievi fushoro-kodrinor i modeluar nga përroi i Bozdovecit dhe përroi që vjen nga Fusha e dytë (miniera), i takon pellgut ujëmbledhës të lumit Devoll. Këta përrenj presin tërrthor shpatin perëndimor të Moravës, duke formuar gryka malore. Mbasi dalin në territorin fushor bashkohen me kanalet kullues të fushës së Korçës, për të përfunduar në Dunavec, e Devoll.

Klima është tipike mesdhetare paramalore, me verë të freskët dhe dimër të gjatë. Gjatë periudhës së dimrit vërehen ditë me ngrica dhe rreshje të dëborës. Territori karakterizohet nga sasi të vogla të rreshjeve të shiut gjatë të gjithë vitit. Pozicioni gjeografik e mbron vendbanimin nga erërat e ftohta lindore.

Territori i Drenovës është i pasur me burime ujore, si: burimi i Izvorit, i Ujit të Ftohtë dhe Mezi i Grykës, që dalin në brendësi të malit të Moravës. Uji i burimeve mbledhet në tri depo uji dhe furnizon fshatin me ujë në 24 orë.

Në fshat janë të përhapura tokat e kafenjta, të cilat zhvillohen në lartësinë 600-1000 m lartësi, në shkëmbinj terrigjenë, reliev fushor, klimë mesdhetare paramalore dhe bimësinë e dushqeve. Trashësia e tokës është mesatarisht 160 cm, me ph ujqor 7.5, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 1.89 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,5%; azoti i përgjithshëm mes. 0. 16%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 2.4 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes. 15 mg. Në brendësi të malit të Moravës janë të përhapura tokat e murrme pyjore. Tokat e punueshme (arat) janë të parcelizuara, të shtrira në V., P., dhe J. të fshatit, duke zënë një sipërfaqe prej 486 ha. Tokat e zëna me pyje janë rreth 500 ha.

Në fshat shfaqet kati i dushqeve, ndërsa në brendësi të malit Moravë shfaqet kati i ahut dhe i halorëve me pyje të dendur e të dominuar nga bredhi (*Abies sp.*), ahut (*Fagus sylvaticus*), pishës (*Pinus sp.*), lajthisë (*Corrilus avellana*). Bota shtazore përfaqësohet nga ariu (*Ursus artos*), ujku (*Canis Lupus*), kaprolli (*Capreolus capreolus*) etj. Territoret malore të Drenovës janë në mbrojtje si kategori e V-të e Zonave të Mbrojtura “Peizazh Natyror Bredhi i Drenovës- Sinicë”. Pjesë e

territorit të fshatit Drenovë është edhe bredhi Burimi i Çardakut, një dru mbi 250 vjeçar, me lartësi 20 m, diameter mbi 150 m e perimenter rreth 3 m.

Sipas të dhënave arkeologjike dhe historike fshati ka histori të gjatë zhvillimi. Sipas gojëdhënave emri Drenovë rrjedh nga fjala bullgare “Drena=e drenuar ose e kulluar”. Banorët vendas shprehen se fillimisht në këtë vendbanim është folur gjuha Bullgare dhe në vitin 1450 kishte rreth 87 shtëpi. Fshati Drenovë është populluar nga popullsia arumune (vllehe) e ardhur nga Himara dhe Saranda. Banorët e fshatit kanë marrë pjesë në luftin Antifashiste Nacional Çlirimtare. Mbas vendosjes së regjimit komunist (v.1956) u ngrit kooperativa bujqësore dhe filloi puna intensive në minierën e Mborje-Drenovës. Deri në fund të viteve ‘80 në fshat jetonin rreth 470 familje, të punësuar në bujqësi dhe nxjerrje të qymyrgurit. Tokat kultivoheshin me grurë, misër dhe patate mali. Fshati Drenovë është njohur për kultivimin e drurëve të manit dhe prodhimit të rakisë së manit, një prodhim tradicional i veçantë.

Ndër vite numri i popullsisë: 849 b. (v.1900), 868 b. (v. 1920), 851 b. (v. 2001), 2 521 b. (v. 2005), 2 642 b. (v.2009) dhe 2 442 b. (v. 2024) (sipas zyrës së Gjendjes Civile). Mbas vitit 1990, në Drenovë filloi tranzicioni demografik, ekonomik dhe social. Numri i popullsisë rezidente gjatë të gjithë vitit është në përgjysmim, rreth 1000 b., dhe rreth 180 familje. Rreth 95% e banorëve i përkasin besimit ortodoks dhe vetëm 5% janë të besimit mysliman. Në fshat gjenden 4 kisha (e Shën Konstandinit, e Shën Gjergjin, e Shën Mërisë, dhe e Shën Basil). Banorët e fshatit janë përfshirë në lëvizjen migruese kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos të popullsisë arumune në drejtim të Greqisë. Nga ky fshat kanë dalë njerëz të shquar që kontribuan gjatë Rilindjes Kombëtare, si: Asdreni (Aleksandër Stavre Drenova), Efthim Kristo, Piro Milkani. Popullsi të ardhur ka shumë pak, kryesisht nga fshatrat e thella të Devollit. Në vitet e fundit janë rikthyer emigrantët ndërkombëtarë mbas daljes në pension. Popullsia në emigrim ndërkombëtare kanë investuar në ndërtimtarinë e fshatit. Krahas banesave të vjetra të ndërtuara me gurë, një katëshe dhe me çati me

rasa guri, ka ndërtime të reja me 2-3 kate të suvatuara, me çati tjegulle e murre tullash. Pjesa më e madhe e ndërtimeve të reja gjenden në P. të fshatit. Disa rrugë të fshatit janë të shtruara me kalldrëm, rruga kryesore është e asfaltuar.



Foto 31, 32. Pamje të banesave dhe rrugëve të gurta të fshatit Drenovë, imazh i kishës në qendër të fshatit, 2025

Në Drenovë mungon transporti publik. Lëvizjet e banorëve kryhen me makina private dhe taksi. Drenova ofron rrjet të mirë të energjisë elektrike, ujësjellësit dhe internetit. Shërbimi shëndetsor ofrohet nga dy infermjere dhe mjeku që kryen vizita 1 herë në javë. Shkolla 9-vjeçare “Kico Grabocka” është kthyer në shkollë fillore dhe është në varësi të shkollës 9-vjeçare të fshatit Mborje. Klasat janë kolektive nga rënia e numrit të nxënësve, si rezultat i emigrimit dhe preferenca e fëmijëve për të studiuar në shkollat e qytetit të Korçës.

Në fshat gjendet një market për tregëtimin e mallrave ushqimore; pesë bar-kafe, një bujtinë, një postë shtetërore dhe një qendër kulturore, e rikonstruktuar për tu vënë në shërbim të komunitetit. Aktualisht fshati ka orientim industrialo-bujqësor. Në territorin e fshatit gjendet një pulari, një baxho, një fabrikë e prodhimit të oxhaqeve dhe një fabrikë e prodhimit të sallamit. Në fshat gjenden rreth 20 ha tokë të mbjella me lajthi e mollë. Përparësi ka kultivimi i tokave arrë në oborret e banesave. Tokat bujqësore janë lënë djerrë nga emigrantët. Një pjesë e tyre janë të mbjella me foragjere, misër dhe grurë në ndihmë të blektorisë. Në fshat mbarështohen rreth 400 kokë dele, 100 kokë dhi, rreth 100 lopë dhe shpendë shtëpiake (pula). Peizazhi natyror dhe

afërsia me qytetin e Korçës bën që banorë të qytetit të rrisin bletë në mjediset e fshatit Drenovë.

2.3.2. MORAVA

Fshat Moravë ose “Qyteti Stalin” është një vendbanim i Nj.A. Drenovë. Gjendet në koordinatat gjeografike: 40°35’15” gjerësi gjeografike veriore dhe 20°47’38” gjatësi gjeografike lindore; në perëndim të vargut malor të Moravës; në rëzë të shpati perëndimor të malit të Thanasit (14016m). Morava ngjan si një lagje veriore e fshatit Drenovë. Gjendet shumë afër qytetit të Korçës, 4.3 km. Fshatrat të tjerë të afërt janë Mborja në V. dhe Qatromi në P.. Morava është ndërtuar mbi depozitime të përziara aluviale-proluviale të sjella prej përrenjve dhe rrëqeve të ujit nga mali i Moravës. Banesat e fshatit janë krijuar në një territor fushor, rreth 950 m lmd. Klima është mesdhetare paramalore, ndërsa pellgu ujëmbledhës i përket lumit Devoll. Të përhapura janë tokat të kafenjta. Bimësia natyrore përfaqësohet nga kati i dushqeve.



Fig.16. Imazh satelitor i fshatit Drenovë dhe Moravë, 2025

Fshati Moravës është krijuar në vitet '50 të shek. XX-të për të strehuar të punësuarit në minierën e qymyrgurit të Drenovës. Të punësuarit në minierë kanë ardhur nga fshatrat malorë të Devollit, Ersekës, Korçës, Maliqit dhe Pogradecit. Në përgjithësi meshkujt ishin të punësuar si minatorë, ndërsa gratë punonin në bujqësi (në fermën e Dëvoranit). Nga natyra industriale e vendbanimit, në territorin e fshatit gjendej një spital i përgjithshëm, një farmaci, një dentist, dyqane dhe një vatër kulture.

Banesat e Moravës janë të organizuara në formën e parcelave, me rrugë të drejta e paralele midis tyre. Ndërtimet janë me tulla, 1-2 katëshe dhe në formën e pallateve 3-katësh. Banesat janë të pasuvatuara dhe me çati tjegullash.



Foto 33, 34. Pamje nga qendra e fshatit dhe ndërtimet të formës së pallateve me tulla, 2025

Mbas ndryshimit të sistemit, fshati Moravë ndryshoi profilin ekonomik. Aktiviteti i nxjerrjes së mineralit vazhdoi deri në fillim të viteve 2000 dhe me pas u ndërpre plotësisht. Privatizimi i tokave, në bazë të ligjit 7501, la pa tokë banorët e fshatit. Ndërprerja e aktivitetit të nxjerrjes së mineralit dhe mungesa e tokës bëri që një pjesë e banorëve të përfshiheshin në emigrim brenda vendit (qyteti i Korçës, Tirana, Durrësi) dhe përtej kufinjve si Greqi, Itali, Zvicër etj. Popullsia ndër vite është: 805 b. (v. 2001), 1 438 b. (v. 2009) dhe 1 358 b. (v. 2024). Popullsia rezidente është përgjysmuar. Emigrimi masiv ka ndikuar në shit-blerjen e banesave dhe në investimet e reja. Në Moravë

ka investime në banesa të reja nga emigrimi dhe nga banorë të qytetit të Korçës (veçanërisht nga komuniteti Romë). Në fshat është e pranishme infrastruktura rrugore, rrjeti elektrik dhe ujësjellësi (furnizimi i njëjtë me fshatin Drenovë). Në Moravë gjendet Qendra Shëndetsore e të gjithë Nj.A. Drenovë. Shërbimi arsimor ofrohet në fshatin Drenovë dhe qytetin e Korçës. Në fshat mungon shkolla, transporti publik, shërbimet kulturore dhe strukturat akomoduese. Prej viteve 1990 nuk funksionon spitali, shërbimi dentar dhe farmaceutik. Banorët jetojnë me ndihmë ekonomike dhe me remitancat e sjella nga familjarët në emigrimin ndërkombëtar.

2.3.3. MBORJE

Fshat kodrinor në njësinë administrative Drenovë. Gjendet në gjerësinë gjeografike: 40°36'12'' dhe gjatësinë gjeografike: 20°48'17''. Shtrihet në rëzë të malit të Moravës, në krahun perëndimor të tij. Fshati shtrihet midis lartësive 970- 1040 m lmd. Mborja gjendet rreth 3 km nga qendra e qytetit të Korçës. Fshatrat kufizues janë Barçi në V dhe Drenova në J.. Në lindje fshati kufizohet me malin e Shëndëllisë (1365m) malin e Qytetit (1326.5m) dhe malin e Thanasit (1401.6m). Në perëndim fshati zgjerohet në drejtim të fushës së Korçës.



Fig.17. Imazh satelitor i fshatit Mborje, 2025

Territori ndërtohet nga sekuença mantelike kryesisht harcburgitike me ndërthurje të rralla të dunitëve në pjesën e sipërme të Jurasikut të mesëm; argjila, ranorë, konglomeratë e qymyre të Oligocenit të Mesëm dhe ranorë masivë, argjila me shtresa qymyresh e ranorësh të Oligocenit të Sipërm. Përbërja gjeologjike ka mundësuar praninë e mineralit të qymyrgurit. Pellgu qymyrmbytës është shfrytëzuar deri në masën 80% përgjatë viteve 1945-1992. Aktualisht miniera e Mborjes është e mbyllur dhe e rënuar. Relievi është kodrinor me pjerrësi në drejtim të perëndimit. Rrjedhja ujore sipërfaqësore ndjek drejtimin lindje-perëndim. Në veri të fshatit kalon përroi i Qytetit, i cili mbledh ujrën e rreshjeve të shiut dhe shkrirjes së dëborës në shpatet perëndimore të vargut të Moravës. Në fshat gjenden disa burime të vogla uji të pijshëm me emërtime si: çezma e Banës, çezma e Kordhelit, çezma e Gjergos dhe Goja e Ariut. Furnizimi me ujë i fshatit bëhet nga mbledhja në depo të ujrave të çezmës së Gjergos, burimet e Xhaxhos, burimet e Rakitës në malin e Shëndëllisë. Klima e Mborjes është mesdhetare paramalore, me dimër të ftohtë e verë të freskët. Bimësia i përket brezit të dushqeve dhe ahishtave. Në brendësi të maleve gjenden pyje me pisha, plepa, lajthi, ku gjenden kafshë të egra si: lepuri i egër, ujku, ariu i murrmë, sorkadhja, dhelpra etj.

Fshati Mborje është studiuar si një vendbanim i lashtë mesjetar. Origjina e emrit "Mborje" është menduar se rrjedh nga fjala "Enborja=treg nga greqishtja", pasi ky vendbanim njihej për tregëti (shitje dhe blerje) të mallrave të ndryshme. Së bashku me kishën dhe vendbanimet kanë përbërë qytetin që ndodhej në rrëzë të kodrës. Një nga vendbanimet më të hershme të territorin të Mborjes është maja e malit të Qytetit, ku gjenden rrënojat e një fortifikimi paraqytetar ilir. Në studime historike dëshmohet se përmasat e vogla të kështjellës janë dëshmi e një selie të një feudali vendas. Vazhdimësia e Mborjes vërtetohet edhe me kishën e vogël bizantine të Metamorfozës së Shpëtimarit (Ristozit) e ndërtuar më 898. Kisha e Ristozit ka afreske

dhe ikanë të realizuar nga piktorë anonimë më 1390. Është në listën e monumenteve të kultures shqiptare.

Kalaja e Mborjes ndodhet mbi një rën nga majat e malit të Moravës, që njihet me toponimin “Maja e Qytetit”, e cila lartësohet mbi fshatin Mborje. Në anën jugperëndimore, kalaja kufizohet me vendin e quajtur “Shën Thanas”, ndërsa në anën juglindore nga lumi i Mborjes. Ajo ka formë eliptike me përmasa rreth 60 x 40 m. Sipas materialeve të gjetura aty, kalaja datohet në periudhën në Mesjetën e Hershme (shek. VI-XII) (Karaïskaj, 1981). Nga vëzhgimi në terren ruhen disa grumbuj gurësh dhe vetëm një pjesë e mureve të kalasë. Kalaja e Mborjes është shpallur monument kulture me vendim të Institutit të Shkencave në vitin 1948 dhe Ministria e Arsimit dhe Kulturës në vitin 1973. Rreth viteve 1450 Mborja ishte pjesë e vilajetit të Korçës dhe kishte rreth 70 shtëpi.

Të dhënat e para për numrin e popullsisë së Mborjes i përkasin shek. XVI. Ndër vite numri i popullsisë ka qënë në rritje: 142 b. (v. 1520), 320 b. (v. 1800), 1116 b. (v. 1900), 1278 b. (v. 1912), 1083 b. (v. 1920), 1764 b. (v. 1944), 4530 b. (v. 2005), 3095 b. (v. 2011) dhe 3095 b. (v. 2016). Raporti meshkuj-femra është 1853 me 1307. Mborja është përfshirë nga lëvizjet e mëdha hapësinore. Emigrimet janë kombëtare, drejt Tiranës dhe ndërkombëtare, drejt Greqisë, Italisë, Gjermanisë, SHBA-së etj. Imigrantët në Mborje i përkasin fshatrave të thellë të malësisë së Voskopojës, Mokrës, Oparit etj. Në Mborje dominojnë banorët me besim mysliman, krahas banorëve me besim ortodoks dhe katolik. Harmonia fetare tregohet me praninë e xhamisë së Mborjes dhe kishës e Ristozit brenda fshatit dhe vizitat në insititucionet pa dallime fetare.

Kisha e Ristozit në Mborje, është ndërtuar në fshatin Mborje në juglindje të qytetit të Korçës. Në arkitekturën e saj kisha paraqitet mjaft kompakte, ndërsa muratura e kishës është e përbërë nga gurë të papunuar, me copëra tjegullash të vendosura njëra mbi tjetrën ndërmjet gurëve, po jo gjithandej.

**Foto 35. Kisha e Ristozit****Foto 36. Kisha e Shën Gjergjit Mborje**

Sipas burimeve të shkruara mendohet që kisha të jetë ndërtuar dhe pikturuar në vitin 1389. Muret janë të pikturuara me afreske që paraqesin skena biblike dhe shenjësorësh. Vizitohet nga vizitorë vendas, por edhe nga turistë të huaj. Me kishën e Ristozit lidhet edhe festa fetare që festohet dyzet ditë pas pashkëve. Është shpallur monument kulture në vitin 1948 dhe është restauruar vitet e fundit.

**Foto.37. Pamje të kullotave të bagëtive të imta në tokat e fshatit Mborje, 2025**

Në aspektin organizativ fshati paraqitet i shtrirë, me rrugë paralele që kryëzohen duke formuar parçela shtëpish. Fshati ka një qendër ku

gjendet zyra, xhamia dhe ambulanca. Shtëpitë janë private, njëkatëshe dhe dykatëshe, murre guri ose tulle. Shtëpitë mund të jenë të veçuara ose të ngjitura me njëra-tjetrën. Në brendësi të avllive të shtëpive gjendet hashefi, pleviçat, ahurët etj. Shtëpitë e reja janë 2-3 katëshe dhe me artitekturë moderne. Në oborret e shtëpive gjenden vreshta rrushi, të përdorur për prodhim e rakisë, për konsum familjar. Aktivitetet ekonomike më të njohura ndër vite të Mborjes janë: sharrat, mobilieritë, teneqexhinjtë, dhe artizanatet. Veprimtaria ekonomike lidhet me sipërfaqet pyjore në brendësi të malit të Moravës dhe kryesisht me pyllin e Bozdoveçit. Pylltaria dhe gjuetia janë dy prej traditave të fshatit. Në ditët e sotme ofrohen shërbime në 5 dyqane, 2 mobileri, 1 sharrë, 4 parukeri, 1 berberanë, 1 furrë buke, 3 rrobaqepsi, 2 restorante dhe disa bar-kafe. Shërbimi arsimor ofrohet në shkollën 9-vjeçare "Haki Mborja", të hapur për herë të parë në 12 dhjetor 1917. Shkolla është rikonstruktuar në vitin 2017 dhe ofron shërbim për rreth 150 nxënës. Shërbimi shëndetësor ofrohet në ambulancën e fshatit nga një mjek familje dhe tri infermierë. Pjesë e trashëgimisë kulturore të fshatit janë personalitetet me rëndësi kombëtare si: Haki Mborja (patriot dhe luftëtar), Selaudin Mborja (mjek dhe profesor), Sali Mborja, Hekuran Mara (akademik) dhe Petrika Thëngjilli (historian).

2.3.4 DARDHË

Vendbanim rural në njësinë administrative Drenovë. Gjendet në koordinatat gjeografike: 40° 31' 08'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 49' 37'' gjatësi gjeografike lindore; në pjesën jugore të vargut malor lindor të Moravës; në shpatin lindor të majës së Gurrit të Vreshtës; midis lartësive 1245-1365 m mbi nivelin e detit; midis Gurit të Vreshtës, Korijes së Lenës (Liseci), Pyllit të Suarës dhe Gurit të Rahut (mali i Shën Pjetrit); rreth 18 km larg qytetit të Korçës. Fshatrat më të afërt janë: Sinica, Arrëza, Nikolica dhe Boboshtica.

Territori i Dardhës përbëhet nga depozitime terrigjene të oligocenit të mesëm (Pg₂³) dhe molasa neogjenike, të përfaqësuara nga

konglomeratë e ranorë, argjila dhe mergele. Në përgjithësi konglomeratet dhe ranorët janë të çimentur dhe mjaft të fortë. Relievi i ndërtuar prej tyre dallohet për kontraste morfologjike dhe shpate të thepisura (Guri i Vreshtës etj). Në disa raste, në brendësi të tyre takohen shtresa e thjerza ranore, argjilore e mergelore. Kjo ka kushtëzuar rezistencë jo të njëjtë ndaj erozionit e korrozionit, të cilët kanë krijuar mikroforma interesante të relievit, jo rrallë të çuditshme, në trajtën e shtyllave, kërpudhave etj. Atje ku dalin argjilat në sipërfaqe morfologjia e relievit është më e butë, më e copëtuar dhe me forma të shumta erozive.



Fig.18. Imazh satelitor i fshatit Dardhë, 2025

Relievi i tij është kryesisht malor, me kurrize e maja me forma të rrumbullakosura dhe shpate me pjerrësi të ndryshme, deri të thepisura si dhe lugina të thella, të përshkuara nga përrenj, që i takojnë pellgut ujëmbledhës të lumit Devoll. Midis kurrizeve malore dallohen: Guri i Vreshtës (1525 m), konglomeratik, që ngrihet me shpate shumë të thepisura, duke dominuar gjithë peizazhin e fshatit; kurrizi Korijsa e Lenës (Liseci, 1731m), Pylli i Suarës dhe Guri i Rahut (mali i Shën Pjetrit, 1480 m), të cilët kanë morfologji të ngjajshme me kurrizin e Gurrit të Vreshtës. Fshati i Dardhës është vendosur midis tyre, në

zgjerimin në trajtën e gropës, të krijuar nga bashkimi i disa degëve të përroit homonim. Morfologjia e luginave ndryshon në funksion të përbërjes gjeologjike, të ngushta deri në trajtën e grykës, kur përshkojnë konglomeratet e ranorët, ndërsa kur zhvillohen në argjila ato janë të gjera, me shpate pak të pjerrët dhe me forma erozive. Shtrati i rrjedhjeve të sipërme të përroit dhe degëve të tij është i ngushtë, ka pjerrësi të madhe dhe pragje. Pas bashkimit të tyre dhe deri sa derdhet në Devoll, zvogëlohet pjerrësia e shtrtitit e zgjerohet; shfaqen mbetje të vogla të nivelit të parë e të dytë tarracave lumore, në shpinën e të cilave janë vendosur banesa dhe toka të punueshme, ndërsa në frontet e tarracave dalin burime të vogla uji, disa të përkohshme.

Klima, tipike mesdhetare malore, dallohet për verën e shkurtër e të freskët dhe dimrin e gjatë e të ftohtë. Temperatura mesatare vjetore mer vlerat 8.3°C , e janarit -1.1°C , e gushtit 17.8°C dhe amplituda midis këtyre vlerave mesatare 18.9°C , ndërsa vlerat skajore ndryshojnë nga -21.8°C (14.01.1968) në 34.2°C (26.07.1965), amplituda midis këtyre skajeve arrin 56.0°C . Mesatarisht takohen rreth 105 ditë në vit me temperaturë minimale negative dhe rreth 19 ditë me temperaturë maksimale të barabartë ose më të lartë se 25°C .

Reshjet mesatare vjetore arrijnë 1032 mm, të pëqendruara kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitin (mbi 60 % të reshjeve vjetore); në vjeshtë bien rreth 33%, në dimër rreth 30 %, në pranverë rreth 24 % dhe në verë rreth 13 % të tyre. Mesatarisht takohen rreth 117 ditë me reshje në vit, më të shumta në vjeshtë dhe në dimër. Muaji me reshje mesatare më të pakta është gushti (rreth 35 mm) dhe me reshje mesatare më të shumta nëntori (rreth 151 mm). Dëbora takohet për vit, por ditët me dëborë dhe me shtresë dëborë ndryshojnë nga nga njeri vit në tjetrin. Zakonisht ajo shfaqet nga fundi i nëntorit deri në fund të marsit, por edhe më parë e më von. Të dhënat tregojnë se trashësia maksimale e trashësisë së shtresë së dëborës ka arritur 136 cm (1954). Me këtë dëborë jo të pakët lidhet tradita e skijimit të dardharëve. Ajo përbën një potencial të madh për zhvillimin e turizmit të bardhë.

Territori i fshatit Dardhë është i pasur me burime ujore, që dalin në kontaktin midis shtresave ranore e konglomerate të përshkueshme me shtresat argjilore të papërshkueshme. Sipas disa dëshmive, Dardha ka pasur rreth 100 burime. Midis tyre dallohen: Uji i Qelbur, burimi i Kiço Telës, i Izvorit, Kroi i Kovaçit, i Dardhës (Fshatit), i Dembelit², Kolovanos, Nokes, Katarakti (Ujëvara) midis Dardhës dhe Sinicës, tepër i vizituar nga turistët; i Vishnjës etj. Ujëti e këtyre burimeve përfundon në përroi të Dardhës. Uji i Qelbur veçohet për përmbajtjen e squfurit, me të cilin lidhet era e vezës së prishur dhe emërtimi. Për vlerat kurative, ky burim është përdorur dhe përdoret në mënyrë empirike për kurimin e sistemit gastrointestinal.

Fshati përshkohet nga *përroi i Dardhës*, me disa degë, të cilat zenë fill në qafat (Bigllës) dhe bashkohen tek fshati ose afër tij në një rrjedhje të vetme, që derdhet në Devoll. Furnizohet me ujë nga reshjet e shiut e shkrirja e dëborës si dhe nga burimet e shumta, të cilat sigurojnë që, edhe pse gjatë verës rrjedhja zvogëlohet shumë, përroi të mos thahet plotësisht. Prurjet maksimale takohen në periudhën e lagët të vitit dhe sidomos kur shirat shoqërohen me shkrirjen e shpejtë të dëborës. Gjatë kësaj kohe, rritet erozioni, sidomos në sektorët terrigjenë, dhe prurja e ngurtë. Përdoret për ujitjen e perimeve. Por mund të kthehet edhe në një atrakion turistik.

Më të përhapura janë *tokat e murrmet pyjore*, të cilat zhvillohen mbi 1000 m lartësi, në shkëmbinj terrigjenë, në reliev të copëtuar, klimë mesdhetare paramalore dhe mesdhetare malore të lagët e të ftohtë, me dimër të ashpër, me ngrica e borë e verë të freskët, me reshje të konsiderueshme, që kushtëzojnë regjimin shpërlarës të tokave; nën pyjet e ahut e të halorëve. Zakonisht përmbajnë 8-14 % humus në sipërfaqe, ndërsa në thellësinë nën 60 cm rreth 1%. Profili i këtyre tokave, 80-140 cm i trashë, përbëhet nga një shtresë e hollë (A_0) mbetjesh organike, me ngjyrë të zezë dhe trashësi deri në rreth 5 cm; nga horizonti humusor, me trashësi deri në 30 cm, me ngjyrë të

² Quhet kështu sepse del në rreth 1.6 m lartësi, ku mund të pine ujë pa mundim edhe dembelët.

murrme të errët ose kafe dhe horizonti B, me ngjyrë të murrme të zverdhur. Tokat e punueshme (arat) kanë sipërfaqe shumë të vogla dhe të shpërndara në shpatet me pjerrësi më të vogël, apo, si u tha, në shpinë të tarracave natyrore ose artificiale.

Në brendësi dhe në rrethinat e fshatit shfaqet kati i ahut dhe i halorëve, ku gjenden pyje gjetherënëse dhe me gjelbërim të përhershëm: bredhi (*Abies*), plepli i egër (*Populus tremula*), bliri (*Tilia cordata*), mështeka (*Betula alba*) etj. Dallohet Bredhi i Vishnjës ose bredhi i bardhë (*Abies alba*), i cili, për moshën mbi 120 vjecare, lartësinë mbi 30 m dhe diametrin e trungur rreth 125 cm është shpallur biomonument natyre.



Foto .38. Pamje nga peizazhi pyjor i fshatit Dardhë

Shkurret përfaqësohen nga lajthia (*Corylus avellana*), dëllinja (*Juniperus oxycedrus* dhe *nana*), kullumbria (*Prunis spinosa* L), trëndafili i egër (*Rosa mollis*, *R. Glutinosa*), murrizi (*Crataegus* L) etj. Bimët aromatike dhe mjekësore, si: çaji i malit (*Sideritis montana* L), dredhëzat (*Fragaria vesca*), rigoni (*Origanum vulgare*), salepi (*Orchis mascula*), aguliçja (*Cichorium intybus*), trëndafili i egër etj gjejnë përdorim në mjekësinë popullore. Territoret e fshatit mbrohen në

kategorinë e V-të Zonave të Mbrojtura “Peizazhi Natyror Bredhi i Drenovës-Sinicë”.

Sipas disa të dhënave, si datë e themelimit të Dardhës mbahet 16 gusht 1624. Emërtimi “Dardhë”, sipas gojëdhënave, lidhet me një dardhë të madhe të egër (goricë). Barinjtë, që kishin ndërtuar një stan nën këtë dardhë, përdornin togfjalëshin “N’ dardhë = nën dardhë”, i cili, me kalimin e kohës, mori trajtën e sotme, Dardhë. Sipas gojëdhënave fshati Dardhë është krijuar si vendbanim nga të larguarit e fshatrave Arrëz, Nikolicë, Çetë, Drenovë, Hoçisht, Vithkuq, etj, në periudhën e pushtimit sllav dhe osman; prej të ardhurve nga Kruja, Kosova, Çamëria (Filati) dhe deri nga krahinat e largëta shqiptare, si Suli, të cilëu vendosën në Dardhë në fillim të shekullit XIX, pas rënies së Sulit dhe dëbimit të popullsisë nga Ali Pashë Tepelena. Fiset e dëgjuara suliotë Boçari, Stefani, Sulioti, Thimo edhe sot kanë trashëgimtarët e tyre që jetojnë në Dardhë.



Foto 39, 40. Pamje nga fshati Dardhë

Nga fundi i shek. XIX u vendosën në Dardhë disa familje zejtare të ardhur nga zona e Filatit.

Deri tani, si dëshmi e parë historike e shkruar për Dardhën, njihet Enciklopedia Greke “Pirsos” ku thuhet: “Si fshat i lirë, Dardha, fshat shqiptar, ishte i përjashtuar nga taksat. Ndaj, në dokumentet osmane nuk ka të dhëna për këtë fshat”. Po sipas kësaj enciklopedie, e folmja e fshatit Dardhë ka ruajtur deri vonë disa trajta të vjetra të gjuhës shqipe

të ngjashme me arbërishten dhe dialektin çam. Kjo dukuri vërehet edhe në disa toponime me karakter konservativ, si: Bredhi i Klishës (bredhi i dikurshëm afë qendrës së fshatit), Oborri i Klishës, Trojet e Ulkut (Ujkut), Trojet e Sidherit etj.

Kushtet natyrore të ashpra, vështirësitë ekonomike, jeta e izoluar midis maleve, larg qendrave urbane dhe mungesa e shërbimeve, i detyroi dardharët ta gjejnë punën aty ku kërkohej krahu i tyre, larg vendbanimit, larg familjeve, duke nxitur, qysh herët, emigrimin e madh brenda vendit, por sidomos jashtë tij. Në një Shqipëri të mbyllur, dardharët kanë qenë ndër mërgimtarët e parë. Profesionit i parë i dardharëve duket se ka qenë ai i druvarit. Me mjetet e punës-sopata e sharra të druvarit, “me karvane prej 20-30 vetash, me mushka, të armatosur, u nisën fillimisht drejt pyjeve të zonave greke, atëherë ende nën Turqinë. Që nga viti 1800 deri në 1935, në Olimp punonin ende sharrat e dardharëve me ujë, që ishte teknika më e mirë e kohës. Më von, ata u shtrinë në malet e Selitit e të Athosit, në Mesollongjo e Demir-Kapi, në Anodoll, në Rruse, në Isekum, në malet e Rodopit në Bullgari e deri në skelën e Varnës, ku bënë tregtinë e qerestesë. Kudu ku punuan, dardharët u cilësuan si druvarë të zotë, aq sa mbeti edhe shprehja e njohur “Ja pret me sopatën e dardharit”. Pas këtij emigrimi sezonal, që e mbante fshatin të populluar, dardharët “zbuluan” Amerikën. Gati të gjitha familjet dardhare kishin një emigrant në kontinentin e largët. Përvoja, mendësitë e reja për një jetë shpirtërore e materiale perndimore dhe të ardhurat e siguruar nga ky migracion ndihmuan në zhvillimin ekonomik, social e kulturor, në emancipimin e gjithë fshatit, që e rezatonte atë përreth.

Ndër shekuj ka pasur periudha të lulëzimit ekonomik, kulturor dhe demografik. Ndër vite popullsia e fshatit ka qenë: 160 b (v.1624), 820 b (v.1768), 1454 b (v. 1839), 1023 b. (v.1900), 1014 b (1927), 500 b (v. 1937), 250 b (v. 1942), 150 b (v. 1968), 141 b (v. 1990), 173 b (2005), 100 b (v.2016), 15 b (2024).

Në dhjetvjeçarët e parë të shekullit të XX, Dardha shënoi zhvillim të dukshëm: kishte rreth 500 shtëpi (1913); shkolla greke, e hapur në vitin

1769, falë prirjes arsimdashëse të dardharëve, në vitin 1917, u zëvendësua me shkollë shqipe, që shënon fillimin e arsimit shqip në këtë fshat; emigrantët ndërtuan më 1924 shkollën më të madhe e më moderne të asaj kohe, në e kthyer në muze vitet e fundit, ku shpaloset historia e fshatit. Gjithashtu emigrantët ndërtuan rrugën automobilistike Dardhë-Boboshticë, që e lidhi me Korçën; sollën makinat, që përdorshin si taksi në linjën Korçë-Dardhë; rikonstruktuan, së bashku me banorët, kalldrëmin e rrugëve brenda fshatit, ujësjellësin e fshatit, krojet e çezmat; ndërtuan hidrocentralin, që furnizonte me energji elektrike Dardhën; mirëmbajtën objektet e kultit ortodoks. Fshati i përket besimit ortodoks. Gjenden 3 kisha (kisha e Shën Thanasit, kisha e Shën Gjergjit dhe kisha e Shën Pjetrit). Qysh në këtë kohë u shfaq interesi turistik për vlerat e mëdha natyrore dhe kulturore të Dardhës; në vitin 1938, botohet Guida e parë turistike e Dardhës.



Foto 41. Kisha e Shën Gjergjit, Foto.42. Kisha e Shën Pjetrit, Dardhë, 2025

Fshati zë një sipërfaqe prej 22 ha. Ai është i tipit të përqendruar. Ka një qendër, ku gjendet një shesh i vogël, kisha dhe muzeu. Urbanistika dhe planimetria e fshatit, rregullsia e ndërtimeve, arkitektura interesante e banesave solide të bukura, një, dy ose tri katëshe, prej guri të gdhendur dhe të mbuluara me plloça të hirta guri, me oborre plot me lule dhe porta të zbukuruara me motive artistike; rrugët e pastërta të shtruara bukur me kalldrëm, krojet e shumta, punishtet e zejeve kryesore, njësitë

tregtare etj, deri në fillim të viteve '40 të shekullit të kaluar, i jepnin fshatit pamjen e një qyteze të lulëzuar, të stilit european. Këto vlera mirëmbahen me kujdesi, duke ruajtur identitetin kulturor të zonës.

Në fund të shek XX dhe gjatë dekadave të para të shek. XXI në Dardhë mori përparësi turizmi, i lidhur me prioritete natyrore, sociale dhe ekonomike: pozicioni i saj shumë afër Korçës, që ishte qendra më e madhe urbane në rajon dhe ndër më të mëdha në vend; zona e mbrojtur e Pezazhit të mbrojtur Bredhi i Drenovës-Sinicë dhe monumentet e afërta të natyrës (Bredhi i Vishnjës, Guri i Capit, Ahishtia e Bradvicës dhe Shënkostandinit) ofrojnë resurse të shumta turistike, që duhen njohur, menaxhuar shkencërisht për qëllime turistike, shkencore, etj.

Në rajonin e Korçës dhe në gjithë Shqipërinë, Dardha, krahas këtyre potencialeve të mëdha turistike natyrore, dallohet edhe për ofertën e larmishme turistike të kulturës së pasur tradicionale etnografike, ku dallohen kostumi i grave dardhare (xibuni), një prej perlave të kostumografisë shqiptare, që qepej në Dardhë dhe kostumet tradicionale të burrave (fustanella, kallat, opingat me xhufka të zeza në majë të tyre dhe fesin me ngjyrë të bardhë në kokë).

Që nga viti 1800 Dardha është përmendur për punimin e drurit, shajakut e kostumeve të bukura; për bujqësinë, sidomos për kultivimin e perimeve, blegtorinë, prodhimin e mjaltit dhe shfrytëzimin e pyjeve. Qysh nga dhjetvjeçarët e parë të shekullit të kaluar dhe sidomos pas vitit 1990 ekonomia u orientura në turizëm, më tepër familjar. Në fshat ka një numër të konsiderueshëm bujtinash dhe tavernash tradicionale; shtëpia e dikurshme e pushimit (kampi i punëtorëve i periudhës komuniste) u kthye në hotel, të cilit iu shtuan edhe disa hotele të tjerë dhe shtëpi pritëse. Fshati është pjesë e 100 fshatrave turistike të Shqipërisë. Në Dardhë, krahas llojeve të tjera të turizmit (malor, i gjelbër, rural e kulturor, sportiv dhe gastronomik), po zhvillohet me sukses turizmi i bardhë.

Gjatë viteve 2000, Dardha u kthye në qendër turistike dhe destinacion për turistët që duan të ushtrojnë aktivitete në natyrë, si: skijim, ecje, alpinizëm e turizëm malor dhe të shijojnë ushqime bio, tradicionale të

zonës dhe të freskëta, të prodhuara nga banorët e fshatit. Dallohet lakrori i famshëm i pjekur në saç, rakia e kumbullës së egër e zierë dy here, me shije të veçantë etj.

Dardha është e njohur edhe për figurat e shquara, me kontribute të mëdha për vendin dhe kombin tonë. Dallohet një plejadë e tërë piktorësh dardharë, me trashëgimi të vyer, që fillon me vëllezrit Kostandini e Athanas Zografi dhe me Nikolla Zengon të shek. XVIII dhe vazhdon me piktorë të familjejes Zengo deri në ditët tona, Androniqi e Sofia Zengo. Nga Dardha janë edhe figura të tjera të shquara, si: Sotir Peci, matematicien, politikan dhe publicist; Thomas Nassi, muzikant, Teodor Laço, shkrimtar, politikan, diplomat, etj.

Në do jetë o derëbardhë/Gjak në rrembat e shëndet/

Mere rrugën shko në Dardhë/ Ku ndjen gas me të vërtet.

Në vitin 2024 popullsia e përhershme, për shkak të migrimit të madh brenda dhe jashtë vendit, ra në 15 banorë, kryesisht mbi 65 vjeçarë. Mungojnë lindjet, ka 1 ose 2 vdekje në vit. Mungon shërbimi arsimor, ndërsa shërbimi shëndetësor ofrohet në një ambulancë. Janë jo të paktë dardharët dhe të tjerë nga rajone të ndryshme të vendit, kryesisht nga Tirana, që rikonstruktuan shtëpitë e prindërve apo kanë blerë vila në fshat, të cilat i përdorin për pushime dimërore dhe verore.

2.3.5. BOBOSHTICË

Fshat kodrinor në Nj.A. Drenovë. Gjendet në koordinatat gjeografike: 40° 33' 10'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 45' 51'' gjatësi gjeografike lindore; midis fushës së Korçës dhe pjesës perëndimore të vargut malor të Moravës, midis lartësive 928 -993 m mbi nivelin e detit. Fshati gjendet në të majtë të rrugës nacionale Korrcë- Ersekë, rreth 7.3 km nga qyteti i Korçës. Territori i Boboshticës përbëhet nga depozitime të përziera aluviale-proluviale, të përfaqësuara nga rëra, zhavorre dhe alevritë të periudhës Pleistocen-Holocen dhe depozitive deluvionale-koluvionale të Pleistocenit. Fshati është i vendosur në një territor të pjerrët me kontraste të vogla të relievit, në pjerrësi të vogël në drejtim

të fushës së Korçës. Relievi është kryesisht i butë, me çoptim të vogël dhe forma erozionale të shfaqura në jug të fshatit. Fshati Boboshticës është i vendosur në depozitimet e ardhura nga mali i Moravës, midis luginës së përroit të Sharrë dhe përroit të Boboshticës. Klima është paramalore me dimër të ftohtë dhe verë të freskët.



Fig. 19. Imazh satelitor i fshatit Boboshticë, 2025

Territori është i pasur me burime ujore, të cilat marrin emertime, si: Milovi, Koka, Turçka, Cifka, Greçka dhe Koka e Çezmave, të cilat përdoren si ujë të pijshëm në fshat. Ujërat e burimeve derdhen në përrenjtë e fshatit, të cilët përfundojnë në lumin e Dunaveçit, degë e lumit Devoll. Tokat janë të kafenjta me trashësi të tokës mesatarisht 150 cm, me pH ujqor 7.7, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 1.89 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,24%; azoti i përgjithshëm mes. 0.26%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 2.3 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes. 15 mg. Tokat ara janë të shpërndara përreth zonës së banuar dhe të rregulluara në formën e parcelave.



Fig. 43. 44. Pamje të fshatit dhe të një banese në fshatin Boboshticë, 2025

Përreth fshatit gjenden bimë të katit të dushqeve dhe ahut, të shprehura në lajthi, plepi i egër (*Populus tremula*), trëndafili i egër (*rosa mollis*, *R. Glutinosa*), murizi (*Crataegus L.*) etj. Bimët aromatike dhe medicinale të pranishme janë: luledele, rigoni, salepi, dëllinja etj.

Fshati Boboshticë ka një histori të gjatë të popullimit. Sipas gojëdhënave territori përreth Boboshticës ka qënë i zënë me pyje të pishës. Banorët e parë kanë qënë sharrëxhinjtë, të cilët ngritën sharat për të bërrë dërrasa. Emri i fshatit rrjedh nga bobo+shtica= habi +dërrasa (nga sllavishtja), që nënkupton një habi e madhe për sasinë e madhe të dërrasave të prera në fshat. Boboshtica filloi në popullohej dalëngadalë nga popullsia shqiptare dhe të ardhur vllhë (arumunë). Sipas regjistrave osmanë të vitit 1450 Boboshtica kishte 80 shtëpi, 200 mana, 50 arra dhe 1 vreshtë.

Të dhënat e para për numrin e popullsisë i përkasin v. 1870 me 1004 b.. Ndër vite numri i popullsisë ka ndryshuar, herë në rënie dhe herë në zbritje, si: 1179 b. (v.1900), 1177 b. (v. 1920), 675 b. (v. 1945), 1125 b. (v. 1950), 1145 b. (v. 1979), 1466 b. (v.2016). Në vitet e fundit ka rënie të numrit të popullsisë për shkak të emigrimit brenda Shqipërisë dhe emigrimit ndërkombëtar drejt Greqisë, Amerikës, Gjermanisë etj. Numri i familjeve është 363.

Emigrimi dhe kultura e sjellë prej vendeve të punës ka sjellë ndryshime në artitekturën e ndërtimeve të fshatit. Banesat prej guri, një ose dy katëshe të ndërtuara nga mjeshtërit e fshatit ndër vite janë shndëruar në

shtëpi moderne me materiale të reja. Shtëpitë e ngjitura pranë njëra - tjetrës janë zëvendësuar me shtëpi të ndara, me oborre të rrethuara me mure guri ose me gardhe. Mungojnë shtëpitë dykatëshe të shtruara me pllloça në korridore, të lidhura me shkallët e drunjta e me parmak anash. Në disa lagje të fshatit ruhen ende kalldrëmet. Një pjesë e mirë e rrugëve janë të asfaltuara. Fshati ka një rrugë kryesore që lidhet me qytetin e Korçës, që shkon drejt e në qendër të fshatit. Rrugët brenda fshatit kanë drejtime të ndryshme, duke formuar blloqe banimi në formë trekëndore apo forma të tjera të ç'rregullta. Në Boboshtiçë njihen disa lagje, si: Popçishtja, Celkovjana, Cingërmadha, Mbracko dhe Bunari. Në fshat banorët janë të besimit ortodoks. Fshati është me kisha të ndërtuara që në shekullin XII-të. Një nga kishat më të vjetra, e ndodhur në perëndim të fshatit, është Manastiri i Shënkollit të Boboshtiçës, i ndërtuar më 1450. Kisha e Shën Mërisë e dëmtuar në periudhën e sistemit komunist, por e rindërtuar pas 1990-s. Pranë kishës së re ndodhet edhe një manastir. Kisha gjendet në jug të Boboshtiçës. Kisha të tjera janë: Shën Kolli ndërtuar më 1915-n, Shën Dhimitri, Shën Jovani, Shën Ilia dhe Satrivaçi e ndërtuar mbas vitit 1990.

Kisha e Shën Jovanit (Boboshticë) Korçë, dallohet për pamjen e jashtme të ndërtimit të saj dhe vlerat artistike të veçanta në mjediset e brendshme, ku të bien në sy muret e veshura me piktura murale. Nisur nga teknika dhe materialet e ndërtimit, studiuesit mendojnë se kisha daton në gjysmën e dytë të shek.XIV.

Boboshtiça ka një shkollë, por nuk është më funksionale. Fëmijët e Boboshtiçës ndjekin shkollat publike të qytetit të Korçës ose shkollën jopublike "Omios" në rrugën nacionale Korçë-Ersekë. Në fshati gjendet një qendër e vogël shëndetsore, në të cilën ofrojnë shërbim një mjek dhe një infermier. Afëria me qytetin e Korçës mundëson plotësimin e shërbimeve shëndetsore, arsimore dhe kulturore të banorëve të Boboshticës.

Boboshtica është një fshat me ku zhvillohen të tri sektorët e parë të ekonomisë. Kultura kryesore bujqësore e fshatit është mani (*Morus*

alba), frutet dhe gjethet e të çilit përdoren për prodhimin e rakisë së manit. Pemët shumëvjeçare të manit gjenden në oborret e shtëpive të fshatit. Tokat arrë kultivohen me drithëra dhe perime për përdorim familjar. Pemtaria zhvillohet me kultivimin e mollës, dardhës, qershisë, kumbullës dhe vreshtave. Blegtoria zhvillohet në formën e fermave. Në Boboshticë gjenden 2 ferma lopësh, një fermë delesh dhe një pulari me tregëtim të nënprodukteve të qumështit, mishit dhe vezëve në nivel rajonal dhe kombëtar. Industria agropërpunuese përfaqësohet me dy baxho dhe një punishte mishi. Sektori i tretë ose sektori i shërbimeve ofrohet në rreth 7 restorante dhe 3 hotele. Gatimet tradicionale si: lakrorët me dy petë, rakia e manit, rosniçat, trahanatë dhe mishi i furrës janë atraksionet turistike të fshatit Boboshticë. Fshati Boboshticë feston Shën Mërinë në 15 gusht të çdo viti, duke mbledhur boboshticarë nga emigrimi dhe fshati.

2.3.6. QATROM

Qatromi është pjesë e Nj.A. Drenovë. Gjendet në koordinatat gjeografike: 40° 35' 07'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 44' 44'' gjatësi gjeografike lindore; në fushëgropën e Korçës, në lartësinë 846m mbi nivelin e detit; në të djathtë të rrugës nacionale Korçë- Ersekë, rreth 6.5 km nga qyteti i Korçës. Kufizohet nga fshatin Polenë në P., fshatin Ravonik në V., Drenovë në L. dhe Mollaj në J.

Fshati është ndërtuar mbi depozitime aluviale (rëra, alevrite, zhavore) të holocenit (Q_h) dhe depozitime aluviale-proluviale të pleistocen-holocenit (Q_{p-h}). Këto depozitime kanë krijuar një reliev tërësisht fushor, me një pjerrësi shumë të vogël në drejtim të veriut.

Klima është mesdhetare paramalore. Dimri është i ftohtë dhe me ngrica, ndërsa vera është e freskët dhe e thatë. Fshati është i ekspozuar ndaj erërave të të gjitha drejtimeve. Rreshjet e dëborët bien gjatë

periudhës së dimrit dhe zgjasin deri në 20 ditë. Rreshjet në formë shiu konsiderohen në vlera të ulëta.



Fig. 20. Imazh satelitor i fshatit Qatrom, 2025

Qatroni është pjesë e pellgut ujëmbledhës të lumit Devoll, ujërat sipërfaqësore të së cilit përfundojnë në Dunavec (degë e majtë e l. Devoll). Në verilindje të fshatit kalon një kanal ujqor që përdoret edhe për ujëtimin e tokave bujqësore. Në territorin e fshatit mungojnë burimet ujore. Furnizimi me ujë të pijshëm sigurohet nga malësia e Vithkuqit, nëpërmjet tubacioneve. Tokat janë të brezit të kafentë, me trashësi të tokës mesatarisht 138 cm, me pH ujqor 7.8, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 1.89 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,24%; azoti i përgjithshëm mes. 0.112%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 1.33 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes.17 mg. Tokat gjejnë përdorim si toka të punueshme. Sipërfaqe të vogla të tokave zihen nga bimësia natyrore e brezit të dushqeve.

Sipas gojëdhënave emri i fshatit rrjedh nga emri “Qatip” e më pas Qatrom. Mendohet se fshat fillimisht ishte krijuar në zonën e Zapeve (territori midis fshatit Drenovë dhe Boboshticës) dhe më pas popullsia është zhvendosur në territorin ku ndodhet tashmë. Rreth viteve 1900

në fshat kishte rreth 284 banorë në 48 familje. Mbas vitit 1945 në fshat pati të ardhur fshatrat e malësisë së Vithkuqit dhe Kolonjës. Gjatë periudhës së sistemit komunist popullsia e fshatit pothuajse u 3-fishua. Familjet më të njohura janë Kocibelli dhe Nasto. Banorët ishin të punësuar në bujqësi dhe blektori. Qatromi ishte pjesë e kooperativës së Drenovës. Tokat arrë kultivoheshin me foragjere. Mbas vitit 1990, ndryshimet politike sollën ndryshime në ekonomi, zhvillimin social dhe kultur të fshatit. Fshat është karakterizuar nga emigrimi kombëtar dhe ndërkombëtar. Të rinjtë e fshatit janë larguar drejt Greqisë dhe Gjermanisë. Numri i popullsisë ka ndryshuar: 282 b. (v. 1920), 684 b. (v. 2001), 867 b. (v.2016) dhe 825 b. (2024). Sipas përlllogaritjeve të banorëve, në fshat nuk jetojnë më shumë se 400 banorë gjatë të gjithë vitit. Gjatë vitit 2024 në fshat ka pasur 1 lindje dhe 7 vdekje.



Foto. 45, 46. Qendat dhe pamje nga një lagje e fshatit Qatrom, 2025

Dominojnë banorët e moshës së tretë. Në shkollën 9-vjeçare “Rakip Kocibelli” arsimohen rreth rreth 30 fëmijë të moshës 5- 15 vjeç. Fëmijët e shkollave të mesme arsimohen në qytetin e Korçës. Në fshat ofrohet shërbimi shëndetësor nga infermjerja gjatë të gjithë javës dhe nga mjeku dy herë në javë. Në fshat gjendet një dyqan ushqimor dhe një kafene. Mungojnë shërbimet kulturore dhe akomoduese. Fshati furnizohet me energji elektike, ka rrjet të mirë të ujësjellësit, por ka kanalizime të ujrave të zeza të pjesshme. Infrastruktura rrugore është e

mirë. Fshati lidhet me dy rrugë me qytetin e Korçës dhe me fshatrat përreth. Transporti publik mungon, ai ofrohet nga shërbime private.

Fshati Qatrom është i grumbulluar dhe i organizuar në lagjen e Lumit, lagjen e Vreshtave, të Gropave dhe lagjen e Mesit. Banesat e vjetra janë një katëshe, me çati e të ndërtuara me plitharë. Ndërtimet e reja janë një dhe dy katëshe, me çati, e të ndërtuara me tulla. Banesat janë të ndërtuara pranë njëra-tjetrës dhe të shpërndara. Fshati ka një qendër, ku gjendet shkolla, ambulanca, lapidari i dëshmorëve të fshatit dhe xhamia. Banorët i përkasin besimit mysliman.

Banorët e fshatit Qatrom janë të angazhuar me bujqësi dhe blektori. Tokat arrë kultivohen me grurë, misër, foragjere, si dhe me vreshta, mollë, kumbulla e qershi. Një pjesë e tokave janë lënë djerrë për shkak të largimit të popullsisë. Ka edhe sipërfaqe toke të dhëna me qera në banorë të qytetit të Korçës ose fshatrave përreth. Blektoria ka zhvillim të mirë. Në fshat mbarështohen rreth 70 lopë, 500 krerë dele dhe rreth 100 krerë dhi. Në fshati gjenden edhe disa koshere me bletë, në pronësi të banorëve nga qyteti. Në fshat ka një fabrikë mielli, një furrë buke dhe 3 frigoriferë për ruajtjen e mollëve. Në fshat janë ngritur katër shtëpi pritëse (bujtina), të cilat presin vizitorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

2.3.7. RAVONIK

Ravoniku është pjesë e Nj.A. Drenovë. Gjendet në koordinatat gjeografike: 40° 36' 17'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 44' 40'' gjatësi gjeografike lindore; në fushëgropën e Korçës, në lartësinë 851 m mbi nivelin e detit, në JP. të Korçës. Distança nga qytetin i Korçës është 4.3 km. Ravoniku kufizohet nga fshati Voskop, Lavdar e Polenë në P., fshatin Turan në V., dhe fshatin Qatrom në J.

Fshati është ndërtuar mbi depozitime aluviale (rëra, alevrite, zhavore) të Holocenit (Q_h) dhe depozitime aluviale-proluviale të Pleistocen-Holocenit (Q_{p-h}). Territori i fshatit është tërësisht fushor, me një pjerrësi shumë të vogël në drejtim të veriut. Klima është mesdhetare

paramalore. Dimri është i ftohtë dhe me ngricë, ndërsa vera është e freskët dhe e thatë. Territori i fshatit bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit Devoll. Në P. të fshatit kalon lumi Dunavec, i cili mbledh të gjitha ujërat sipërfaqësore të fshatit.



Fig.21. Imazh satelitor i fshatit Ravonik, 2025

Tokat janë të kafenjta, me trashësi të tokës mesatarisht 130 cm, me ph ujur 7.5, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 1.6 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,4%; azoti i përgjithshëm mes. 0.084%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 1.33 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes. 17 mg. Tokat janë të drenazuara, por kanë nevojë për pasurim të vazhdueshëm me minerale. Bimësia natyrore është e pakët, ajo i përket brezit të dushqeve.

Sipas të dhënave historike, fshati ka një histori të gjatë krijimi. Të dhënat e para statistikore i përkasin v. 1900, ku në fshat kishte 46 familje me 275 banorë. Në periudhën e komunizmit popullsia është shtuar në vazhdimësi nga shtimi natyror dhe ardhjet e popullsisë nga malësia e Vithkuqit dhe malësia e Kolonjës. Numri i popullsisë ka ndryshuar: 275 b. (v. 1920), 853 b. (v. 2001), 1025 b. (v. 2016) dhe

1000 b. (2024). Numri i familjeve është rreth 247. Pjesa më e madh e popullsisë janë myslimanë. Në fshat gjendet një vakëf dhe kisha e Shën Parashevisë, e rindërtuar në vitet 1990 në rënojat e kishës ekzistuese. Aktualisht vihet re një rënie e numrit të popullsisë për shkak të emigrimit kombëtar dhe ndërkombëtar. Popullsia e re ka emigruar fillimisht drejt Greqisë dhe vitet e fundit në Gjermani. Në fshat gjenden shtëpi të vjetra, një katëshe, me çati e të ndërtuara me plitharë. Krahastyre, në hyrje të fshatit gjenden shumë banesa të reja, të ndërtuara nga banorët që kanë shitur ndërtimet e vjetra (brenda fshatit) e që janë të punësuar në emigracion.



Foto.47, 48. Pamje nga qendra e fshatit Ravonik, 2025

Fshati është i grumbulluar, edhe pse ndërtime gjenden edhe në tokat bujqësore, përgjatë rrugës Ravonik-Qatrom. Ravoniku ka një qendër fshati ku gjendet ambulanca, lapidari për 18 dëshmorët e rënë në Luftën e II Botërore, një dyqan dhe shkolla 9-vjecare. Ravoniku është i organizuar në pesë lagje. Fshati ka infrastrukturë rrugore të mirë, edhe pse mungon transporti publik. Lëvizja e banorëve bëhet me transport privat. Rrjeti elektrik, i kanalizimeve dhe rrjeti i internetit janë të mirë. Rrjeti i ujësjellësit furnizon banorët me ujë 24 orë. Uji merret në qytetin e Korçës. Në fshat ofrohet shërbim ambulator çdo ditë nga infermjerja dhe një herë në javë nga mjeku. Në fshat gjenden dy dyqane ushqimore, tri bar-e dhe një furrë buke.

Tokat arrë janë të kultivuara me grurë, misër dhe jonxhë. Ka edhe sipërfaqe të tokave të punëshme të zëna me pemë frutorë, si: mollë,

qershi, kumbulla dhe dardha. Banorët e fshatit merren edhe me blektori. Në fshat mbarështohen rreth 500 krerë dele, 50 krerë dhi, 90 lopë, rreth 50 derra dhe rreth 10 kafshë pune. Shpendët shtëpiakë janë të pranishëm në oborret e shtëpive.

2.3.8. TURAN

Fshati Turan është pjesë e Nj.A. Drenovë. Gjendet në koordinatat gjeografike 40° 37' 13'' gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 44' 30'' gjatësi gjeografike lindore; në fushëgropën e Korçës, në lartësinë 838 m mbi nivelin e detit, në anën e majtë të rrugës Korçë-Voskopojë, rreth 4.2 km larg qytetit të Korçës. Kufizohet në J. me fshatin Ravonik, në L. me qytetin e Korçës, në P. me fshatrat Voskop dhe Goskovë.

Territori i fshatit pozicionohet mbi depozitime ranore, alevrite dhe zhavore të periudhës së Holocenit (Q_h). Konsiderohet një fshat fushor me shtrirje tërësore në fushëgropën e Korçës, lartësia e të cilës ka një pjerrësi të vogël në drejtim të veriut. Klima në fshat është mesdhetare paramalore, jugore.



Fig. 22. Imazh satelitor i fshatit Turan, 2025

Hidrografia përfaqësohet nga lumi Dunavec, rezervuari i Turanit dhe nga burime nëntokësore të cilat shërbejnë për furnizimin me ujë të pandërprerë të qytetit të Korcës dhe fshatrave përreth.

Tokat në fshatin Turan i takojnë brezit të tokave të kafenjta, të cilat kanë shtrirje nga lartësitë 600-1000 m dhe kanë përmbajtje të lartë humusi me trashësi 30-49 cm. Ndërsa bota bimore përfaqësohet kryesisht nga bimët e kultivuara, ndërsa natyrale kemi vetëm plepin dhe disa lloje shkurresh si manaferra dhe trendafili i egër. Në botën shtazore dallojmë disa kafshë si: dhelpra, nepërka, nusja e lalës, dhe në raste të veçanta ujku i cili zbret nga lartësitë e maleve. Ndërsa nga shpendët dallojmë: thëllëzën e fushës (gargujt, shqiponja, laraska, bufi, pëllumbat etj. Fauna ujore është e përfaqësuar me gjallesat që jetojnë në lumin Dunavec, ku ndër to dallojmë disa lloje peshqish si: marena, ngjala, cironkën e bardhë, karasi, klenin etj si dhe dallojmë kafshë ujore si gjarpërnjtë e ujit, breshka e ujit, bretkosa, vidrën, aragosta e lumit etj. Për sa i përket vitit të themelimit të fshatit nuk dihet me siguri por nga zbulimet arkeologjike të gazsjellësit TAP në fshatin Turan u gjet një varrezë që i perket epokës së hekurit. Këto gërmime janë realizuar në vitin 2017 ku doli në dritë një nga varrezat më të mëdha të lashta në Shqipëri, me rreth 1.000 varrime të shtresuara, disa prej të cilave mendohej se ishin edhe të mobiluara. Nga gërmimet arkeologjike kanë dalë në dritë shumë objekte me vlerë të madhe si: unaza, rathë, vathë, enë qelqi dhe rruaza qelqi, monedha ari, shumë objekte qeramike, që mendohet të përdoreshin në shekullin e XI-të apo të X-të.

Teqeja e Turanit është një monument i trashëgimisë kulturore në Turan dhe ndodhet në buzë të rrugës. Përdorimi fillestar i kullës ka qënë vrojtimi. Kulla, ka një pjesë të zhytur nën tokë, kurse pjesa tjetër është mbi tokë.

Kulla e Turanit ndodhet në skajin lindor të fshatit Turan dhe është ndërtuar në një terren të sheshtë. Volumi i saj i mbyllur, mungesa e dritareve dhe elementë të tjerë flasin vetëm për mbrojtje. Sipas të

dhënave, kulla ndahet në katër kate prej dyshemesë së drurit e cila nuk ruhet me përjashtim të gjurmëve të trarëve.

Është një vendbanim fushor me funksion agrar. Sipërfaqja tokësore e fshatit është rreth 180 hektarë, ndërsa për sa i përket planit të shtrirjes, ai ka shtrihet sipas planit linear i vendosur përgjatë rrugës kryesore nga të dyja anët e saj. Venbanimi përbëhet nga dy pjesë: Turani i cili zë pjesën dërmuese të fshatit ku banon shumia e popullsisë 85% dhe Turani lart ku banon vetëm 15% e popullsisë. Në sipërfaqen e ndërtuar dallohen 9 lagje (mëhalla) të shkëputura nga rruga kryesore të cila janë të paasfaltuara dhe kanë mesatarisht nga 6-7 shtëpi.

Turani është vendbanim i vogël me popullsi të ardhur nga zona e Voskopojës dhe fshati Lavdar, i cili përgjatë viteve është karakterizuar nga migrimi i popullsisë dhe kohët e fundit ka zvogëlim të popullsisë. Pas viteve 90 banoerët u përfshinë në migrimin e brendshëm në drejtim të qytetit të Tiranës, Korcës etj., dhe migrimi i jashtëm në drejtim të Greqisë, Italisë, SHBA etj. Në të njëjtën kohë me migrimin e popullsisë vendase fshati tërhoqi popullsi nga vendbanimet e thella në brendësi të territorit të bashkisë Korçë. Të ardhurit ripopulluan fshatin duke ndërtuar shtëpi të reja. Banorët janë të besimit musliman. Në fshati gjendet teqeja e Turanit.

Popullsia e fshatit ka ndryshuar në vazhdimësi. Numri i popullsisë është: 81 b. (v. 1900), 69 b. (v. 1920), 421 b. (v. 2001), 454 b. (v. 2005), 347 b. (v. 2016). Aktualisht, numri i familjeve është 108 dhe numri i popullsisë 356 banorë.

Përbëhet gjithsej nga rreth 100 shtëpi. Gjatë vitit të kaluar (2023) fshati ka pasur 6 vdekje dhe 0 lindje. Popullsia aktive është e zënë me punë në sektorin publik dhe privat në qytetin e Korcës dhe ndërsa pjesa tjetër është e zënë me bujqësi. Karakteristikë është punësimi sezonal në shtetin fqinj në Greqi. Banorët e angazhuar në bujqësi, i kanë kultivuar tokët e tyre kryesisht me drithëra (gruri, elbi apo tërshëra) dhe më pak me kultura të tjera (pemëtari). Blegtoria nuk është shumë e zhvilluar. Bagëtitë e imta dhe produktet e tyre shfrytëzohen për konsum familjar dhe pak për treg.

Në lidhje me shërbimet sociale që ofrohen, afërsia me qytetin e Korçës ka bërë të mundur reduktimin e disa shërbimeve sociale. Shkolla e Turanit funksionon vetëm për arsimin e ulët, me klasa kolektive ku mësojnë gjithsej 22 nxënës, ndërsa parashkollori ka 30 fëmijë. Mjeku i familjes ofron shërbim shëndetësor në ditë të veçanta, ndërsa infermjerja ofron shërbim ambulator gjatë të gjithë javës.

Rrugët kryesore janë të asfaltura, ndërsa në brendësi të lagjeve mungon asfalti. Kanalizimet e ujrave të zeza janë të pjesëshme. Të pranishme janë shërbimet 24 orë në drita, ujë dhe internet. Në fshat gjenden shpimet më të mëdha të ujit, që furnizojnë qytetin e Korçës dhe disa fshatra përreth tij.

Në territorin e fshatit ndodhen katër biznese të tipit bar-restorant, që ofrojnë pije dhe gatime tradicionale. Një mundësi për rigjallërimin e jetës së vendbanimit është edhe hapja e një biznesi të kuajve ku është ngritur edhe një pistë vrapimi me kuaj që ofron argëtim për vizitorë të ndryshëm.




Foto.49. Pamje të kullës së Turanit, “Monument Kulture”, 2025

2.4. NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAJ

Njësia administrative (Nj.A.) Mollaj është pjesë e bashkisë së Korçës. Gjendet gjeografikisht në juglindje të bashkisë, midis $40^{\circ} 29' 23''$ e $40^{\circ} 35' 10''$ gjerësi gjeografike veriore dhe $20^{\circ} 38' 33''$ e $20^{\circ} 46' 33''$ gjatësi gjeografike lindore. Distanca km veri-jug është 10.7 km, ndërsa distanca lindje-perëndim është 14.8 km. Ka një sipërfaqe prej 69 km^2 , ose 8.3 % të sipërfaqes së bashkisë. Kufizohet në veri me Nj.A. Drenovë, në lindje me Nj.A. Miras (bashkia Bilisht), në jug me Nj.A. Mollaj (bashkia Ersekë), në perëndim Nj.A. Vithkuq dhe dhe veriperëndim me Nj.A. Voskop.

Mollaj si njësi gjendet në zonën tektonike të Mirditës dhe gropave Ndërmalore. Të pranishëm janë depozitimet aluviale (alevrolite, rëra, zhavore) të holocenit (Q_h); depozitive deluviale-koluviale dhe aluviale të pleistocenit (Q_p); argjila, rëra, konglomeratë e qymyre të oligocenit të mesëm (Pg_3^2); gëlqerorë konglomeratikë të kretës së poshtme (Cr_1); breçke ofiolitike, ranorë tufogjenë të jurasikut të sipërm (J_3) dhe depozitime të jurasikut të mesëm (J_2). Përbërja litologjike ka mundësuar praninë e burimeve minerale, si: gurë, rëra, zhavore të përdorura si materiale ndërtimi.

Territori i njësisë shtrihet në fushëgropën e Korçës, shpatin perëndimor të vargut malor të Moravës dhe pjesën lindore të malësisë së Vithkuqit. Lartësia më e ulët është 850 m mbi nivelin e detit dhe lartësia më e lartë është 1528 m mbi nivelin e detit. Klima është tipike mesdhetare paramalore, me ndikim të masave ajrore që vijnë nga kontinenti. Territori i njësisë administrative bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit të Dunavecit, degë e majtë e lumit Devoll. Brenda territorit të Nj.A. gjenden burime të shumta ujore, përrenj (i Floqit, Dëvoranit), lumenj (i Kamenicës, Dunaveci) dhe liqene artificiale (ujëmbledhësi i Kamenicës). Tokat janë kryesisht të brezit të kafenjtë, kurse bota bimore dominohet nga brezi i dushqeve edhe pjesërisht i ahut.



Harta 8. Shtrirja gjeografike e Njesisë Administrative Mollaj, Burimi: Arc GIS 10.1

Njësia Mollaj ka në administrim fshatrat Mollaj (Dëvoran), Kamenicë, Floq, Pulahë dhe Ujëbardhë. Fshatrat gjenden përgjatë rrugës nacionale Korçë- Ersekë, ku Mollaj (Dëvorani), Kamenica dhe Floqi ndodhen në të majtë të rrugës dhe Pulaha e Ujëbardha në anën e djathtë të saj. Fshati më i afërt me qytetin e Korçës është Mollaj (7.5 km) dhe fshati më i largët është Floqi (15 km).

Popullsia në v. 2023 në Nj.A. Mollaj është 2 615 banorë, nga të cilët 1 334 meshkuj dhe 1 281 femra. Moshë e re (0-14 vjeç) zë 14.1 % të popullsisë, moshë aktive (15-64 vjeç) zë 63.9 % dhe moshë e tretë (65+

vjeç) 22% të popullsisë. Në popullsisë me moshë mbi 10 vjeç të Nj.A. Mollaj, rreth 55.3% e tyre është me arsim 7/8/9 vjeçar; 20.5% me arsim të mesëm dhe vetëm 7.6 % me arsim të lartë dhe pasuniversitar (Cens, 2023). Popullsia në Nj.A. Mollaj konsiderohet e plakur sepse mosha e tretë zë rreth $\frac{1}{4}$ e popullsisë totale. Plakja e popullsisë është ndikuar nga rënia e numrit të lindjeve në secilin fshat, rritjes së vdekjeve për shkak të numrit të lartë të moshës së tretë dhe dominimit të emigrimeve kundrejt ardhjeve (imigrimeve). Në 22 vitet e fundit, sipas të dhënave të Censusve 2001, 2011 dhe 2023, numri i popullsisë në Nj.A. Mollaj ka rënie graduale me 32 %, përkatësisht v.2001 me 3 863 b.; v. 2011 me 3 438 b. dhe v.2023 me 2 615 b. Të dhënat e Censusve nuk përkojnë me të dhënat demografike të Zyra të Gjendjes Civile, sipas të cilave numri i popullsisë është më i lartë. Këto ndryshime të dhënave shkaktohen nga rregjistrimet e emigrantëve ndërkombëtar në Shqipëri dhe nga mosdeklarimi i lëvizjeve migruese kombëtare e ndërkombëtare. Nj.A. Mollaj ka më shumë të larguar (emigrantë) se të ardhur (imigrantë). Numri më i lartë i të ardhurve evidentohet në fshatin Dëvoran, ndërsa numri më i ulët në fshatin Ujëbardhë. Të ardhurit i përkasin vendbanimeve më të thella rurale të malësisë së Vithkuqit dhe krahinës së Devollit, të cilët vlerësojnë pozicionin gjeografik të përfshatshëm veçanërisht të fshatit Dëvoran, klimën dhe tokat e punëshme tepër produktive.

Sipas drejtorisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në Nj.A. Mollaj gjenden 2 914,3 ha tokë të punëshme, kur rreth 497 ha janë të zëna me pemtari e vreshta dhe 2 417,3 ha toka arë. Fshati Dëvoran ka sipërfaqet më të mëdha me pemë frutorë e vreshta (306, 5 ha) dhe tokë arë (928 ha), ndërsa fshati Ujëbardhë ka sipërfaqet më të vogla të tokës arë (167 ha) dhe tokës së zënë me pemë e vreshta (1 ha).

Aktivitetet kryesore ekonomike të Nj.A. Mollaj janë bujqësia dhe blektoria, produktet e të cilave shkojnë për treg ndërkombëtar, kombëtar, lokal dhe konsum familjar. Nj.A. Mollaj njihet për kultivimin e mollës, qershisë, kumbullës, lajthive, lakrës, grurit, mistrit, foragjereve dhe primeve. Tokat ujiten me ujrat e kanalit të

Gjancit dhe ujrata e lumenjve/përrenjve që vijnë nga mali i Moravës. Blektoria zhvillohet me mbarështimin e rreth 3000 krerë dhen dhe rreth 250 gjedhë, produktet e tyre tregëtohen në baxhot e dyqanet më të afërta. Aktivitet ekonomik vlerësohet nxjerrja e lëndëve të para për ndërtim, në tri gurore të Nj.A. Mollaj. Në këtë njësi ka dy baxho, 11 frigoriferë të ruajtjes së mollëve, një fabrikë të prodhimit të lëngjeve të frutave, tri mullinj, një sharrë, 3 bujtina dhe katër restorante.

Infrastruktura e përgjithshme bazohet në infrastrukturën fizike dhe të shërbimeve. Rrugët që lidhin fshatrat me njëra-tjetrën dhe me qytetin e Korçës janë të gjitha të asfaltuara. Rrjeti energjitik ofron energji elektrike të pandërprerë 24 orë në të gjithë vendbanimet, vetëm në raste të rreshjeve të dendura të dëborës dhe erërave të forta evidentohen ndërprerje. Fshatrat furnizohen me ujë 24 orë. Uji i pijshëm sigurohet nga burimet e malit të Moravës dhe të malësisë së Vithkuqit. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza ka ardhur duke u përmirësuar. Telekomunikacioni ofrohet nëpërmjet shërbimit të telefonisë celulare dhe Fast Net mbulon me sinjal interneti të gjitha fshatrat. Mbetjet urbane të njësisë administrative depozitohen në landfildin e Maliqit dhe pjesërisht në përrenjtë e fshatrave. Edhe mbetjet inerte trajtohen në vendgrumbullime të posaçme.

Transporti i banorëve në vendbanimet e njësisë mundësohet nëpërmjet linjave private, të tipit të furgona dhe taksi.

Shërbimi shëndetësor ofrohet nëpërmjet qendrave ambulatorie të pranishme në çdo vendbanim. Mjekët janë të pranishëm 1 ose 2 herë në javë, ndërsa infermjerët janë të përhershëm. Në Nj.A. Mollaj janë të pranishme, një shkollë e mesme e bashkuar, dy shkolla 9-vjeçare dhe një shkollë fillore. Vetëm fshati Ujëbardhë ka mundësi të institucionit arsimor.

Trashëgimia kulturore në territorin e njësisë është e pasur me arkeologji, objekte kulti, ndërtime tradicionale, tradita, zakone, festime dhe kulinari. Statusin e Monumentit të Kulturës e mbajnë: Kalaja e Bellovodës (Ujëbardhës), Tuma e Kamenicës dhe kisha e Shën Kollit

të Kamenicës. Figurat më të njohura të Nj.A. Mollaj janë Kristo e Thanas Floqi dhe Ruzhdi Pulaha.

2.4.1 MOLLAJ (DËVORAN)

Fshat dhe qendra e njësisë administrative Mollaj. Gjetet në gjerësinë gjeografike: $40^{\circ} 33' 36''$ dhe gjatësinë gjeografike: $20^{\circ} 44' 29''$; në jug të fushëgropës së Korçës, në lartësinë 900 m mbi nivelin e detit dhe rreth 7.5 km nga qyteti i Korçës, përgjatë rrugës Korçë-Ersekë në anën e majtë. Kufizohet me fshatin Boboshtiçë në L., me fshatin Kamenicë në J, me fshatin Dërsnik në P. dhe fshatin Qatrom në V.



Fig.23. Imazh satelitor i fshatit Mollaj (Dëvoran), 2025

Territori i fshatit ndërtohet nga depozitime të deluvioneve dhe kulvioneve të periudhës së pleistocenit (Q_p); nga ranorë, alevrolite të akuitarianit dhe ranorë, argjila dhe konglimeratë të pliocenit (N_2). Relievi është fushor, me pjerrësi në drejtim të veriut. Në jug të fshatit

gjendet mali Korijsa e Mulipit (997m), një kodër me kreshtë të rrumbullakosur e shpatë të buta.

Territori i fshatit është pjesë e pellgut ujëmbledhës të l. Devoll. Burimi i Toplecit dhe Moçalit janë dy burimet më të mëdha në fshat. Përmes fshatit me drejtim lindje-perëndim rrjedh lumi i Dvoranit, degë e djathtë e lumit të Dunavecit. Ujitja e tokave bujqësore bëhet nga kanali ujitës, që furnizohet nga liqeni i Gjançit. Klima është mesdhetare paramalore, me verë të freskët e ditër të ftohtë. Të pranishme janë rreshjen të formë shiu, bore dhe breshëri. Tokat janë të kafenjta, me trashësi të tokës mesatarisht 140 cm, me pH uhor 6.9, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 2.08 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1,66%; azoti i përgjithshëm mes. 0.14%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 5.19 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes.26 mg. Bimësia i përket brezit të dushqeve. Bimësia natyrore është në sipërfaqe të vogla.

Emri Dvoran do të thotë *oborri-mbretëror*. Ky emër është vendosur gjatë sundimit sllav. Sipas të dhënave të pleqëve të fshatit, fshati Dvoran banohej në vendin e quajtur "Turek" (në rrëzë të Stërkës së Boboshticës), ndërsa këtu ku është Dvorani sot banohej nga të krishterë shqipëtarë. Me vendosjen e pushtimit osman, turqit nuk e pranonin fenë e krishterë dhe në Dvoran, erdhën myslymanët. Turqit ia ndryshuan emrin nga Dvoran në Tepexhik, që do të thotë fshat midis dy tepeve, dy kodrave.

Mbas luftës së dytë Botërore, menjëherë mbas vendosjes së rregjimit komunist në Dëvoran u krijua ferma dhe kooperativa bujqësore. Kultivimi i sipërfaqeve të mëdha me mollë i vendosi emrin "Mollaj" fshatit. Krijimi i fermës dhe kooperativës kërkonte fuqi puntore, të cilat u siguruan nga individë të ardhur nga fshatrat e malësisë së Vithkuqit, malësisë së Ersekës, krahinës së Mokrës dhe krahinës së Devollit.



Foto.50, 51. Imazhe nga pallatet 3-katëshe dhe ndërtimet private në fshatin Mollaj (Dëvoran) , 2025

Një pjesë e familjeve ishin të përndjekur politikë. Popullsia në fshatin Dëvoran është rritur në vazhdimës. Dëvorani është fshati më i madh njësisë administrative Mollaj, me: 426 b. (v.1900), 394 b. (v.1920), 1803 b. (v.1985), 2703 b. (v. 1990), 1495 b. (v. 2001), 2788 b. (v.2005), 2829 b. (v.2019), dhe 2500 b. (2020). Aktualisht, numri i familje është 535 në v. 2019. Në vitin 2019 rezultojnë 11 lindje dhe 9 vdekje. Rritja e numrit të popullsisë është ndikuar nga ardhjet e popullsisë, veçanërisht nga fshatrat malorë (Arrëz, Panarit, Lozhan), të cilët janë të lidhur me aktivitetin bujqësor dhe gjenden më afër tregut, shërbimeve dhe zhillimit ekonomik. Pavarësisht se ka shumë ardhje, fshati njih largime të popullsisë, sidomos të të rinjve, në drejtim të Tiranës, Durrësit, qyteteve të Greqisë, Gjermanisë etj.

Fshati Dëvoran është tërësisht fushor, i organizuar në 7 lagje: lagjia e Sallatashit, lagjia e Lumit, lagjia e Plloçkës, lagjia e Kullirave, lagjia e Boboshticës, lagjia e Burimit dhe lagjia e Korçës. Fshati ka një qendër të vogël kur janë të ndërtuara disa shërbime dhe xhamia. Banesat janë të tipit të pallateve 3-katëshe me tulla dhe shtëpi private 1 ose 2-katëshe me oborr dhe avlli. Banesat e vjetra janë ndërtime me gurë, kryesisht 1 katëshe, ndërsa ndërtimet e reja 2-3 katëshe dhe të shpërndara edhe në tokat arë.

Rrugët e fshatit janë kuadratike, të shtrurara me asfalt ose kalldrëm. Transporti ofrohet nga operatorë privatë dhe ofrohet çdo 30 min në drejtim të Korçës dhe anasjelltas. Në Dëvoran ofrohen shërbime të mira

të rrjetit elektrik, ujësjellësit, kanalizimeve dhe internetit. Fshati furnizohet me ujë të pijshëm nga burimet e Zgërfellës dhe Saliut. Rrjeti i kanalizimeve është pothuajse i plotë në fshat. Në fshat ofrohen shërbime shëndetësore dhe arsimore. Në qendrën shëndetësore ka 1 daktroreshë, 1 mami dhe 3 infermiere. Shkolla "Isuf Dalipi" është shkollë e mesme e bashkuar dhe në të marrin mësim fëmijët nga kopshti deri në klasë të 12-të. Në shkollën e mesme arsimohen fëmijë që vijnë edhe nga fshatrat më të afërt të Dëvoranit.

Tokat arrë zënë 928 ha, tokat me pemtari dhe vreshta 206.5 ha, tokat pyjore 44.5 ha dhe kullotat 2.2. ha. Rreth 50 ha e tokës në fshat është truall ndërtimi. Të gjithë tokat arrë janë të punueshme.

Remitancat e emigrantëve janë investuar në aktivitete ekonomike, ndërtimtari dhe shërbime arsimore e shëndetësore. Mollaj është një fshat i karakterit bujqësor. Përparësi ka kultivimi i mollëve (138 ha), qershive (69 ha) dhe kumbullave (29 ha) (ushqimit). Tokat arë kultivohen me drithëra të bukës (323 ha), perime (veçanërisht lakër e bardhë) (26.1 ha), foragjere (178 ha), fasule (5 ha) dhe patate (6 ha).



Foto.52,53. Pamje të tokave ara të punuara dhe të mbjella me pemë frutorë, 2025.

Tokat kanë përdorim intensive pasi përdoren mjete si traktorë, minitraktorë, makina mjellëse, motokorse, autokombanja, freza etj. Krahas bujqësisë zhvillim ka edhe blektoria. Në Dëvoran mbarështohen rreth 65 gjethë, 1000 të imta, 15 kafshë punë dhe rreth 1200 shpendë. Sektori i dytë i ekonomisë përfaqësohet nga ndërmarjet

përpunuese. Në Mollaj gjendet 1 baxho, 3 mullinj, 1 sharrë, 3 hekurpunues, 4 rrobaqepsi, 11 frigoriferë të ruajtjes së mollëve dhe 1 fabrikë të përpunimit të frutave.

Aktivitetet tregëtare të pranishme në fshat janë 2 hotele, 1 restorant, 9 bar-kafe, 6 dyqane ushqimesh, 3 prodhim e tregëtim fidanësh, 2 karburante, 1 gomisteri, dhe 1 lavazh makinash. Afërsia me qytetin e Korçës, territori fushor dhe tokat bujqësore produktive e bëjnë fshatin një qendër zhvillimore ekonomike.

2.4.2. KAMENICA

Fshati Kamenicë është pjesë e Nj.A. Mollaj. Gjendet në gjerësinë gjeografike: 40° 32' 13'' dhe gjatësinë gjeografike: 20° 43' 29''; në pjesën jugore të vargut malor të Moravës (shpati perëndimor i malit të Llofkës); në jug të malit të Lajthisë së Madhe dhe në veri të malit të Strajishtit; midis lartësive 902-1047 m mbi nivelin e detit, rreth 11 km nga qyteti i Korçës.



Fig.24. Imazh satelitor i fshatit Kamenicë, 2025

Kamenica shtrihet përgjatë rrugës nacionale Korçë-Ersekë, në anën e majtë. Kufizohet me fshati Floq në J., fshatin Dvoran në V. dhe fshati Pulahë e Dërsnik në P. Fshati ka shtrirje gjatësore në grykën e formuar nga lumi i Kamenicës dhe në fushën e Korçës, sapo del nga gryka e lumit. Territori i fshatit përbeht nga depozitime terrigjene të oligocenit të mesëm, të përfaqësuara nga ranorë, argjila dhe konglomeratë. Relievi i ndërtuar prej tyre dallohet për kontraste të theksuara morfologjike, midis majave të maleve dhe grykëluginës. Relievi është kryesisht kodrinoro-malor, me kurrize e maja me forma të rrumbullakosurame shpate me pjerrësi të ndryshme, e me luginë të thellë të lumit të Kamenicës. Përreth fshatit gjenden disa maja malesh, me lartësi të ndryshme, si: 1251.2 m (mali i Lajthisë së Madhe), 1386m, 1376m, 1088m dhe 1010 m (mali i Strajishtit). Fshati Kamenicë shtrihet përgjatë luginës së lumit të Kamenicës. Lumi merr përrenj nga e majta dhe nga e djathta duke zhvilluar me intensitet proceset e shpatit. Shtrati i lumit paraqitet me gjerësi dhe me materiale të trasha zhavorore. Vitet e fundit është bërë shtratifikimi i lumit të Kamenicës. Klima është tipike mesdhetare paramalore, ndërsa tokat janë të brezit të kafenjtë e shumë pak të murrme pyjore.

Territori i fshatit Kamenicë është i pasur me burime ujore, si; burimi i Zgërfellës, burimi i Saliut, burimi i Izvorit, lumi i Kamenicës sëbashku me përrenjtë e majtë e të djathtë, si dhe ujëmbledhësi i Kamenicës. Ujërat e tyre gjejnë përdorin në familje, bujqësi dhe blektori. Tokat janë të kafenjta, me trashësi të tokës mesatarisht 150 cm, me pH ujqor 7.9, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 1.49 %, në 30-50 cm është mesatarisht 0.93%; azoti i përgjithshëm mes. 0.12 %; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 2.5 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes.16 mg. Kamenica ka sipërfaqe pyjore, të përfaqësuara nga brezi i dushkut dhe i ahut.

Territoret e fshatit Kamenicë njihen për hershmërinë e popullimit të tyre, dëshmuar nga siti arkeologjik "Tumat e Kamenicës". Tuma e Kamenicës daton që nga shekulli i XII p.e.s deri në shekullin e VI p.e.s. Gërmimet e bëra nga arkeologët në vitin 2002, kanë zbuluar një

vendvarrim me përmasa më të mëdha se vend-varrimet e zbuluara më parë. Fillimet e saj datojnë në fazën fundore të periudhës së bronzit të vonë (rreth 1250-1050/1025 B.C). Aty janë zbuluar rreth 400 varre dhe mbetje skeletore të më shumë se 430 individëve. Vendosija e trupit të një individi të vetëm në një varr primar të tipeve të ndryshëm, ka qenë mënyra më e zakonshme e trajtimit të të vdekurve të komunitetit prehistorik të Kamenicës, por janë ndeshur edhe trajtime të tjera alternative. Më i rëndësishmi ndër trajtimet alternative të të vdekurve është djegia e trupit. Interes paraqet mënyra në trajtimin e të vdekurve dhe rasti i vendosjes së dy individëve në të njëjtin varr. Interesante paraqitet gjithashtu gjetja e skeletit të trupit të një gruaje dhe një fëmije në barkun e saj. Në muzeun e tumës janë të ekspozuara larmi enësh qeramike të pikturuara dhe objekte të tjera metalike, (prej bronzit, hekuri, ari, kocke, qelqi apo gur), të cilat dëshmojnë qartë për organizimin social-ekonomik dhe kulturor të komunitetit prehistorik të zonës. Falë vlerave që mbart, tuma e Kamenicës, kërkon kujdes dhe mirëmbajtje të vazhdueshme, nga institucionet përkatëse. Ajo ka marrë statusin “monument kulture“, në vitin 2008 dhe përbën një nga vlerat e rralla për t’u vizituar nga turistët e huaj.

Gjatë periudhës osmane fshati Kamenicë përmendet në regjistrat kadastralë të shekujve XV-XVII si pjesë e një nahije të rajonit të Kolonjës, me 38 shtëpi. Popullsia ishte e përzier me të krishterë dhe më vonë edhe myslimanë. Kjo dëshmohet me praninë e kishë së Shën Nikollit, kishës së Shën Mërisë, kishës së Shën Thanasit dhe të xhamisë së Kamenicës. Aktualisht dominojnë banorët e besimit mysliman.



Foto. 54, 55. Lagjia e Poshtme dhe e mesme e fshatit Kamenicë, 2025

Popullsia e fshatit Kamenicë ka pësuar rritje gjatë periudhës 1945-1990 si rezultat i politikave pronataliste, përmirësimit të shërbimeve shëndetsore dhe arsimore, si dhe ndalimit të lëvizjes hapësinore të popullsisë. Vetëm mbas vitit 1990 në fshat u shfaqën ndryshime në strukturën demografike të popullsisë. Popullsia në vite është: 808 b. (v. 1900), 782 b. (v. 1920), 1294 b. (v. 2001), 2413 b. (v. 2005). Popullsia u përfshi në lëvizje hapësinore brenda vendit dhe jashtë territorit shqiptar. Lëvizjet përtej kufijve kanë qenë të përhershme dhe të përkohshme. Lëvizjet e përhershme shfaqen në banesat e braktisura e të rënuara të fshatit, ndërsa ndërtimet e reja si dhe rikonstruksionet e ndërtimeve ekzistuese janë tregues të emigrantëve sezonalë, emigrantëve të kthyer dhe investitorë të huaj. Në Kamenicë ka edhe popullsi të ardhur nga fshatrat e thellë të malësisë së Vithkuqit.

Fshati Kamenicë shtrihet në formë gjatësore, duke filluar që përgjatë rrugës nacionale Korçë-Ersekë deri në brendësi të grykës së formuar nga lumi i Kamenicës. Banesat e reja gjenden në pjesën e fushës, ndërsa ndërtimet ekzistuese janë të grumbulluara në tri lagje (lagjia e Përtejme, lagjia e Mesit dhe lagjia e Sipërme). Ndërtimet ekzistuese janë të ndërtuara me mure guri, çati me rasa guri, 1-2 katëshë e të pasuvatuara. Ndërtimet e reja janë të ndërtuara me tulla, 2-3 katëshe, me çati tjellugllash e të me murre të suvatuara e të lyera. Infrastruktura rrugore është e pranishme në të trija lagjet. Të pa shtruara janë rrugët dytësore. Transporti ofrohet nga furgonat privat të linjës Kamenicë-Korçë dhe anasjelltas. Rrjeti i energjisë elektrike, internetit dhe ujësjellësit është i mirë. Fshati furnizohet me ujë të pijshëm nga burimet e Zgërfellës dhe të Saliut. Shërbimi shëndetsore ofrohet në qendrën ambulatorie nga infermjerja e fshatit dhe mjeku që kryen vizita 1 herë në javë. Fshati ka një shkollë 9-vjeçare “6 dëshmorët” ku arsimohen fëmijët e moshës 3 deri në 15 vjec. Arsimi i mesëm merret në shkollën e Dëvoranit ose në shkollat e qytetit të Korçës. Në Kamenicë gjenden 4 dyqane ushqimore, 2 kafene, 2 restaurante dhe 4 bujtina.

Popullsia e fshatit Kamenicë ka të zhvilluar frutikulturën. Tokat ara janë të mbjella me vreshta mollës, qershish, kumbulla, lajthi, arra etj. Sipërfaqet e tjera të tokave të punueshme janë të mbjella me misër, grurë dhe foragjere (në ndihmë të zhvillimit të blektorisë). Blektoria zhvillohet në mbarështimin kryesisht të bagëtive të imta (rreth 800 krerë dele dhe dhi) dhe rreth 50 krerë lopë. Në fshatin Kamenicë merr zhvillim edhe turizmi kulturor (arkeologjik) në Tumat e Kamenicës.

2.4.3. FLOQ

Vendbanim rural në jug të Nj.A. Mollaj. Gjendet në Gjendet në gjerësinë gjeografike: 40° 30' 27'' dhe gjatësinë gjeografike: 20° 42' 52''; në pjesën jugore të vargut malor të Moravës; midis lartësive 1000-1060 m mbi nivelin e detit; midis shkëmbit të Dardhë, malit të Shpellësh, Shkëmbit të Zeres dhe majave të tjera të malit të Llofkës; rreth 15 km nga qyteti i Korçës. Kufizohet me fshatin Kamenicë në veri dhe fshatin Pulahë në perëndim.



Fig.25. Imazh satelitor i fshatit Floq, 2025

Territoret e fshatit Floq janë të përbëra nga breçke ofiolite, e ranorë tufogjenë të jurasikut të sipërm, si dhe gëlqerorë të kretës dhe triasit të sipërm e jurës së poshtme. Përreth fshatit gjenden shkëmbinjtë magmatikë. Territori i fshatit konsiderohet sizmik për shkak të kalimit të thyerjes tektonike tërthore që ndan vargun malor të Moravës në dy pjesë. Kjo dëshmohet nga tërmeti i qershor 2019, i cili solli dëmtime të banesave të fshatit.

Relievi i Floqit paraqitet kodrinoro-malor, me forma të rrumbullakosura të relievit, kreshta të buta e shpate me pjerrësi të ndryshme. Në shpatet me pjerrësi të madhe shfaqen format erozionale sipërfaqësore e me mungesë të bimësisë. Në shpatet më të butë janë të pranishme bimët e brezit të dushkut dhe të ahut. Përreth fshatit gjenden disa maja malesh me lartësi: 1182m, 1503m, 1499 m (sh.Zeres), m. i Shpellës dhe 1156 m mbi nivelin e detit.

Klima është mesdhetare paramalore. Vera është e shkurtër dhe e freskët, ndërsa dimri i gjatë dhe i ftohtë. Të pranishme janë rreshjet në formën e dëborës.

Territori i fshatit Floq është i pasur me burime ujore, si: burimi i Ujit të Ftohtë, burimi Pisha e Jorgjit, burimi Bllado dhe lumi i Bicës etj. Territori i fshatit është pjesë e pellgut ujëmbledhës të lumit Dunavec. Tokat e fshatit janë të brezit të kafenjtë, me trashësi të tokës mesatarisht 120 cm, me pH ujqor 7.9, përmbajtja e humusit deri në 30 cm është mesatarisht 1.45 %, në 30-50 cm është mesatarisht 1.14%; azoti i përgjithshëm mes. 0.13%; P_2O_5 i asimilueshëm në 100g tokë është 1.6 mg; dhe K_2O i asimilueshëm në 100 gm tokë është mes.15 mg. Ato kanë përdorim në bujqësi. Bimësia përfaqësohet me brezin e dushqeve dhe ahut. Pyjet e pishës dhe të dushkut gjenden në shpatet malore në veri dhe jug të fshatit.

Sipas gojëdhënave emërtimi i fshatit rrjedh nga “Floq ose Flok= flokë bore”, në fshat bie shumë borë. Një gojëdhënë e dytë fjala “Floq” do të thotë hije në turqishten e vjetër. Kjo mund të konsiderohet si shpjegimi më i mirë pasi fshati është i ekspozuar ndaj diellit vetëm në veri-përëndim. Popullsia në vite: 200 b. (v. 1430), 612 b. (v. 1900), 632 b.

(v. 1920), 1 300 b. (v. 1990), 575 b. (v. 2001), 1072 b. (v. 2005) dhe 400 b. (v. 2023). Popullsia e fshatit Floq ka pësuar rënie në 30-vitet e fundit. Në vitin 2014 në fshat jetonin deri 1100 banorë. Në vitin 2023 numri i popullsisë ka qenë 400 banorë, në rreth 120 familje. Popullsia e rë është larguar në drejtim të qytetit të Korçës, Tiranës, Durrësit si dhe Greqisë, Gjermanisë etj. Floqi po kalon fazën e plakjes së popullsisë. Në fshat gjenden më tepër popullsisë të moshës së tretë (+65 vjeç), të angazhuar në bujqësi dhe blektori. Popullsia e re është përfshirë në emigrimin e brendshëm dhe emigrimin ndërkombëtar. Banorët e fshatit janë të besimit mysliman dhe ortodoks. Në fshat gjenden xhamia dhe kisha e Shën Athanasit. Fshati është i ndarë në dy lagje të mëdha. Banesat e fshatit janë më së shumti 1-katëshe, të ndërtuara me gurë dhe të mbuluara me çati tjegullash.



Foto. 56,57. Pamje nga një prej lagjeve të fshatit Floq dhe qendra e fshatit, 2025

Infrastruktura rrugore është e pranishme deri në hyrje të fshatit. Rrugët kryesore dhe dytësore brenda në Floq janë të paasfaltuara. Në vende të caktuara gjenden gjurmë të kalldrëmve të prishur. Në fshat transporti është privat. Lëvizja e banorëve në drejtim të qytetit të Korçë kryhet me një furgon dhe makina private. Rrjeti elektrik ka probleme në periudhën e ftohtë të vitit, sidomos në ditët më rreshje bore apo erëra të forta. Ujësjiellësi është funksional. Fshati furnizohet me ujë nga burimi i Toplecit, Çezma e Ushtarit dhe burimi i Izvorit. Në fshat janë ndërtuar 2 depozitë të grumbullimit të ujit. Rrjeti i kanalizimeve

mungon, ujërat e zeza depozitohen në lumin e fshatit. Në fshat gjendet një shkollë 9-vjeçare "Floq-Pulahë". Arsimi i mesëm merrët në shkollat më të afërta, në fshatin Mborje ose në qytetin e Korçës. Qendra ambulatorie ofron shërbim nga infermjerja (gjatë të gjithë javës) dhe mjekja një herë në javë. Në fshat ka 1 dyqan ushqimor dhe 1 lokal.

Banorët e fshatit mbështeten në aktivitetin bujqësor në prodhimin e mollëve, qershive, kumbullave dhe dardhave. Tokat e tjera arë mbillen me foragjere dhe perime për përdorim familjar. Blektoria mbështet në mbarështimin e rreth 1000 bagëti të imta dhe rreth 50 krerë lopë. Në fshat gjenden rreth 200 koshere me bletë për shkak të pranisë së pyjeve dhe kullotave në lartësi të malit të Llofkës. Në territoret e fshatit gjendet një gurore për nxjerrjen e materialeve të ndërtimit (gurë, zhavorre etj). Banorët janë të njohur për prodhimin e qilimave të leshtë, një aktivitet artizanal që zhvillohet shumë pak tashmë. Fshati Floq njihet figurën e patriotit, shkrimtarit, politikat dhe avokatit të Kristo Floqit, si dhe firmëtarit e patriotit Thanas Floqi.

2.4.4. PULAHË

Vendbanim rural në Nj.A. Mollaj. Gjendet në gjerësinë gjeografike: 40° 32' 03" dhe gjatësinë gjeografike: 20° 41' 39"; në V. të malit të Stanës (1166 m); midis lartësive 900-955 m mbi nivelin e detit; midis malësisë së Vithkuqit dhe fushëgropës së Korçës, rreth 17 km nga qyteti i Korçës, në anën e djathtë të rrugës nacionale Korçë-Ersekë. Kufizohet me fshatin Ujëbardhë në perëndim, fshati Dërsnik në veri, fshatin Kamenicë në lindje dhe fshatin Floq në jug.

Territori i Pulahës përbëhet nga depozitime deluvionale-koluvionale të Pleistocenit (Qp); argjila, ranorë e konglomeratë të Oligocenit të mesëm (Pg²₃) dhe harcбургit-lercolit mantelik me ndërthurje të rralla dunitesh në pjesën e sipërme (σJ₂). Relievi i formuar prej tyre paraqitet me kontraste të vogla, shpate të butë dhe kreshta të rrumbullakosura. Relievi është kodrinoro-fushor, me pjerrësi në drejtim të L.; me prani të përrënjeve të shkurtër e të cekët. Majat më të larta që rrethojnë fshatin

në perëndim dhe jug arrijnë lartësitë 1077 m dhe 1166 m mbi nivelin e detit.



Fig. 26. Imazh satelitor i fshatit Pulahë, 2025

Fshati Pulahë është vendosur në depozitimet deluviale-koluviale të ardhura nga malet e malësisë së Vithkuqit.

Klima është mesdhetare paramalore, me dimër të ftohtë dhe verë të freskët. Në territorin e fshatit gjenden disa burime ujore, më i rëndësishëm burimi i Veizit nga i cili furnizohet me ujë të pijshëm Pulaha. Fshati bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit Dunavec, degë e majtë e Devollit.

Të përhapura janë tokat e kafenjta dhe të murrme pyjore. Tokat e kafenjta janë toka të punueshme (toka ara) dhe gjenden në pjesën e fushëgropës së Korçës. Tokat e murrme pyjore gjenden në shpatin e malit në jugperëndim të fshatit. Në brendësi dhe përreth fshatit gjenden bimë të katit të dushqeve dhe ahut. Të përhapura janë dëllinja e zezë (*Common juniper*), pisha (*Pinus*) etj. Në territorin e fshatit kultivohen bimë medicinale, të cilat grumbullohen dhe tregëtohen brenda vendit dhe jashtë Shqipërisë.

Sipas gojëdhënave fshati Pulahë fillimisht ka ekzistuar në lartësi të malit, aty ku sot quhet “Grykat”. Këtë e dëshmojnë banorët e zonës, të cilët shprehen se gurrët e ndërtimeve janë shfrytësuar gjatë viteve ‘50

për ndërtime në fshatin e sotëm. Arsyeja e zhvendosjes më poshtë të fshatit lidhet me praninë e një numri të lartë të gjarpërinjve. Në regjistrat osmanë të vitit 1450 fshati kishte rreth 40 shtëpi.



Foto. 58. Pamje të ndërtimeve dhe infrastrukturës në fshatin Pulahë, 2025

Rregjistrimet e para të popullsisë vijnë nga viti 1900, ku janë rregjistruar 279 banorë dhe rreth 45 familje. Gjatë viteve 1945-1990 fshati kishte rreth 550 banorë në rreth 124 familje. Fshati ishte i tipit bujqësor, pjesë e kooperativës së bashkuar Kamenicë. Tokat kultivoheshin me grurë, misër, patate, perime, mollë dhe rrush. Mbas vitit 1990 numri i popullsisë në fshat është përgjysmuar për shkak të largimeve drejt qytetit të Korçës, Tiranës, Greqisë dhe shtetë të tjera në Europë dhe Amerikë. Lëvizjet hapësinore kanë përfshirë moshat e reja të popullsisë, të përfshirë në lëvizje individuale dhe familjare. Edhe ardhjet (imigrimet) nga fshatrat e Panaritit, Lavdarit nuk mundën të kompesonin numrin e personave të larguar. Popullsia në vite: 279 b. (v. 1900), 297 b. (v. 1920), 550 b. (v. 1990), 413 b. (v. 2001) dhe 200 b.

(v. 2024). Banorët i përkasin besimit mysliman. Në fshat gjendet një vakëf dhe një xhami.

Fshati Pulahë është i grumbulluar, me një qendër trekëndore, ku takohet tri rrugët kryesore dhe ku janë ndërtuar ambulanca e një lulishte e vogël. Fshati është i ndarë në tri lagje (mëhalla). Ndërtimet janë me plitharë, gurrë dhe tulla. Ndërtimet me plitharë e gurrë, janë 1-katëshe e me çati tjegullash, ndërsa ndërtimet me tulla janë 2-3 katëshe dhe me çati po tjegulle.

Në fshat rrugët janë të asfaltuara, por mungon transporti publik. Lëvizja e banorëve bëhet me transport privat. Rrjeti elektrik dhe kanalizimet janë të sistemuara mirë. Rrjeti elektrik, i internetit dhe ujësjellësi janë në kushte të mira. Fshati furnizohet me ujë të pijshëm tek burimi i Veizit. Në Pulahë gjendet shkolla fillore "Hasim Saliu" me vetëm 5 nxënës. Disa fëmijë arsimohen në shkolla private jashtë territorit të fshatit. Fshati ka një qendër ambulatorie, ku ofron shërbim një infermiere gjatë të gjithë javës dhe mjeku që kryen vizita dy herë në javë. Fshati ka një dyqan ushqimore dhe një bar të vogël.

Aktivitetet ekonomike të banorëve janë bujqësia dhe blektoria. Tokat e punëshme kultivohen me pemë frutorë (mollë e dardha), si dhe bimë medicinale, patate, fasule, misër etj. Blektoria është e zhvilluar nëpërmjet mbarështimit të lopëve (rreth 54 krerë) dhe bagëtive të imta (rreth 270 dele dhe rreth 40 dhi). Në fshat gjenden rreth 250 koshere bletësh. Në fshat gjendet një baxho për përpunimin e qumështit dhe grumbullues të bimëve medicinale. Një nga figurat më të njohura të fshatit është dramaturgu (shkrimtari) Ruzhdi Pulaha.

2.4.5. UJËBARDHË (BELLOVODË)

Vendbanim rural në Nj.A. Mollaj. Gjendet në koordinatat gjeografike: : 40° 31' 32" gjerësi gjeografike dhe 20° 41' 07" gjatësi gjeografike; në lindje të malësisë së Vithkuqit, midis lartësive 1030-1090 m mbi nivelin e detit; ndërmjet malit të Stanes (1166 m), malit të Celivres

(1312 m) dhe malit të Kalës (1157 m), rreth 17 km larg qytetit të Korçës. Fshatrat më të afërt janë : Gjançi, Roshanji, Pulaha dhe Floqi. Territorët e Ujëbardhës përbëhen nga depozitime aluviale-proluviale (rëra, zhavore, aleviate) (Q_{p-h}) dhe në gëlqerorë të (T_3-J_1). Gëlqerorët paraqiten rezistentë dhe pozicionohen në format pozitive të relievit, ndërsa rërat, zhavoret dhe alevrolitet kanë formuar territoet më të ulta. Relievi paraqitet malor, me kurrize e maja me forma të rrumbullakosura dhe shpate me pjerrësi të ndryshme. Fshati Ujëbardhë është i vendosur në shpatin jugor të malit të Stanes, me ekspozim nga jugu të ndërtimeve. Përballë fshatit gjendet një lug me drejtim perëndim-lindje, ku mblidhen ujrat e rreshjeve të shiut për të derdhur në lumin Dunavec.



Fig.27. Imazh satelitor i fshatit Ujëbardhë (Bellovodë) 2025

Klima është tipike mesdhetare malore, me verë të shkurtër e të freskët dhe dimët të gjatë e të ftohtë. Rreshjet mesatare vjetore janë deri në 1000 mm/vit, të përqëndruara në gjysmën e ftohtë të vitit. Dëbora është e pranishme çdo vit, por në dekatën e fundit është pakësuar numri i

ditëve me rreshjeve bore dhe zgjatja e tyre. Territori i fshatit ka burime të vogla ujore, ujrat e të cilave përfundojnë në pellgun e lumit Devoll. Të përhapura janë tokat e murrme pyjore, të cilat zhvillohen në lartësinë mbi 1000 m, në shkëmbinj terrigjenë, klimë mesdhetare paramalore dhe malore dhe pyjeve të ahut. Tokat e punueshme (arat) zënë sipërfaqe shumë të vogla dhe janë të pozicionuara në jug të fshatit, në territoret më të ulta. Përreth fshatit gjenden dushqe dhe pyje të katit të ahut e halorëve.

Sipas studimeve arkeologjike territoret e fshatit Ujëbardhë kanë qenë të populluara që në fillimet e hershme të periudhës së Hekurit (1 200-800 p.e.s.) Kjo dëshmohet nga zbulimet arkeologjike në kalanë e Ujëbardhit (Bellovodës). Më parë fshati është njohur me emërtimin Bellovodë (bello=i bardhë + vodë =ujë nga sllavishtja). Rënojat e kalasë së fshatit gjenden në malin gëlqeror oval të Kalëst (1130m). Në të ruhen linjat e murit rrethues të kalasë, të ndërtuar me gurë massive, të papërpunuar dhe pa lidhje llaçi. Veçantia e kalasë qëndron tek muri tërthor që pret murin rrethues dhe kufizon një sipërfaqe më të vogël brenda kalasë. Ky mur krijonte një mjedis të vecuar, në formën e akropolit, i cili ka shërbyer si vendstrehim i aristokracisë fisnore. Muri ka një gjerësi 3.20-3.40m dhe ruhet në lartësinë 1 m (Karaiskaj, 1980). Fshati i Ujëbardhës konsiderohet një fshat i vogël, me ndryshime të vazhdueshme të numrit të popullsisë. Rregjistrimet më të hershme të popullsisë i përkasin vitit 1450, ku numëroheshin 27 shtëpi. Në vitet 1900 fshati kishte 31 familje e 285 banorë, të besimit të krishterë. Sipas gojëdhënave banorët e fshatit janë përfshirë në emigracion që herët, kryesisht në Greqi. Në periudhën 1945-1990 në fshat ishin të kufizuara lëvizjes hapësinore. Politikat pronataliste dhe të fuqizimit të fshatit bëri që numri i popullsisë të rritet. Në vazhdimësi numri i popullsisë ka ndryshuar: 188 b. (v. 1920), 400 b. (v.1990), 86 b. (v. 2001), 30 b. (v. 2024). Rënia e numrit të popullsisë është ndikuar nga lëvizjet migruese ndërkombëtare dhe kombëtare. Drejtim i lëvizjes ka qenë Greqia. Ardhjet e popullsisë mbas 1990 janë të pakta, kryesisht 2-3 familje nga fshati Roshanj. Në fshat dominon popullsia e moshës së tretë. Emigrimi

ka ndikuar pozitivisht duke rikonstruktuar banesat e fshatit, por edhe negativisht duke rënuar një pjesë të ndërtimeve.



Foto59, 60. Pamje të fshatit Ujëbardhë dhe të një banese 1-katëshe,
2025

Ndërimet janë një katëshe, me mure guri të gdhëndur dhe çati me tjegulla. Konsiderohet një fshat i grumbulluar, me shtëpi të bashkuara dhe prona të bashkuara. Fshati është i organizuar në dy lagje, të gjendura mbi rrugën kryesore që shkon në fshatin Vithkuq. Rrugët midis banesave janë të pashtuara.

Në fshat mungon transporti publik. Lëvizja e banorëve bëhet nëpërmjet linjës së transportit privat Korçë- Vithkuq. Mungon institucioni arsimor, fëmijët e fshatit arsimohen në fshatin më të afër Pulanë, ose në qytetin e Korçës. Gjithashtu në Ujëbardhë mungojnë shërbimet tregëtare, hotelerike, restorante dhe objekte kulturore. Nevojat familjare të banorëve plotësohen me tregëtarë ambulantë. Rrjeti i energjisë elektrike, i ujësjellësit, i kanalizimeve dhe i internetit është i mirë. Fshati furnizohet me ujë të pijshëm nga burimet e fshatit Vithkuq. Aktivitetet kryesore ekonomike të Ujëbardhit janë bujqësia, blektoria, gurore dhe artizanati. Tokat e punueshme janë të pakta. Kultivohen me perime, misër, fasule dhe të zëna me mollë, kumbulla të egra dhe rrush. Në fshat prodhohet rraki me metoda tradicionale. Blektoria merr zhvillim nga mbarështimi i bagëtive të imta. Në fshat gjenden rreth 300 krerë dele dhe rreth 50 krerë dhi. Mungojnë lopët në fshat. Banorët e sigurojnë qumështin dhe nënproduktet e tij nga baxhoja në fshatin Pulahë. Në L. të vendbanimit gjenden dy gurore në të cilat nxirren dhe

përpunohen gurët gëlqerorë të triasit të sipër-jurës së poshtme (T_3-J_1). Punimet artizanale zhvillohen nëpërmjet dërstiljes së leshit dhe përgatitjes së gatimeve tradicionale për periudhën e gjatë të dimrit.

ANEKS

Përmbajtja e strukturës së udhëzues-anketës, që do të përdoret në mbledhjen e të dhënave për studimin gjeografik, historik, social-ekonomik dhe kulturor aktual të vendbanimeve urbane dhe rurale në 4 njësitë administrative të Bashkisë Korçë, në kuadër të projektit “Studimi i qendrave të banuara në bashkinë e Korçës (Njësia administrative Korçë, Qendër Bulgarec, Drenovë dhe Mollaj)”, financuar nga Universiteti “Fan S. Noli”.

Vendbanimi:

1. Veçoritë fiziko-gjeografike

a. Pozita gjeografike

Koordinatat gjeografike absolute: Gjerësi gjeografike: ____° ____' ____''; Gjatësi gjeografike: ____° ____' ____''.

Vendbanimet _____ në kufi: _____.

Sipërfaqja e vendbanimit _____ km²; Shtrirja gjatësore _____ km; Gjerësia _____ km.

Distanca kilometrike nga: qyteti i Korçës _____ km; Pogradeci _____ km; Tirana _____ km; Rinasi _____ km; Kapështica _____ km; Qafëthana _____ km; Shën Naumi _____ km; Tri Urat _____ km, Kakavija _____ km.

b. Veçoritë gjeologjike dhe geomorfologjike

Lartësia mes. _____ m niveli i detit; Njësia fiziko gjeografike _____;

Përbërja gjeologjike _____;

Tipet gjenetike të relievit _____;

Objekte gjeologjike (gjeotrashëgimi) _____.

c. Klima dhe elementët e saj

Rrezatimi diellor: orët me diell____ orë; rrezatimi diellor mesatar____ orë; rrezatimi diellor mak____ orë; rrezatimi diellor min____ orë. Temperatura e ajrit: mak____⁰C; min____⁰C; mes ____⁰C. Nr i ditëve me: ngrica____ ditë; thatësirë____ ditë; mjegull____ ditë; rreshtje shiu____ ditë; rreshje bore____ ditë, trashësia____ mm; rreshje breshri____ ditë. Erërat, llojet e tyre_____.

d. Hidrografia

Lumenj____; burime____
____;
përrenj____
____;
Liqene natyrore____; liqene
artificiale____.
Hidrotrashëgimia____
_____.

e. Tokat

Llojet _____ e
tokave_____
____;
Përdorimet _____ e
tokës:_____

_____.

f. Bimësia

Katet
bimore_____

Bimesia
natyrore_____

Bimësia _____ e
kultivuar_____

_____.

Biotrashëgimia _____

Zona _____ të
mbrojtura: _____

2. Popullsia

a. Emërtimi _____ (emërtime _____ të
tjera) _____ ;

b. Historiku _____ i _____ krijimit _____ të
vendbanimit _____

i. Të _____ dhënat
arkeologjike _____

ii. Vendbanimi _____ para
1945 _____

iii. Vendbanimi _____ në _____ 1945-
1990 _____

iv. Vendbanimi _____ 1990-
2024 _____

c. **Nr. i popullsisë**

Të dhënat/ vite	Nr. populls isë	Lindj e	Vdek je	Shtesë natyro re	Emigri me	Imigri me	Saldo migrue se
Viti ____ —							
Viti ____ —							
Viti ____ —							
Viti ____ —							
Viti ____ —							
Viti ____ —							
Viti ____ —							

d. Besimi fetar (objekte fetare)

e. Trashëgimia kulturore lokale

-Trashëgimia

materiale _____

-Trashëgimia

jomateriale

(gojore) _____

f. Figura historike, artistike, politike
etj _____

3. Organizimi i vendbanimit

a. Forma e vendbanimeve

1. Vendbanime me shtëpi të shpërndara dhe prona të bashkuara;
2. Vendbanime me shtëpi të bashkuara dhe prona të shpërndara;

b. Vendbanimet sipas planit të shtrirjes

1. Vendbanim përgjatë rrugës
2. Vendbanim i grumbulluar
3. Vendbanim i rrumbullakët
4. Vendbanim me shesh qendror

c. **Artitektura e ndërtimeve**

i. Katet e banesave _____

ii. Materialet e ndërtimit (mur, çati/tarraca,) _____

iii. Organizimi i brendshëm i banimit _____

Infrastruktura (Evidento praninë ose jo të shërbimeve)

Lloji i shërbimit	Po	Jo	Nese po, si paraqitet shërbimi
Infrastruktura rrugore			
Transportin publik			
Rrjeti elektrik			
Rrjeti i kanalizimeve			

Rrjeti i ujësjetllësit			
Rrjeti i internetit			
Shërbime shëndetsore			
Shërbime arsimore			
Shërbime tregëtare			
Bar/restaurante			
Stuktura akomoduese			
Shërbime kulturore			

4. Zhvillimi ekonomik

a. Aktivitetet ekonomike të sektorit primar

Bujqësia _____

Përdorimi i tokës	Tokë bujqësore	Pemtari	Kullota	Pyje
Sipërfaqja (ha)				

Blektoria _____

Lloji	Dele	Dhi	Lope	Derra	Kafshë pune	Shpendë
Nr.						

Pemtaria _____

Bletaria _____

Pylltaria _____

b. Aktivitetet ekonomike të sektorit sekondar

Ndërtimtaria _____

-Industria
përpunuese _____

c. Aktivitetet ekonomike të sektorit terciar

Tregëtia _____

Transporti _____

Turizmi _____

Artizanati _____

LITERATURA

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2008). *Fjalor enciklopedik shqiptar: A-Gj* (Vol. I). Tirana, Albania: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
2. Aliu, S. (2021). Vendbanimet prehistorike në Shqipërinë Juglindore. Libër Kumtesash, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
3. Axhemi, S. (2007). *Gjeografia e popullsisë dhe e vendbanimeve*. Tiranë: Alsa graphic
4. Braholli, E. (2023). Kushtet natyrore dhe historike të krijimit të vendbanimeve rurale në pellgun me të sipërm ujëmbledhës të Devollit. Libër Kumtesash. *Studimi i qendrave të Banuara të Shqipërisë* (pp. 328-345). Elbasan: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
5. Braholli, E., & Leka, A. (2022). Geotouristic potential of geodiversity sites (Case Study-The Source area of Devolli, Albania). *6th UNICART, Interdisciplinary International Conference* (pp. 313-319). Rende (CS, Italy)/ Tirana (Albania): ETQA sbl.
6. Braholli, E., & Menkshi, E. (2019). Geotouristic assessment of Dardha village (Korçë, Albania) by GAM method. *European Journal of Social Sciences*, 186-193
7. Dumani, B., & Stringa, A. (1997). *Elementet e Demografisë*. Tirane: Albino.
8. Gruda, G. (2020). *Relievi Struktural i Shqipërisë*. Tiranë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë.
9. Gjoka, F. (2021). *Pedogjeografia*. Tirana: Mediaprint.
10. Hidrometeorologjik, I. (1980). *Manual i Temperaturave*. Tiranë.
11. Hidrometeorologjik, I. (1980). *Manuali i Reshjeve*. Tiranë.
12. IGJEUM. (2020). *Buletini mujor Klimatik*. Tirana: Departamenti i Klimes dhe Mjedisit.
13. *Instituti i Studimeve Gjeologo-Minerare*. Harta tektonike e Shqipërisë, shk. 1:200000, 1999.

14. *Instituti Hidrometeorologjik*. Klima e Shqipërisë (Manuali agrometeorologjik), 1980
15. Instituti i Statistikave (INSTAT). (2023). *Cens 2023*,
16. Instituti i Statistikave (INSTAT). (2023). *Census 2001*,
17. Instituti i Statistikave (INSTAT). (2023). *Census, 2011*
18. Kacori, Th. (përkthim) (1984). Burime turke për historinë e Bullgarisë. fq. 128-141
19. Këshilli i Ministrave. (2002, Maj 06). Per Zonat e Mbrojtura, Ligji nr. 8906. From Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
20. Këshilli i Ministrave. (2019). Për miratimin e Listës së rishikuar, të përditësuar, të Monumenteve të Natyrës Shqiptare. Tiranë: Fletore Zyrtare.
21. Këshilli i Qarkut Korçë (2025). *Boniteti i Tokave në bashkinë e Korçës*,
22. Kolovani, D. (1920). *La Question de Koritza*, Princeton University, Dieval, France.
23. Laçi, S., Xhafa, S., Kola, E., & Laçi, E. (2014). *Gjeografia Rurale*. Tiranë: Lilo.
24. Menkshi, E. (2020). *Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Qarkut Korçë*. Korçë: Promo Print.
25. Menkshi, E., & Shehu, D. (2020). Roli i infrastrukturës në zhvillimin e territorit urban: Rast studimi qyteti i Korçës. Vjetari FEF, 66-76.
26. Ministria e Kulturës, Lista e Monumenteve të Kulturës së rrethit të Korçës, 2006.
27. Naçi, N. N. (1923). Korça dhe katundet e qarkut . Korçë: Kotti.
28. Pano, N. (2016). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*. Tirane.
29. Pashko, P. (2018). Morava Mt Oligocene-Middle Miocene sucession of Albanian-Thessalian Basin, Albania. *Bulletin of the Geological Society of Greece*, 1-46.
30. Pashko, V. (n.d.). *Boboshtica dhe njerëzit e saj*.

31. Pepo, P. (1981). Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore, shek.XVIII-filim i shek.XX (Kodiku i Korçës dhe Selasforit), Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë.
32. Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Korçë. (2014) pdf
33. Pupa, E., & Fetah, J. (2009). *Mborja ndër vite*. Tiranë.
34. Qendra e Kërkimeve Biologjike. Flora e Shqipërisë, pjesa e parë dhe e dytë, 1988, 1992
35. Qendra e Kërkimeve Gjeografike (1990). *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.Vol.I
36. Qendra e Kërkimeve Gjeografike (1990). *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.Vol.II
37. Qiriaz, P (2024). Geography of Albania. Springer
38. Qiriaz, P. (1985). Guri i Capit. In G. Autoresh, *Enciklopedia Shqiptare*. Tirane: Akademia.
39. Qiriaz, P. (1985). Morfologjia dhe morfogjeneza e gropave juglindore dhe maleve përreth tyre. Monografi, Tirane: Universiteti i Tiranës
40. Qiriaz, P. (2019). *Gjeografia Fizike e Shqiperise*.
41. Qiriaz, P. (2020). *Trashegimia natyrore e Shqiperise (Vlerat, rreziqet dhe menaxhimi)*. Tirane: Akademia e Shkencave e Shqiperise.
42. Qiriaz, P., & Sala, S. (2006). *Monumentet e Natyres te Shqiperise*. Tirana: Mediaprint.
43. Ramo, S. (2012). Ilia Panariti dhe Korça. Korçë: Kotti.
44. Raport. (2014). Planifikimi urban. Korçë: Bashkia Korçë.
45. Rembeci, A. (2014). Kodiku i mitropolisë së Korçës dhe Selasforit (shek. XVII-XIX): Të dhëna për kulturën në zonën e Korçës. *Monumentet*, 97-125
46. Riza, E., & Strazimiri, B. (1972). Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës. *Monumentet* 3, 120.
47. Riza, E. (1991). *Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetës së vonë*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 231-233
48. Selenica, E. (1982). *Korça në faqet e historisë*. Tiranë: 8 Nëntori.
49. Selenica, T. (1928). *Shqipnia më 1927*. Tiranë: Shtypshkronja "Tirana", fq.311-341
50. Strategjia e zhvillimit të komunes Mollaj, 2011
51. Sh. Aliaj. *Neotektonika e Shqipërisë*, 2012.
52. Sheri, F. (1970). *Popullsia e Shqipërisë*. Tiranë: 8 Nëntori
53. Shqipërisë, K. i. (2014). *Ligj Nr.115/2014 Për ndarjen Administrativo-territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore ne Republikën e Shqipërisë*. Tiranë: Fletore Zyrtare.

54. T. Tafili. Gjendja e ujërave nëntokësore të Shqipërisë. Strategjia e zhvillimit të qendrueshëm, 2002.
55. Tumat e Kucit të Zi. (1978). Iliria (7-8), 127-155. From https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1977_num_7_1_1279
56. Tyli, N. (1971). Kushtet e formimit të ujërave nëntokësore në presion në ultësirën e Korçës, *Përmb. Stud*, 3/1971.
57. Theohari, R. (2014). *Potpuri Dardhar*. Tiranë: Email.Thomo, P. (1978). Mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Korçës. Monumente historike në vendin tonë, , 5-256
58. Thomo, P. (2012). *Korça, urbanistika dhe arkitektura*. Tiranë: Morava.
59. Velo, M. (2014). *Betonizimi i Shqipërisë*. Tiranë
60. Veshi, L. et al. (1986). Pedologjia,
61. VKM (2024). *Per shpalljen "Peizazh i Mbrojtur (Kategoria e V) të zonës Bredhi i Drenovës-Sinicë"*. Tiranë.
62. Xhaferllari. R. (2016) Trashëgimia natyrore e qarkut të Korçës dhe menaxhimi turistik i saj. Monografi, Universiteti i Tiranës. Tirana
63. Zeko, I. (1963). Inventarizimi i shpendëve të Shqipërisë. Buletini i USHT, Ser. Shkenc. të Nat., Nr. 1/1963
64. Ziko, V. T. (2015). *Dardha: legjenda e feniksit të pyllit*. Korce: Kotti
65. Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Drenovë
66. Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Qendër Bulgarec

